

**RINDËRTIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR NË VEPRËN E
DRITËRO AGOLLIT**
(Një qasje analitike ligjërimore)

Votim Hanoli

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale,
me profil Shkenca komunikimi, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Lorena Licenji Phd

Numri i fjalëve: 53106

Tiranë, Tetor 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, i nënshkruari, Votim Hanoli deklaroj me përgjegjësinë time të plotë juridike se ky punim është tërësisht punim origjinal i imi dhe se çdo gjë e shkruar këtu është fryt i punës sime personale. Në të nuk ka plagjiaturë apo material të kopjuar nga të tjerë dhe se çdo burim apo referencë është bërë në përputhje me rregulloren dhe standardet e vendosura nga Shkolla Doktorale e UET.

© Votim Hanoli

ABSTRAKTI
RINDËRTIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR NË VEPRËN E
DRITËRO AGOLLIT.

Të flasësh për Dritëro Agollin, për artin dhe stilin e tij sigurisht që kërkon mund dhe kohë, sepse Agolli ngërthen në vetvete vlera pafund që të nxisin të studiosh. Ky punim doktoral, synon të analizojë krijimin e identitetit kombëtar në veprat e tij letrare përmes një qasjeje analitike e ligjërimore. Problematika e këtij punimi vërtitet në qerthullin e debateve të shumta mbi teoritë sociologjike që e studiojnë identitetin kombëtar si Primordializmi dhe Konstruktivizmi (Modernizmi) prej të cilit edhe “kërcënohet”. E gjithë kjo punë kërkimore është përqendruar në argumentin kryesor që lidhet direkt me hipotezën e punimit tonë, sipas të cilit *“Identiteti kombëtar në veprën e Dritëro Agollit legjitimon qenien shqiptare përmes riprodhimit ligjërimor të vlerave primordiale më tepër se sa vlerat konstruktiviste”*. Gjithashtu kemi menduar që hipoteza të gjejë vërtetim përmes pyetjeve kërkimore si: Çfarë vendi zë çështja e identitetit kombëtar shqiptar në veprën e Dritëro Agollit?, Si trajtohet kombi në veprën e tij? dhe së fundi, Si del tema e kombit dhe identitetit kombëtar në raport me tema të tjera të pasqyruara në veprën e Agollit? Analiza empirike dhe analiza ligjërimore, janë fokusuar së pari në kontradiktat që lindin mes dy teorive kryesore të marra në shqyrtim dhe më pas në shpjegimet që jep secila për të vërtetuar tezën tonë. Parë si një rast studimor, për këtë punim janë përzgjedhur disa nga veprat përfaqësuese të Agollit ku gjen shprehje ligjërimi për kombin dhe atdheun, por kjo e marrë në një periudhë kohore të kufizuar, siç është ajo e Realizmit Socialist, sepse jo vetëm që e shpreh më qartë lidhjen me

elementin primordial por edhe sepse saktëson kontekstin dhe sfondin e punimit tonë doktoral.

Fjalë kyçe: Identiteti kombëtar, gjuha ideologjike, ligjërimi nacionalist, toka mëmë, gjaku dhe nderi, Realizmi Socialist.

ABSTRACT

RECONSTRUCTION OF NATIONAL IDENTITY IN THE WORK OF DRITERO AGOLLI

"Homeland ... is this yard here, that piece of land, they both moo, listens as they moo? Homeland is the poplar, one fence, the chimney up there! Those disappear, the homeland fades ". (Agolli.1991: 119). Talking about Dritero Agolli, talking about his art and style can certainly require time, because Agolli incorporates the infinite value to encourage the studying and beyond. This doctoral work aims to analyze the creation of national identity in his literary works through a discourse analytical approach.

The issue of this paper rounds around in numerous debates on sociological theories which study national identity as Primordialism and Constructivism (Modernism) from which it is "threatened". All this research is focused on the main argument that is directly related to our hypothesis entitled, according to which *"Albanian national identity in the work of Dritero Agolli legitimates the Albanian being through the reproduction of primordial values more than constructivist values"*. Also we thought that to this hypothesis is meant to be given

explanation by the research questions such as: What place does the issue of the Albanian national identity occupy in the work of Dritero Agolli. How is the nation addressed in his work, and finally, How does the theme of nation and national identity is related to the other topics in Agolli's work.

Empirical analysis and discourse analysis, are focused primarily on the contradictions that arise between the two main theories included in our survey and then the explanations that gives each of them to prove our thesis. Seen as a case study, we have selected for this study some of Agolli's works where is mainly expressed the discourse to the nation and homeland, but we need to emphasise that this includes a limited period of time, that of the Socialist Realism. This choice derives because, in Agolli's work during this period, is not only clearly expressed the primordial connection element but also it provides the context and the background of our doctoral thesis.

Key words: National identity, ideological language, nationalist discourse, mother land, blood and honour, Socialist Realism.

Ja kushtoj familjes sime, në veçanti babait tim, Rizait, heroit tim.

FALENDERIME

Një punim shkencor, nuk është “*vetëm lodhje personale*”, por edhe punë e një grupi njerëzish të cilët ndodhen pas teje, që të japin jo vetëm përkrahje por dhe një nxitje më shumë për t’a bërë këtë punim sa më të mirë e sa më cilësor.

Së pari, ky punim nuk do të mund të finalizohet pa ndihmën e pakursyer të profesores sime udhëheqëse, Lorena Licenji, e cila më ka dhënë motivin për t’u fokusuar në linja të drejta e të sakta larg rrëmujës dhe problematikave që të krijon stresi i kërkimit doktoral.

Së dyti, falenderim i veçantë shkon për Universitetin Europian të Tiranës, i cili, pas dilemash të miat pa fund, më dha mundësinë të realizoj ëndrrën time, të thelloj njohuritë e mia duke ndjekur studimet në nivelin e Doktoraturës, si dhe për mbështetjen dhe përkrahjen e jashtëzakonshme për të kurorëzuar me sukses këtë proces, veçanërisht pedagogët e Departamentit të komunikimit pranë Shkollës Doktorale Belina Budini (për këshillat dhe sugjerimet), Gilman Bakalli, Henri Çili, Ferit Duka, Irena Myzeqari etj.

Së treti falenderoj familjen time të madhe, Timen me familjen e saj, Deten me familjen e saj, Titin me familjen e tij, Nikun me familjen e tij, Verën me familjen e saj, Limin, Ledin me familjen e tij dhe Zenin me familjen e tij, dhe të gjithë nipërit dhe mbesat e mia që kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë frymëzimi im, përkrahja ime më e madhe dhe paradigma ku unë jam mbështetur për të ecur i qetë në rrugën time drejt doktorimit. I kërkoj thellësisht ndjesë prindërve të mi Rizait dhe Selimes, për kohën e munguar në aktivitetin e përditshëm familjar, me justifikimin e vetëm, për t’u zhytur në botën e studimit, të cilën e dua shumë.

Së fundmi, një falënderim për mikeshat e mia Mirela Nezhën dhe Denis Çelçimën të cilat më kanë ndihmuar me përkthimin e pjesës teorike dhe materialeve të literaturës si dhe në trajtimin e ideve e të mendimeve, të vlefshme e të domosdoshme në plotësimin e kuadrit teorik.

ABSTRAKTI

DEDIKIME

FALENDERIME

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. KAPITULLI I. HYRJE	11
1.1 Përzgjedhja e temës	11
1.2 Vështirësitë dhe kufizimet e punimit	13
1.3. Pse është Dritëro Agolli objekt i këtij studimi?.....	17
1.4 Shtrirja kohore dhe hapësinore e studimit	21
1.5 Objektivat e temës, hipoteza dhe pyetjet kërkimore	22
1.6 Struktura e punimit	26
2. KAPITULLI II. KUADRI TEORIK, LITERATURA DHE METODOLOGJIA.....	29
2.1 Hyrje	29
2.2 Letërsia si art dhe praktikë sociale. Krijimi i identiteteve në letërsi	30
2.3 Ligjërimi si praktikë sociale dhe si formë e shprehjes në letërsi	33
2.4 Ndërtimi i identiteteve përmes ligjërimit. Ligjërimet nacionaliste	37
2.5 Instrumentat e analizës	41
3. KAPITULLI III. KONTEKSTI HISTORIK. QASJE DHE TEORI MBI IDENTITETIN KOMBËTAR	46
3.1 Debate mbi identitetin kombëtar	46
3.2 Identiteti kombëtar mes primordializmit dhe konstruktivizmit	50

3.3 Primordializmi apo konstruktivizmi. Një qasje teorike	59
3.4 Marrëdhëniet mes primordializmit dhe konstruktivizmit	61
3.5 Identiteti kombëtar në rrafshin primordial	74
3.6 Ndikimi politik në rindërtimin e identitetit kombëtar	79
3.7 Identiteti kombëtar si ideologji	83
3.8 “Shthurja” e variantit tradicional në rindërtimin e identitetit kombëtar	90
3.9 Nga nacionalja drejt identitetit kombëtar	94
3.10 Identiteti dhe dhuna	98
4. KAPITULLI IV. RINDËRTIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR NË VEPRAT E DRITËRO AGOLLIT-ANALIZE E VEPRAVE	104
4.1 Hyrje	104
4.2 Prezantim i shkurtër i romaneve të marrë në analizë	105
4.3 Identiteti kombëtar, “Njeriu i Ri” dhe idealizmi për atdheun	108
4.4 Identiteti kombëtar, “Njeriu i Ri” dhe ideologjia	115
4.5 Konflikti për rindërtimin e identitetit kombëtar	119
4.6 Identiteti kombëtar dhe heroi mitik	124
4.7 Identiteti kombëtar dhe tjetri. Tjetërsimi përmes nacionalizmit	132
4.8 Identiteti kombëtar si trashëgimi dhe traditë	143
4.9 Aspekte të ligjëritit tradicional në veprën e Dritëro Agollit	155
4.10 Variacione të shfaqjes së elementëve primordialë te D.Agolli	159
5. KONKLUSIONE	167
6. SHTOJCA I	176

7. BIBLIOGRAFIA 184

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Karakteristika të identitetit dhe primordializmit.

Tabela 2. Pikëtakimet dhe pikëlargimet mes primordializmit dhe konstruktivizmit përmes historisë dhe lidhjes me atdheun

Tabela 2/1. Pikëtakimet dhe pikëlargimet mes primordializmit dhe konstruktivizmit përmes gjuhës dhe simboleve.

Tabela 3. Ndërtimi i individit identitar përmes rrafshit linear të personazhet të Agollit.

Tabela 4. Ndërtimi i individit identitar përmes rrafshit jolinear të personazhet të Agollit.

Tabela 5. Ndërtimet gjuhësore që përcaktojnë identitetin kombëtar të Agolli

Tabela 6. Denduria e përsëritjes së variablave primordiale në veprat e Dritëro Agollit.

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Përzgjedhja e temës.

Studimi i teorisë së identitetit kombëtar në letërsinë shqipe, sidomos në veprat e Realizmit Socialist, është një domosdoshmëri. Kjo letërsi ka specifika të dallueshme nga ana e teorive dhe e kontekstit ku vendoset identiteti kombëtar. Kësisoj, qasja teorike ndaj kësaj çështjeje (identitetit kombëtar), vjen si nevojë e shumëfishtë. *“Identiteti dhe çdo gjë në shoqëri ndryshon, ndryshon dhe identiteti dhe karakteri kombëtar. Brenda identitetit hyjnë gjuha, territori gjeografik, hyjnë zakonet, hyjnë konstitucioni shpirtëror, të gjitha këto janë elemente që ndryshojnë”*. (Agolli, 2006). Për shqiptarët, çështja e identitetit kombëtar, diskutimi dhe tezat e ngritura për të, ka ekzistuar prej kohësh, herë e parë si përpjekje për ekzistencë, herë si përpjekje për shtetformim por edhe si mundësi për të gjetur dhe shprehur vetveten në përqasje me popuj e kultura të tjera bashkëkohëse.

Që nga shekulli XVII në Europë, vetëdija kombëtare lindi prej kulturës së njësuar, pra prej kulturës popullore, nga e cila duket më pastër dhe më qartë se kudo ideja e një lloj ngulitjeje në subkoshiençë, se çdo njëri nga ne duhet të nxitet t’i dalë për zot shumëllojshmërisë së vetvetes, ta rrokë identitetin e vet si shumën e përkatësive të tij të ndryshme. Prej këtij konteksti mund të konkludojmë në një hipotezë se vetë shqiptarët jo pak herë kanë pasur në dorë të identifikojnë dhe të ngrenë lart moralin e tyre kombëtar përpos asaj që thotë Kadare se *“... problemi i mirëkuptimit ose moskuptimit shqiptar me kontinentin, është në thelb mirëkuptimi ose moskuptimi me vetveten...”* (Kadare, 2006:49), e që në jo pak raste, këto të fundit, sidomos kohëve të fundit, shqiptarëve u kanë munguar. Fjala është për tezën *“Rindërtimi i identitetit kombëtar në veprën e Dritëro Agollit”*, duke përdorur termin

rindërtim për dy arsye, letrare dhe historiko-sociologjike: **së pari**, sepse, meqë objekti i studimit tonë është letërsia, vepra letrare, pohojmë që letërsia si art, si shkencë por dhe si praktikë sociale, ka privilegj të saj rindërtimin e një bote tjetër (bota e trillimit) paralele me botën e njëmendësisë (botën reale), dhe: **së dyti** “*sepse intelektualët nacionalistë (ri)ndërtojnë kombin duke u bazuar tek e shkuara etnike: në radhë të parë, ata përpiqen të gjejnë një të shkuar të denjë për kombin; mbledhin copat e së shkuarës dhe mundohen t’i lidhin ato me të tashmen; nga e shkuara ata nxjerrin motive për të frymëzuar dhe modeluar rigjenerimin e kombit*”. (Smith, 1995:15).

Janë këto aspekte që nxjerrin në dritë një kontribut të shkrimtarit për të formuluar dimensionet e qenies shqiptare në kohë, dimensione këto të cilat bashkë me konfliktet sociale shihen si pjesë e identitetit kombëtar dhe “... pikërisht në një botë që është bërë kaq e lëvizshme, marrin rëndësi krijimet e një prejardhjeje të përbashkët”. (Alternat, 2002:17). Këto dimensione, në krijimtarinë e tij letrare, na zbulohen përmes aspektit ligjërimitor në të gjitha gjinitë letrare, madje shpesh në formë origjinale, të cilat e tejkalojnë dhe kohën shkrimore të ngujuar në ideologji dhe sociologji. Nëse në fillimet e saj, çështja e identitetit shihej më tepër si teori ideologjike, Agolli me veprën e tij vijon projektimin e Shqipërisë duke u bërë kështu “*poet i 24000 km katrorë*”, por ai në kohë pranon kontradiktën dhe fillimin e ndryshimit të konceptit, dhe në mënyrë diplomatike bën një lloj tërheqjeje nga ideologjia e ku në letërsinë e tij do të nxjerrë kokë një traditë e re që përpiket të çlirojë ligjërimitin e letërsisë shqipe të pa frymë, nga një frymë e monumentalizmit fals e të gënjeshtërt që të lëbyr sytë. Objektivi ynë, me këtë rast, do të jetë tentimi për shkoqitjen e aspektit koheziv dhe atij çintegruës të nacionalizmit përmes gjuhës së përdorur nga

personazhet e Agollit, shqyrtimi i shumë kategorive që kanë të bëjnë me të (kombi dhe kultura, fisi, gjuha, simbolet, gjaku, feja, etnia edhe rraca), por nuk do të mungojnë as përpjekjet për të treguar se pse identiteti kombëtar ka gjasa të jetë shumë pak i shmangshëm në të ardhmen, apo pse ai mund të shpjegohet edhe si një riciklim i vazhdueshëm i destabilizimeve brendaeuropiane që prodhon politika e vendeve të cilat vetëkonceptohen dhe pranohen nga të tjerët si ato të cilat duhet të jenë rregulluese të të ashtuquajturit “*rend european*”.

1.2 Vështirësitë dhe kufizimet e punimit.

Zhvillimi i suksesshëm i këtij studimi, paraqet vështirësi në disa plane:

-Së pari, kemi një temë të ashtuquajtur “të nxehtë”, me një reflektim sa në rrafshin horizontal, pra në shtrirjen gjithëpërfshirëse gjeografike, aq edhe në rrafshin vertikal, pra në laryshinë e teorive të ndryshme mbi nacionalizmin, identitetin, kombëtaren, globalen, që janë sot në tregun e mendimit, aq më tepër pastaj për veprën letrare kur dihet që letërsia e kësaj periudhe shumë pak është marrë në shqyrtim.

-Së dyti, mungesa e një qëndrimi të vetëm koherent në lidhje me këtë çështje dhe trajtimin e saj në letërsi, ku mendimi teoriko-studimor bie ndesh në shumë raste me atë çka është në realitet, pasqyrimi i kësaj gjendjeje nga shkrimtarët, të cilët ku më shumë e ku më pak janë të indoktrinuar nga politika e vendit të tyre dhe padashur janë bërë zëdhënës të saj, duke dëmtuar mendimin dhe qëndrimet e lexuesit të tyre, dhe kjo përbën një vështirësi më vete.

-Së treti, vetë konceptet nacionalizëm, nationale, nacion, identitet kombëtar, nuk janë përcaktuar në mënyrë të prerë e kategorike, ndaj lenë vend për diskutime shumë të gjata.

Këtu nuk duhen lënë pa përmendur të paktën dy kampe mendimi: konstruktivistët dhe primordialistët, rreth të cilëve do të fokusohemi më shumë edhe në këtë punim dhe po kështu do të kemi dhe qasjen tonë në lidhje me veprën letrare të Dritëro Agollit.

-Së katërti, mungesa e distancës mes zhvillimit teorik dhe realizimit praktik të koncepteve mbi nacionalizmin, e vështirëson vlerësimin e autorit, ose në rastet më të mira kjo distancë është aq e vogël sa përsëri neve na e vështirëson të kuptuarit e qëndrimit të drejtë ose jo, që mban autori në vepër kur trajton këto probleme.

Vetëdija e këtyre vështirësive e bën këtë punim me një qëllim e trajtë. Nëpërmjet tij synojmë vazhdimin e këtij diskursi të madh shkencor-filozofik-politik-artistik e ligjërimit, pasi të kemi dhënë edhe një qëndrim tonin rreth këtyre problemeve. Sa herë që i përvishemi studimit të nacionalizmit, duhet të kemi parasysh një gjë: kemi të bëjmë me fenomenin për të cilin mendimet e atyre që e studiovan atë janë të ndryshëm e shpeshherë të kundërt, dhe e gjithë kjo e ka burimin në vetë natyrën tejet të papërcaktuar, konceptualisht mjaft të mjegulluar dhe kundërthënëse të këtij fenomeni social. Përveç kësaj, studimi vështirësohet edhe më, nëse e kuptojmë që para nesh është një dukuri shoqërore, karakteristike për modernitetin e vonë, e cila u shfaq aty nga gjysma e shekullit XIX, për të lulëzuar kah mesi i gjysmës së pjesës së parë të shekullit XX. Kjo sepse, kur pothuajse të gjithë po mendonin se përfundimi i Luftës së Dytë Botërore do të ishte limiti historik i fillimit të një epoke postnacionaliste, fenomeni nacionalizëm apo identitet kombëtar, aty kah dekada e fundit e shekullit që kemi lënë pas, u rishfaq me tërë forcën e tij shpërthyes, i zgjuar ndoshta pas harxhimit të sedativëve që i jepeshin atij. Me fjalë të tjera, ajo që e thëllon paksa vështirësinë e ndërmarrjes sonë studimore është se, po t'u kushtosh vëmendjen e duhur

gjërave që thamë më lart, s'ka se si të mos krijohet përshtypja se ideja e identitetit kombëtar, vjen e forcohet në raport të drejtë me rritjen e kompleksitetit të modernitetit nga konteksti i zhvillimit të gjithanshëm social. Vështirësia e fundit vjen nga ajo që do t'a quanim *aspekti sociologjikisht jokonkret i natyrës së dukurisë së identitetit kombëtar*. Atë s'do të mund t'a studiojmë si një institucion social brenda të cilit, raportet e pjesëve përbërëse të tij janë mjaft të definuara (si familja p.sh). Ai (identiteti kombëtar) na e flak tej këtë mundësi qasjeje, për të na imponuar një tjetër që ka të bëjë më shumë me përqëndrimin në shpjegimin e kategorive mjaft të ndërlikuara, që, në fund të fundit, janë të lidhura me aspekte sentimentale të njerëzve: ndjenjat që ata ushqejnë për kolektivitetin të cilit i përkasin, gjuha dhe elementët ligjërimorë që përdorin personazhet, elementet të cilat ata i konceptojnë si relevante për përcaktimin e bashkësisë grupore, të cilat janë vendimtare për determinimin e raporteve dhe sjelljes ndaj të tjerëve që s'i takojnë atij grupi, dhe, natyrisht, rëndësia që u japin njerëzit atyre elementeve identitare.

Duke qenë se krijimtaria e Dritëro Agollit dhe tematika që ajo trajton është mjaft e gjerë dhe e pasur, kemi rënë në një marrëveshje për dy lloj kufizimesh:

a. në kohë

b. në krijimtari.

Ky lloj selektimi, përmes kufizimit, në fakt konsiston në marrjen në shqyrtim të letërsisë shumë pak të studiuar e të marrë në analizë, periudhës së viteve '50-'90 ose përkitazi periudhës ideologjike të Realizmit Socialist (deri në rënien e tij), si dhe veprave të shkruara nga autori në këtë periudhë. Kështu, duke qenë se në studimin tonë jemi kufizuar në kohë përse i përket periudhës historike, pra i jemi referuar periudhës së Realizmit Socialist, kemi

përzgjedhur vepra të shkruara nga autori në poezi dhe prozë, të cilat mendojmë se jo vetëm që i vijnë më për shtat hipotezës dhe objektivave të punimit tonë, por më shumë se të tjerat, përmes procedeve letrare, mbartin në vetevete shprehjen me të fuqishme të identitetit kombëtar. Janë vepra në të cilat ligjërimi i personazheve përvec larmisë së tematikave, situatave dhe konflikteve artistike nxjerr dukshëm identitetin e tyre personal dhe kombëtar, madje edhe kur kanë shërbyer si skenarë filmash, këto vepra kanë ruajtur origjinalitetin e tyre, duke ruajtur vlerat e tyre letrare e historike kombëtare. Veprat e marra në analizë për këtë punim, zgjedhur nga krijimtaria e pasur e Dritëro Agollit janë:

- Romane

Komisari Memo (1970)

Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo (1973)

Njeriu me top (1975)

Dështaku (shkruar më 1985 dhe botuar më 1991)

- Poema

Devoll-Devoll (1964)

Baballarët (1969)

Nënë Shqipëri (1975)

- Vëllime poetike

Në rrugë dola (1958)

Hapat e mia në asfalt. (1961).

Mesditë (1968)

Fjala gdhend gurin. (1977)

1.3 Pse është Dritëro Agolli objekt i këtij studimi?

Dritëro Agolli, një nga personalitetet më të shquara të letërsisë shqipe, është poet, prozator, publicist, kritik dhe politikan. U lind në vitin 1931, në fshatin Menkulas të Devollit, në Korçë. Mësimet e para i ndoqi në fshatin e lindjes, kurse ato të mesme, në gjimnazin e qytetit të Gjirokastrës. Studimet e larta i ka kryer për gazetari, në Leningrad, të ish Bashkimit Sovjetik. Pas mbarimit të studimeve, kthehet dhe punon për një kohë të gjatë në redaksinë e gazetës “Zëri i popullit”. Për 15 vjet me radhë, ka qenë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Krijimtaria e tij letrare dhe publicistike, është shumë e pasur, gjë me të cilën ka prezantuar denjësisht letërsinë shqipe në aspektin kombëtar dhe global. Vepra e tij letrare është studiuar dhe përkthyer në disa gjuhë të botës, duke bërë jehonë të madhe në vendet ku u botua, si në Francë, Gjermani, Itali, Greqi, Rusi, e vende të tjera.

Ndër librat e Dritëro Agollit përmendim: *“Në rrugë dola”* (i frymëzuar nga një varg i një poezie të poetit të madh rus Sergei Esenin), *“Hapat e mia në asfalt”*, *“Zhurma e erërave të dikurshme”*, *“Shtigje malesh dhe trotuare”*, *“Mesditë”*, *“Nënë Shqipëri”*, *“Fjala gdhend gurin”*, *“Komisari Memo”*, *“Dështaku”*, *“Njeriu me top”*, *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*, *“Trëndafili në gotë”*, dramat; *“Fytyra e dytë”*, *“Mosha e bardhë”*, si dhe librat e fundit me poezi *“Lutjet e kambanës”*, *“Pelegrini i vonuar”* etj. Nga romanet e Agollit janë bërë një sërë filmash artistikë. Interesant është fakti se strukturat ligjërimore që ka ndërtuar Agolli janë aq të gjetura dhe të goditura, saqë dhe në ekranizimet e filmave ato kanë qëndruar ashtu të pandryshuara duke ruajtur lirshmërinë ligjërimore të sjellë nga vetë autori. Kjo formë ligjërimi e bën veprën e Agollit mjaft tërheqëse dhe tepër të lexuar, dhe filmat e

krijuar nga veprat e tij mjaft të ndjekur e të pëlqyer. Ndër filmat më të mirë prej veprave të tij janë “I teti në bronz” (romani “Komisari Memo”), “Njeriu i mirë”, “Apasionata”, “Njeriu me top” nga romani me të njëjtin titull etj. Ai ka shkruar edhe skenarë filmash. Filmi i parë për të cilin ai përgatiti një skenar dhe nuk shndërroi një krijim letrar në skenar ishte “Horizonte të hapura”. Në prozën e tij Agolli solli risi jo vetëm në strukturën ligjërimore, por dhe në galerinë e personazheve të veta. Ata janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë. Frazologjia e pasur popullore dhe filozofia jetësore e bëjnë përgjithësisht veprën letrare të Agollit sot për sot më të lexuarën. Jo më kot Ukshin Hoti do ta quante atë *gjenium e popullit*. Në prozë bëri emër sidomos romani “*Komisari Memo*”, në të cilin pasqyrohet roli i madh edukues dhe drejtues në vitet e LANÇI. Nga ngjarjet e kësaj periudhe e merr subjektin edhe romani “*Njeriu me top*”. Dritëro Agolli ka botuar edhe mjaft tregime e novela të tjera. Ndër krijimet satirike të tij, romani “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*” vë në lojë konformizmin dhe servilizmin si shfaqje të huaja për Njeriun e Ri.

Nisur nga fakti që shkrimtari Dritëro Agolli është pjesë e skenës letrare shqiptare për mëse 50 vjet, si një krijues me shumë anë dhe pamje, të gjitha këto na krijuan bindjen se është me vlerë të trajtojmë një problem pothuaj të munguar në qasjen ndaj krijimtarisë së tij letrare, problemin e identitetit kombëtar, problem i cili dashje pa dashje kërkon të na vërtetojë se “*nacionalizmi është e vetmja fe e kohës sonë*”. (Lukas, 2002:23). Sa e sa studime janë bërë për veprën e Agollit, për tema të veçanta të trajtuara në të, por asnjëherë nuk është marrë në studim identiteti kombëtar në veprën e tij, përveç rasteve kur kjo temë është përmendur përciptazi ndër motivet e tjera të krijimtarisë së tij letrare. Siç vëren edhe studiuesi Shaban Sinani: “*Dritëro Agolli, me prozën e tij, ka krijuar karaktere dhe mjedise që bartin gjurmën e historisë,*” (Sinani.2011:271).

Së pari, Dritëro Agolli është një pikë kyçe e zhvillimit të letërsisë shqipe në një hark të gjerë kohor. Duke qenë poet eksplisit në kuptimin e plotë të fjalës, vepra e Agollit i dedikohet fëmijës, nxënësit, mësuesit, fshatarit, intelektualit etj, sepse siç thotë shkrimtari i madh amerikan Tomas. S. Eliot *“Kur një qytetërim është i shëndoshë, atëherë poeti i madh do të ketë diçka t’i thotë edhe shokut të tij fshatar të çdo shkalle të edukimit”*, apo siç vëren edhe studiuesi Shaban Sinani se: *“Dritëro Agolli zë kudo dhe për këdo një pikë reference të paluajtshme”*. (Sinani. 2010:26).

Së dyti, vepra e Dritëro Agollit më mirë se çdo vepër tjetër e letërsisë së asaj periudhe, (Realizmit Socialist, diktaturës komuniste), i ka mbajtur lidhjet e ngushta me njeriun e thjeshtë dhe me identitetin e tij, gjë që padyshim rrjedh nga konceptet e autorit rreth nacionalizmit, nacionales, kombit, e thënë ndryshe, nga qëndrimi i tij përmes personazheve të veta ndaj kombit, kombëtares dhe identitetit kombëtar.

Së treti, vepra e Dritëro Agollit spikat edhe në drejtim të formës. Lidhjet e tij me traditën e ligjëritimit shkrimor popullor dhe të letërsisë së traditës së shkrimit shqip janë të dukshme dhe mbizotërojnë në krijimtarinë e tij. Gjuha e Agollit është e thjeshtë, e papërpunuar, me fraza të kapshme e frazeologji që duket sikur dalin nga toka, nga balta. Sigurisht, nuk e përjashtojmë faktin që, në veprën e tij gjejmë edhe tekste të frymëzuara nga tradita shkrimore botërore, si ajo historike po aq edhe bashkëkohore, sa nga Bërns, Esenini e deri tek Majakovski e Hikmet. Por në tërësinë e saj kjo vepër i përket më shumë traditës së shkrimit shqip, të karakterit të Rilindasve, sidomos Naimit, e cila në një farë mënyre përshtatet edhe në përmbajtje, gjë që lidhet mjaft mirë dhe me objektin kryesor të studimit tonë. Vërejmë pa vështirësi që temat janë ideale e qëndrime rreth identitetit kombëtar.

Së katërti, në trajtimin e këtij problemi, pra të identitetit kombëtar, vepra e Agollit është më e hapur, më e konstatueshme në parashtrimin e qëndrimeve e zgjedhjeve që autori kërkon tua lerë si mesazhe lexuesve, sikur është e konstatueshme edhe imponimi ideologjik, pasojë e doktrinimit marksist-leninist apo të Realizmit Socialist. *“Me zhvillimin e letërsisë së Realizmit Socialist u grumbullua një përvojë e re artistike, e cila, e studiuar nga pozitrat e botëkuptimit marksist-leninist, përbën një faktor të rëndësishëm objektiv për të nxjerrë përfundime shkencore për kuptimin e novatorizmit dhe të traditës”*. (Mato, 1983:11). Në këtë studim kemi kërkuar të hedhim në shqyrtim një dukuri që në periudhën e Realizmit Socialist krijoi me ngulm në mendjen e shqiptarëve përmes ideologjisë, atë që u quajt frymë revolucionare, që mban në këmbë identitetin kombëtar përmes vlerash të rreme (po marrim guximin t’i quajmë kështu), ato vlera që impononte verbërisht ky sistem dhe kjo doktrinë. *“Kjo shpjegohet më pak me interesat konkretë materialë sesa me vlerën simbolike të çështjes që lidhet me identitetin kombëtar”*. (Altermatt, 2002:17).

Së pesti, është interesant qëndrimi që Agolli mban me rrëzimin e diktaturës komuniste, pjesë aktive e së cilës ai ishte. (Kujtojmë këtu sa aktiv ka qënë Agolli në jetën politike). Katarsisi i tij vjen i singertë. Në raport me çështjen tonë, pra me identitetin kombëtar dhe qëndrimet ndaj nacionalizmit e nacionales, Agolli nuk ka ndonjë ndryshim “të rrezikshëm”. Në thelb, qëndrimi i tij, siç do ta vërejmë edhe në faqet e këtij punimi, është i njëjtë, vetëm se shkarkohet nga ujërat e tepërta, letërsia e tij bëhet më reale, qëndrimet më të drejtpërdrejta dhe sigurisht, ai që ndryshon rrënjësisht është qëllimi.

Së gjashti, siç vëren edhe vetë autori, Dritëro Agolli: *“Ndërgjegjja kombëtare është një nga faktorët kryesorë për formimin e “ndërgjegjes poetike” të një populli, në një etapë të caktuar historike”*. (Agolli.1980:20).

1.4 Shtrirja kohore dhe hapësinore e studimit

Ky punim ka si qëllim të analizojë marrëdhëniet dhe shpleksjen e teorive mbi nacionalizmin dhe identitetin kombëtar përmes ligjërimit në veprën e shkruar nga Dritëro Agolli në një hark kohor nga viti 1955 (koha kur Agolli shkruan veprat e para) deri më 1990. Për këtë, duke qenë se jemi në fushën e studimit të letërsisë, do të na vijë në ndihmë teoria e Ruth Wodak me elementë të qasjes historike pasi *“Rrënjët e shumëfishta të Analizës Kritike të Ligjërimit shtrihen në Retorikë, Gjuhësinë e tekstit, Antropologji, Filozofi, Socio-Psikologji, Shkencat Konjitive, Studimet letrare dhe sociolinguistikë dhe gjithmonë e me tepër në Gjuhësinë e aplikuar dhe Pragmatikë”*. (Wodak & Meyer, 2009:1).

Trajtimi i kësaj çështjeje në veprën e Agollit, siç do ta vërejmë edhe në faqet e punimit, është i kahershëm, ose më saktë është gjithnjë prezent, por forma me të cilën ai e shfaq na çon drejt studimit të teksteve të tij me periudha, konkretisht me dy periudhat e sistemit politik në Shqipëri, atë të diktaturës komuniste, pra të Realizmit Socialist, dhe me atë të fillimit të qasjes ndaj ndryshimeve politike (vitet 1990 e më pas). Por në studimin tonë ne do të mbetemi në të parën që është periudha ideologjike e Realizmit Socialist. Edhe qëndrimet dhe analiza e këtyre qëndrimeve të Agollit në veprën e tij janë përkitasi këtyre periudhave. Pikërisht kjo e bën veprën e tij të shtrirë në hapësirë e në kohë. *“Identiteti është i ndërtuar në akordancë me kushtet e veçanta të proceseve kohore dhe varet nga koha dhe hapësira.*

Si koncept paraqitet me nocionin e vazhdimësisë dhe në nocionin e

ndryshimit pa pasur kontradikta. Atij i referohen dy faktorë. 1-autenticiteti, i cili nuk është natyror dhe i lindur por i ndërtuar në kontekstin historik dhe social. 2-Kuptimi apo sensi i historisë së identitetit. Kjo do të thotë që, jo vetëm në pozicionimin e tij gjatë proceseve historike por ndryshimin e karakterit të tij holistik brenda perspektivës historike. Ndërsa identiteti religjioz kishte ndikim dhe ishte shumë determinant në europën pre -moderne, me procesin e modernizmit, identiteti kombëtar fitoi kuptim kritik dhe madje një karakter universal, i cili u shpërnda në të gjitha vendet. Karakteri historik i identitetit e bën atë të ndryshueshëm dhe të përkohshëm, ndërkohë që socialiteti i tij, mënyra e socializimit të tij, frymëzon vazhdimësinë”.

(Martin, 1995:8-11)

1.5 Objektivat e temës, hipoteza dhe pyetjet kërkimore.

Për shkak të gjerësisë së madhe të teorive që kanë studiuar fenomenet e nacionalizmit dhe të identitetit kombëtar, por edhe të specifikës ligjërimore që paraqet tema, punimi shkencor “*Rindërtimi i identitetit kombëtar në veprën e Dritëro Agollit*” ndërtohet në disa objektiva:

Së pari, duke analizuar veprën e Dritëro Agollit nga një pikëpamje e ligjërimit për kombin, rreket të analizojë lidhjet e letërsisë dhe aspekteve ligjërimore që lidhen me të, me teoritë mbizotëruese në mendimin e përbotshëm rreth identitetit kombëtar dhe nacionalizmit. Kjo analizë kryhet për aq sa na shërben neve për të studiuar veprën e Agollit. Vështirësia e këtij punimi rritet ngase në mendimin e përbotshëm ka shumë qëndrime, nganjëherë edhe të kundërta, qëndrime që jo shumë rrallë janë shoqëruar edhe me sjellje të ndryshme të kombeve në rrjedhat e historisë.

Së dyti, të identifikojë termat e kombit, shqiptarisë dhe atdheut e nacionalizmit në letërsinë e Agollit, pasi ky punim nuk është konceptuar si trajtim gjithëpërfshirës dhe shterues i këtyre teorive që nga fillimi i herës e deri në ditët e sotme. Ky është një proces në vijimësi, sepse ende nuk ka një qëndrim të vetëm për përcaktimin e koncepteve të kombit, nacionalizmit dhe identitetit kombëtar. Synimi ynë, është përfaqja e këtyre teorive në kontekstin ligjërimit të veprës së Agollit, pavarësisht rrethanave që e kushtëzuan këtë qasje. Nisur nga ky qëndrim edhe ky studim ka për qëllim të “shtojë” një rezultat analize ligjërimore në shumësinë e studimeve që janë bërë në të dy kahjet, qoftë në atë të teorive mbi nacionalitetin, identitetin kombëtar, qoftë edhe për veprën e Agollit e cila nuk ka rreshtur së studiuar nga kritikët dhe studiuesit e letërsisë.

Së treti, duke qenë se fokusi ynë i diskursit dhe analizës përqëndrohet më gjatë në dy rrymat e dukshme në atë të konstruktivizmit (modernizmit) dhe primordializmit (esencializmit, etnosimbolizmit) në trajtimin e identitetit kombëtar, ato janë dy qëndrime krejt të kundërta, siç vërehet edhe nga studiuesit sepse të dyja gjejnë mishërim praktik, në strategjitë politike të kombeve të ndryshëm në rrjedhat e mbijetesës dhe jetesës, të dyja gjejnë po ashtu zbatim praktik edhe në art e letërsi. Qëllimi ynë është të zbulojmë pikërisht këto lidhje e këto qëndrime në ligjërimin dhe veprën e Agollit.

Së katërti, të shpjegojë teorikisht se si ndodh procesi i ravijëzimit të identitetit kombëtar përmes një vepre letrare pasi sigurisht që nuk bëhet fjalë për një punim shterrues, do të ishte absurde të mendohej një gjë e tillë. Ky punim gjithashtu nuk shërben as si “guidë” e teorive dhe autorëve të shumtë që janë marrë me këto tema. Në të kundërt ky punim merret me gjuhën në tekstin e veprës së Agollit dhe të mundësive që na jep ky tekst për të kuptuar qasjen e tij ndaj identitetit dhe nacionalizmit, dhe për të kuptuar kujt krahu i përket ky tekst,

atij konstruktivist, apo primordialist. Jo teksti në vetvete, por letërsia e Agollit dhe qëndrimet e tij janë objekt i këtij punimi, sigurisht në favor të mendimit tonë. Duke qënë trillim (*fiction*), letërsia ka fatin e madh të krijojë botë paralele me botën e njëmendësisë, pra botën reale, mirëpo këtu jemi në kontradiktë me Eagleton i cili thotë se nuk është ky thelbi por fakti se si përdoret gjuha, ligjërimi në këtë trillim. Mirëpo Culler vëren se “*Ne e ndjekim letërsinë për aftësinë që ka ajo që të krijojë një marrëdhënie të veçantë me botën*”. (Culler, 1997:30). Kjo është patur parasysh që në përcaktimin e titullit të punimit tonë, që ligjërimi kërkon të rindërtojë identitetin kombëtar në veprën e Dritëro Agollit, sepse nga realiteti kjo vjen e ravijëzohet në faktin letrar. Ky punim mbi ligjërimin kombëtar në veprën e Dritëro Agollit nuk është një analizë letrare mbi veçori të stilit apo në teknikat narrative të autorit në ”produktin” e vet. Ai ngërthen në vetvete analizën ndërdisiplinore mes sociologjisë, letërsisë dhe shkencës së komunikimit përmes analizës (kritike) të ligjërimit. Studimi do të tentojë të shkoqisë veçoritë gjuhësore të personazheve dhe situatave konkrete ligjërimore (fjalëve që autori vë në gojën e personazheve duke krijuar kështu përmes kësaj gjuhe lidhjen me kombin e vet). Duke qënë se është studimi i parë mbi Agollin në këtë këndvështrim, pra mbi identitetin kombëtar, kemi formuluar këtë hipotezë.

Hipoteza: “*Identiteti kombëtar në veprën e Dritëro Agollit legjitimon qënien shqiptare përmes riprodhimit ligjërimor të vlerave primordiale (etnosimboliste) më tepër se sa vlerat konstruktiviste (moderniste)*”.

Pyetjet kërkimore: Për të patur një kornizë më të plotë të shqyrtimit të punimit tonë dhe për shkak të ndërthurjes së disa disiplineve brenda një studimi të vetëm, kemi hartuar këto pyetje kërkimore:

1. Çfarë vendi zë çështja e identitetit kombëtar në veprën e Dritëro Agollit?

- A e shfaq dukshëm vepra e Agollit identitetin kombëtar?

2. Si trajtohet kombi në veprën e tij?

- Cfarë elementësh ligjërimorë përdor Agolli për të shprehur identitetin kombëtar?
- Si shprehen personazhet dhe si i krijojnë situatat në të cilat veprojnë për të shprehur dhe mbrojtur identitetin e tyre kombëtar?

3. Si del tema e identitetit kombëtar në raport me tema të tjera të pasqyruara në veprën e Agollit?

- A është i lidhur drejtpërdrejt ligjërimi nacionalist në veprat e Agollit me elementë primordialë?
- Cilat janë fjalët që përdoren më dendur në ligjërim për të shprehur identitetin kombëtar?

Për tu kthyer përgjigje të gjitha pyetjeve dhe hipotezave të parashtruara më sipër si dhe duke parë që ky studim është më tepër çështje teorike, mendohet që e gjithë kjo punë të realizohet në bazë të metodave cilësore, teorike, analitike etj. Gjithashtu është menduar të përdoret metodologjia e *case study* duke e parë Agollin dhe çështjen e identitetit kombëtar si *case study* me metodat përkatëse si vrojtime, biografi, book review, analizë etj, pa lënë jashtë vëmendjes të dhënat historike përmes metodës historiko-kulturore interpretative sipas kërkesave dhe mundësive që kërkon ky studim.

Metoda kryesore e përdorur për të realizuar këtë punim, ka qenë ajo e vëzhgimit të rindërtimit të identitetit kombëtar në procesin letrar të periudhës së Realizmit Socialist, duke analizuar veprat kryesore të Dritëro Agollit të shkruara gjatë kësaj periudhe, jo vetëm të konsideruara interesante për kërkimin tonë shkencor por edhe sepse janë të lidhura drejtpërdrejt me hipotezën e studimit tonë.

Teoria e përdorur *"Teoritë janë si syzat"*- thotë prof. Odeta Barbullushi në një prej leksioneve të saj të Metodave të Kërkimit. Kështu pra, përsa u përket teorive bashkëkohore sociale në dobi të verifikimit të tezës sonë mendojmë ti referohemi teorisë **Primordialiste** apo esencialiste/etnosimboliste, debatit mes primordialistëve dhe modernistëve (konstruktivistëve) që shpjegon qasjen e identitetit kombëtar në kontekstin e një lidhjeje fokale mes elementeve fundamentale si toka, balta, gjaku, miti, tjetri, gjuha, simboleve të kombit etj dhe mënyrën se si këto marrin jetë përmes ligjërit, për të cilën do të flasim më gjerësisht në kapitullin përkatës duke dhënë përkufizimet përkatëse, përfaqësuesit kryesorë dhe qasjet e tyre teorike mbi këto teori.

1.6 Struktura e punimit

Ky punim doktoral është ndërtuar në pesë kapituj.

Kapitulli I-rë, është një prezantim hyrës me temën, me faktin pse kemi përzgjedhur Dritëro Agollin për studimin tonë, vështirësitë e hasura për të zbërthyer gjetjet e këtij punimi, objektivat e temës sonë, metodologjia e përdorur për të vërtetuar hipotezën tonë në përputhje me shtrirjen kohore që përfshin arti dhe krijimtaria e Dritëro Agollit.

Kapitulli II-të “Kuadri teorik” ka si qëllim shpjegimin e metodologjisë së përzgjedhur dhe fokusohet së pari mbi njohjen e koncepteve bazë të aspektit letrar, pra ç’është letërsia (duke qenë se fokusi i punimit tonë është një shkrimtar dhe vepra e tij letrare pavarësisht këndvështrimit) dhe si krijohen identitetet në letërsi, lidhja e letërsisë me disiplina të tjera sociale, për të kaluar tek fokusi ynë kryesor që është analiza kritike e ligjërimit dhe mënyrat e metodat që ajo përdor në krijimin e identiteteve përmes ligjërimit (cfarë thonë, si e thonë, kur e thonë për të krijuar identitetin e tyre dhe për ta lidhur këtë me një vlerë tjetër madhore siç është identiteti kombëtar), bazuar në mendimin shkencor më të fundit mbi këtë dukuri. Gjithashtu në këtë kapitull shpjegohet në mënyrë shterruese metodologjia e përdorur duke aplikuar analizën kritike të ligjërimit dhe përzgjedhja e instrumentave të analizës.

Kapitulli III-të ka si qëllim dhe prezantimin historik të teorive të ndryshme rreth identitetit kombëtar dhe nacionalizmit me karakteristika të këtyre teorive. Ky kapitull karakterizohet nga fokusimi tek mendimet dhe teoritë e Ernest Gellner, Antoni Smith, Tom Nairn, John Brewilly, Urs Alternat, Amartia Seen etj si dhe dy teoritë qendrore, në atë të konstruktivizmit dhe në atë të primordializmit dhe në përfundim të kësaj qasjeje hidhen mendime rreth afërsisë së tyre me veprën letrare në përgjithësi, me qëndrimin popullor të autorët në veçanti, si në rastin tonë me Agollin. Kapitulli synon parashtrimin e teorive të shumta në lidhje me këtë çështje, sikur e kemi thënë edhe më lart, e cila së bashku me pjesët e veçanta të këtij kapitulli lidhen dhe me qasjen e tyre në ligjërimin letrar në përgjithësi dhe në atë të Agollit në veçanti që janë dhe disa nga synimet e tij.

Kapitulli IV-t, Përmes analizës së veprave, synon të parashtojë elementet që e formësojnë një hero (Njeriun e Ri Socialist) të pajisur me identitet kombëtar fokusuar në formimin e Njeriut të Ri përmes ideologjisë, pse kemi zgjedhur ta quajmë kështu, tjetërsimin e Njeriut

të Ri përmes nacionalizmit, vitalizimin e Njeriut të Ri identitar përmes elementëve primordialë, heroin e përfutur nga rikrijimi i identitetit kombëtar, vendosjen e tij në qendër të konfliktit për rindërtimin e identitetit kombëtar, identitetin kombëtar të rikrijuar përmes mitit apo si trashëgimi. E gjithë kjo realizohet përmes qëmtimit të karakteristikave të secilit qëndrim dhe pasurohet nga kritikën përkatëse. Kapitulli sqaron marrëdhënien e kësaj vepre me teoritë e identitetit duke u ndalur në dy njësi strukturore. 1. Identiteti kombëtar në prozën e Agollit i fokusuar në çështje të tilla në kontekstin rindërtimit të një identiteti të ri përmes rimarrjes me në fokus ligjërimin.

2. Identiteti kombëtar në poezinë e Agollit, i fokusuar në çështje të tilla si : primordializmi në poezinë e Agollit dhe roli i këtij qëndrimi primordial mbi identitetin kombëtar, ndikimi i pashmangshëm tek lexuesi i këtij qëndrimi (Studimet e kulturës dhe feedback-u nga publiku).

Kreu i V-të përfshin edhe konkluzionet e nxjerra nga nivelet e mësipërme.

Kreu i VI-të dhe i fundit përbëhet nga referencat bibliografike.

Punimi pasurohet edhe me një shtojcë e cila përbëhet nga intervista marrë vetë autorit,

Dritëro Agolli në kuadër të këtij punimi.

KAPITULLI II. KUADRI TEORIK, LITERATURA DHE METODOLOGJIA

2.1 Hyrje

Letërsia është arti i fjalës. *Letërsia nuk është tjetër veçse mjeshtëri e marangozit*- ka thënë Marquez! Letërsia është rilindja e shpirtit, e ëndrrave, e ideve, e asaj që dashurojmë, e asaj që na lëndon, na ngacmon dhe rrjedhshmëria e vargjeve është kënga e këtyre situatave njerëzore e shprehur përmes fjalëve. *“Fjalët janë gjithçka kemi”* thotë Samuel Beckett. Pa forcën e fjalës në letërsi, njerëzit do ishin të varfër në shprehje, në ndjenjë dhe në artin e të folurit, të kuptuarit, të dashuruarit dhe të përjetuarit të emocioneve njerëzore. E thënë kështu, mendohet që letërsia ka dhe demonstroi një lloj pushteti. Sipas Eagleton *“Ideologjia nuk manifestohet vetëm në teoritë letrare, por edhe në vetë letërsinë: letërsia dhe ideologjia nuk janë dy fenomene të veçuara që mund të lidhen me njëri-tjetrin, porse “letërsia, duke qenë e lidhur ngushtë me pushtetin e shoqërisë, është ideologji”.* Prandaj nuk mund të ushqehet më iluzioni i rehatshëm që e sheh letërsinë si një ishull idilik të shkëputur nga historia, ashtu siç nuk mund të ëndërrosh më për letërsinë si një pasaportë për t’u futur në histori”. (Eagleton,2005:5). Ajo çka ne duam të sqarojmë përmes këtij punimi është trajtimi i letërsisë shqipe nga një këndvështrim tjetër, parë nën lupën e ligjërit dhe kontekstit social të ndërtimit të identitetit kombëtar si konstrukt shoqëror në letërsinë e periudhës së Realizmit Socialist. Kapitulli ka si qëllim shpjegimin e metodologjisë së përzgjedhur dhe fokusohet së pari mbi njohjen e koncepteve bazë të aspektit letrar, pra ç’është letërsia (duke qenë se fokusi i punimit tonë është një shkrimtar dhe vepra e tij letrare pavarësisht këndvështrimit) dhe si krijohen identitetet në letërsi, lidhja

e letërsisë me disiplina të tjera sociale, për të kaluar tek fokusi ynë kryesor që është analiza kritike e ligjërimit dhe mënyrat e metodat që ajo përdor në krijimin e identiteteve përmes ligjërimit (çfarë thonë, si e thonë, kur e thonë personazhet/heronjtë për të krijuar identitetin e tyre dhe për ta lidhur këtë me një vlerë tjetër madhore siç është identiteti kombëtar), bazuar në mendimin shkencor më të fundit mbi këtë fenomen. Gjithashtu në këtë kapitull shpjegohet në mënyrë shterruese metodologjia e përdorur duke aplikuar analizën kritike të ligjërimit dhe përzgjedhja e instrumentave të analizës.

2.2 Letërsia si art dhe si praktikë sociale. Krijimi i identiteteve në letërsi.

“Gjuhësia e përdor termin ligjërim për të përshkruar një njësi të të folurit më të madhe se sa fjalia. Megjithatë, ka shumë që e konsiderojnë letërsinë si ligjërim”. (Mathews & Ross, 2010:391). Që në zanafillë të saj, misioni i letërsisë ka qenë shprehja e botës shpirtërore të njeriut përmes përdorimit të gjuhës. Themi shprehja, sepse ky është dhe një nga funksionet themelore të gjuhës që përdor letërsia, (funksioni ekspresiv/ shprehës), nëse i referohemi funksioneve të gjuhës, të cilat sipas Jakobson janë: Referencial, Ekspresiv, Konativ, Fatik, Metalinguistik/Metagjuhësor dhe Poetik, dhe duke qenë se jemi në letërsi flasim për forma të narracionit krijuar nga këto funksione. “Këto forma të ndryshme të analizave gjuhësore të ligjërimit, lejuan gjithashtu për herë të parë specifikimin e marrëdhënieve të qarta mes strukturave gramatikore të një teksti nga njëra anë dhe strukturat e tjera të ligjërimit, p.sh., struktura narrative, në anën tjetër”.(Van Dijk, 1988:6).

Në kohë të ndryshme kanë qarkulluar mendime të ndryshme për të definuar termin letërsi, kuptimi i parë i së cilës rridhte që nga antikiteti i lashtë. Culler thotë se duke shmangur të gjitha emërtesat dhe “peripecitë” e termit: “... do arrinim në përfundimin se letërsia është

çdo gjë që një shoqëri e dhënë e trajton si letërsi, pra një grup tekstesh që arbitrat kulturorë e njohin si vepër letrare”. (Culler, 1997 :22). “Foucault, Derrida dhe / ose Lacan) kanë një stil më filozofik të analizës së ligjërimit, me referenca të shpeshta në punën ideologjike, historike, psikoanalitike e neomarksiste dhe aplikimet, veçanërisht në fushën e studimeve letrare”. (Culler, 1980:18). Pa gjuhë dhe ligjërim nuk ka letërsi, sepse vetë letërsia është një formë ligjërimi. Me kohë qëllimi i letërsisë ka ndryshuar. Psh, “Për formalistët, gjuha letrare përfaqësonte një sërë devijimesh nga norma, një lloj dhune gjuhësore. Letërsia ishte një lloj “i veçantë” që e dallonte atë nga “gjuha e zakonshme” e së përditshmes”. (Eagleton, 2005). Pra, duke qenë kështu, letërsia mendohet si një disiplinë mjaft e studiuar seriozisht brenda grupimit të madh të shkencave sociale, porë kjo edhe në lidhjen simbiotike që ka me to, sidomos kur vihet në fokus të analizës së ligjërimit. “Analiza e ligjërimit përdoret shpesh kur punohet me gjuhën dhe gjuhësinë dhe është mjaft e njohur në shumë prej shkencave shoqërore, ndër të cilat sociologjia dhe shkencat politike”. (Mathews & Ross, 2010:391).

Tekstet letrare të veprës së Dritëro Agollit në këtë punim janë analizuar duke përdorur koncepte të ndryshme të kritikës bashkëkohore të Analizës Kritike të Ligjërimit (Analiza kritike e ligjërimit u referohet një sërë qasjesh që janë të lidhura shumë çka u takon themeluesve të saj si Norman Fairclough, Ruth Wodak, Teun Van Dijk dhe Theo Van Leeuwen) kritika formaliste, kritika strukturaliste, qasjes sociolinguistike (Metodologjia e përdorur rrjedh nga një model akademik i cili është i përkufizuar dhe shpjeguar, e që bazohet kryesisht në modelin e Teun Van Dijk e njohur si qasja socio-konjitive me një fokus të përbërë nga elemente të diskursit, perceptimit dhe shoqërisë që shërbejnë si mjet për krijimin e fenomeneve të realitetit shoqëror. Në këtë kontekst, diskursi mund të kuptohet si

një eveniment komunikativ ku përfaqësimet sociale kanë një rol vendimtar), dhe qasja historike, e cila ka të bëjë me shtrirjen në kohë, ku përfshihen faktet historike, e përfaqësuar nga Ruth Wodak etj dhe kritikës letrare apo edhe analizës së përmbajtjes për të cilën jemi mbështetur në një qasje shkencore të hartuar nga Timothy Stephen. Duhet theksuar se gjatë kësaj analize kemi synuar të marrim në shqyrtim njësi të vogla ligjërimi, pra segmente ligjërimi, (fjalë, fjali dhe shprehje) të cilat na shërbejnë për të sqaruar mënyren sesi ndërtohen identitetet (kombëtare) në letërsi.

Sipas Wellek dhe Woren, dy janë rrugët e mundshme në qasjen të vepra letrare për të analizuar por edhe për të krijuar identitete: *“vështrimi i jashtëm i cili mbështetet në të dhënat dhe marrëdhëniet me shkencat e tjera si filozofinë, psikologjinë, sociologjinë, biografinë etj. Metoda të tilla si historike, psikologjike, biografike, marksiste, psikanalitike etj synojnë të interpretojnë letërsinë në një kontekst të caktuar, pra një vështrim thjesht shkaku dhe **qasja e brendshme** e konceptuar mbi bazën e teorisë së formalizmit rus e gjerman, metodës franceze të interpretimit të tekstit, drejtimit të kritikës së re amerikane si dhe të shkollës strukturaliste të Pragës. Duke njohur rezultatet e këtyre metodave ... nxirret në plan të parë kuptimi i brendësisë së veprës në aspektin e poetikës letrare”.*(Dado,2003:22).

Por ajo që është më e rëndësishme, të gjitha këto, pra edhe tekstet edhe përzgjedhja mbi analizën e tyre, janë parë në një fokus më të gjerë duke përfshirë në këtë mënyrë edhe analizën krahasimtare mes asaj që mund ta quajmë lëndë, dhe qëndrimeve teorike të shumta, rreth çështjes kombëtare, identitetit kombëtar, nacionalizmit e nacionales. Vetë këto teori janë parë në prezantim krahasimtar dhe përmes një analize empirike, duke gërshetuar në të

njëjtën kohë *explication de texte* me *close reading*, “... pasi analiza kërkon njohjen e elementëve të strukturës së tekstit letrar dhe të raporteve me kontekstin”, (Dado,2003:24), si e vetmja mënyrë me të cilën mund të analizojmë ndërtimin e identiteteve dhe të konkludojmë rreth qëndrimit të Agollit në veprën e tij dhe në çështjet e identitetit kombëtar. Shumësia e teorive dhe qëndrimeve ndaj nacionalizmit dhe identitetit kombëtar, si dhe mungesa e plotë e distancës që një teori duhet të ketë me një vepër në marrëdhëniet që krijohen mes tyre (për faktorët që krijojnë këto marrëdhënie do flasim më gjerë), kërkon një shumësi qasjesh ndaj tekstit, për arritjen e rezultateve të pritshme shkencore. “*Analiza ka në themel të saj dhe sintezën, që do të thotë se praktika e analizës letrare realizon kombinimin e analizës me sintezën, por analiza nënkupton gjithashtu që ajo të konceptohet si reflektim i një përvoje letrare, që ka arritjet dhe mënyrat e veta të ndërtimit*”. (Dado,2003:24). Kjo përsa i përket analizës letrare të tekstit pasi për analizën e ligjërimit ka kritere të tjera. Prirjet e këtyre teorive në kohën e sotme janë trajtuar me kujdesin e ruajtjes së ekuilibrit të trajtimit e qasjes në nivel politik e filozofik, me atë të karakterit artistik e letrar.

2.3 Ligjërimi si praktike sociale dhe si formë e shprehjes në letërsi.

Ligjërimi nuk është thjesht komunikim, por ai e strukturon realitetin dhe e modifikon atë. Ligjërimi është një fenomen social sepse ekziston një lidhje dialektike mes tij dhe shoqërisë. Vënia në praktikën ligjërimore të projekteve politike e nacionaliste duhet patjetër të shpjerë në pranimin nga masat të ligjërimeve të mëdha. Si i tillë, ky rrafsh i përket të ashtuquajturës praktikë sociale. Këtu proceset e komunikimit janë shoqërisht të përcaktuara nga një bashkësi lidhjesh socio-ekonomike, politike e kulturore. “*Prandaj analiza e ligjërimit është një metodologji e dobishme për t’iu përgjigjur pyetjeve me karakter specifik gjuhësor, po aq*

sa dhe sociologjik për qëllime si përshkruese ashtu edhe kritike”. (Johnstone, 2008). Të dyja këto lloj pyetjesh janë në themel të pyetjeve kërkimore të punimit tonë. Në këtë punim do të analizojmë identitetin sa në aspektin individual aq dhe në aspektin kombëtar (fokusuar te ky i fundit madje më tepër, pasi identiteti kombëtar prevalon mbi atë individual) duke analizuar ligjërimin, sepse “... *ligjërimi ka një anë individuale e një anë shoqërore, të cilat s’mund të mendohen veçmas*”. (Saussure, 2002:19). Fairclough thotë se gjuha është pjesë e pandarë e jetës shoqërore, të cilat lidhen me pjesë të tjera të saj dhe në marrëdhënie simbiotike me to. Sipas tij, duke qenë se ligjërimi kontribuon në mënyrë vendimtare në ndërtimin e realitetit ku jetojmë, ai vetë (ligjërimi) është një praktikë sociale. Duke folur për lidhjen e aspektit social me gjuhën dhe marrjen në konsideratë të procedeve ligjërimore, Fairclough thotë se kjo nuk është shfaqje e një koncepti të gabuar që e zvogëlon jetën shoqërore drejt gjuhës duke treguar se gjithçka që tregohet brenda shoqërisë është ligjërim. Analiza e ligjëritimit merret me gjuhën në përdorim si proces, sepse ligjërimi përmbledh në vetvete si procesin e krijimit, edhe tekstin dhe procesin e tij të interpretimit. Duke qenë kështu, ligjërimi është dukuri shoqërore, sepse merret me jetën e gjuhës në shoqëri. *"Analiza Kritike e Ligjëritimit e sheh ligjërimin - përdorimin e gjuhës në të folur dhe të shkruar - si një formë e "praktikës sociale". Duke e përshkruar ligjërimin si praktikë sociale, kjo nënkupton një marrëdhënie dialektike mes një ngjarjeje të veçantë diskursive dhe gjendjes (a), institucion (s) dhe strukturës sociale (s), e cila e kornizon atë: Ngjarja ligjërimore është formuar nga ana e tyre, por edhe forma e tyre. Kjo, sepse ligjërimi është shoqërisht konstitutiv, po aq sa dhe kushtëzues shoqëror. Ai konstituon situatat, objektet e dijes dhe identitetet sociale, si dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve dhe grupeve të njerëzve. Është konstitutiv si në kuptimin që ai ndihmon për të mbështetur dhe për të riprodhuar status*

quo-sociale, por dhe në kuptimin që ai kontribuon për ta transformuar atë". (Fairclough & Wodak, 1997: 258). Në teoritë e komunikimit hasim dy perceptime të analizës kritike të ligjërimit: me shkronja të vogla e me shkronja të mëdha. "Analiza kritike e ligjërimit (me shkronja të vogla) i referohet disa qasjeve të ndryshme që mund të përfshijnë veprimin e orientuar të analizës së ligjërimit, analizën rrëfimtare, analizën retorike, analizën e ligjërimit të komunikimit publik, analizën etnografike, analizën e lidhjeve etj. Analiza Kritike e Ligjërimit (me shkronja të mëdha) u referohet studiuesve që e lidhin punën e tyre me teoritë dhe metodat e Fairclough, Wodak, Van Dijk dhe Leuween. Të dyja janë të lidhura me pushtetin dhe privilegjin si dhe me marrëdhënien mes ligjërimit dhe strukturave sociale". (Trainor & Graue, 2013:66). Në punimin tonë do tu referohemi të dyjave, secilës me veçoritë e saj themelore.

E veçanta e këtij punimi është fakti i fokusimit tek koncepti i identitetit kombëtar, përdorimi i teknikave të ligjërimit dhe i procedeve letrare për tua veshur personazheve këtë identitet. Konstatojmë këtë bazuar dhe në mendimin e Fairclough se *"Ligjërimi në letërsi është interesant sepse marrëdhëniet e pushtetit të gjeneruara prej tij janë shpesh të paqarta dhe ekzistojnë arsye për ta parë atë në prizmin e marrëdhënieve të fshehta të pushtetit brenda ligjërimit". (Fairclough, 1989:49). Ligjërimi shërben si mjet për të kontrolluar dijen apo të vërtetën dhe për pasojë prezantohet si mjet për ndikim dhe pushtet. Në çdo shoqëri, ligjërimi vihet nën kontroll, selektohet, organizohet dhe lëviz përmes disa procedurave, roli i të cilave është të rregullojnë ndikimin e ligjërimit, të parandalojnë dëmet që mund të vijnë prej tij dhe të zbusë peshën e tij materiale. Gjithsesi më tepër se sa pushtet dhe kontroll, në punim do të na duhet të merremi dhe të shpjegojmë tipare të tjera të brendshme gjuhësore ndërthurur me*

faktorë të tjerë shoqërore jashtëgjuhësorë. Të gjithë këta bashkëveprojnë duke bërë që ligjërimi të kontrollojë dijen dhe të vërtetën dhe realizon kështu pushtetin mbi të tjerët.

Ky punim do të analizojë veçoritë gjuhësore të personazheve dhe situatave (fjalëve që autori u vesh me apo pa vetëdije). Analiza Kritike e Ligjëritimit, duke e studiuar gjuhën në proces, gjuhën si praktikë sociale përmes prodhimit dhe interpretimit të ligjëritimit, tenton të shpjegojë vendin dhe rëndësinë që ka secili personazh duke parë mënyrën sesi gjuha përdoret për të sendërtuar apo dalluar një personazh nga tjetri, rëndësinë që ka kjo formë ligjërimi dhe çfarë sjell në kontekstin e praktikave sociale, në rastin konkret, rindërtimin e identitetit kombëtar. *“Gjuha –sipas Fairclough –është proces që bashkëjeton me elemente shoqërore jogjuhësore dhe kushtëzohet edhe prej tyre”.*(Fairclough,2003:22). Ky kushtëzim vërehet përmes asaj që Fairclough e quan *member resources* apo burimet e pjesëmarrësit të cilat janë burimet që përdor pjesëmarrësi në ligjërim për të interpretuar tekstin. Këtu futen njohuritë gjuhësore, njohuritë për pasqyrimin përmes gjuhës, gjuha, prirjet, shijet apo interesat e marrësit gjatë interpretimit të ligjëritimit

“Gjuha, më mirë se gjithçka tjetër, jep shpesh dritën ose mjerimin e një kohe” – thotë Ismail Kadare. Teoritë e komunikimit thonë se ligjërimi nuk është mesazhi që përmban fjala, kuptimi semantik i thënies, por ligjërimi ka anën e dukshme që është thënia apo teksti i shprehur me fjalë, por ka dhe anën e padukshme që janë procedurat e përdorura për ta kontrolluar ligjërimin. Në këtë punim do të referohemi të dyja qasjeve për të zbuluar dhe analizuar identitetin (kombëtar) në morinë e heronjve të Agollit. Gjuha e Agollit është e thjeshtë, e papërpunuar me fraza të kapshme e frazeologji që duket sikur dalin nga toka, nga balta, gjë që e bën gjuhën e Agollit të ketë një lloj pushteti me anë të të cilit kërkon të pushtojë dhe dominojë lexuesin e vet. *“Ligjërimi nuk është thjesht ai që përkthen luftat apo*

sistemet e dominimit, por ai për të cilin e përmes të cilit luftohet, pushteti të cilin kërkojmë ta zotërojmë”. (Foucault, 1971).

Duke qenë se ligjërimi nuk është vetëm funksion por është edhe strukturë, kjo e fundit ka të bëjë me formimin e fjalëve dhe me organizimin e tyre në njësi më të mëdha gjuhësore (ligjërimore) si sintagma, fraza, fjalia, teksti dhe konteksti dhe përveç të gjitha këtyre edhe në përdorimin e frazeologjive dhe shprehjeve popullore. *“Nga perspektiva e konstruktivizmit, realiteti krijohet përmes komunikimit dhe praktikës së zbatuar. Prandaj, teoria e ligjëritimit shërben për të shqyrtuar krijimin ligjërimor të të kuptuarit e botës materiale; mirëpo ligjërimi është jo vetëm një mori e strukturuar e kuptimeve të ndërtuara, por edhe si proces i ndërtimit të kuptimeve”. (Tomiç, 2011: 5/9).* Pikërisht në të gjitha këto do ta kërkojmë identitetin personal dhe kombëtar në personazhet e veprave të pelegrinit të letërsisë shqipe, Dritëro Agollit.

2.4 Ndërtimi i identiteteve përmes ligjëritimit-Ligjërimet nacionaliste.

“Ligjërimi nënkupton kurdoherë një sistem të përcaktuar dhe diçka në zhvillim e sipër; ai është krijim i së tashmes sikurse është dhe frut i së kaluarës. (Saussure, 2002:19). Sipas Andre Martine, ligjërimi është institucion njerëzor, ashtu siç janë institucione edhe familja, shkolla, gjykata etj. Parë kështu ne arrijmë të shpjegojmë se përmes gjuhës së përdorur në ligjërim, identitetet legjitimojnë vetveten. Gjuha që ne përdorim dhe ligjërimi që aplikojmë në marrëdhëniet me të tjerët, tenton jo vetëm të përcjellë informacion, por edhe të sigurojë të mira sociale. E thënë kështu, ligjërimi është instrument që krahas të tjerash na ndihmon të sigurojmë të mira sociale, duke bërë gjëra të ndryshme dhe duke shfaqur veten, vlerat që mbartim, pra identitetet tona. *“Këto përfaqësime sociale të cilat mund të definohen si*

"korniza kolektive të perceptimeve" shërbejnë si një urë mes sistemit të shoqërisë dhe sistemit konjitiv të individëve. Me fjalë të tjera, përfaqësimet sociale dhe idetë e përbashkëta (ideologjia), ndikojnë mbi njohjen e veprimit/ndërveprimit dhe janë të ndërtuara si subjekt i ndryshimeve dhe ruajnë varshmërinë reciproke". (Wodak, 2008:25). Pikërisht në këtë aspekt, do të na duhet të fokusohemi në punimin tonë, duke vërtetuar krijimin dhe shprehjen e identiteteve (në këtë rast personazheve të Agollit) përmes ligjërimit. Duke marrë në konsideratë këtë, do të shohim nivelin e ligjërimit, nivelin e njësive që tejkalojnë fjalinë dhe periudhën, duke u përqendruar në gjuhësinë postsusuriane, dhe për pasojë, ky fokus, do të na orientojë të operojmë jo vetëm me instrumenta gjuhësorë por edhe koncepte të mbartura nga shkencat sociale, në këtë rast nga sociologjia apo deri diku dhe antropologjia.

Historikisht tregimet, mitet, dhe manifestimet e tjera kulturore si muzika dhe artet pamore, teknologjia, kuzhina dhe veshjet kombëtare përbejnë atë që quhet kulturë kombëtare. Cdo periudhë kohore, çdo epokë historike, ka shprehur në një mënyrë apo një tjetër peshën e identitetit kombëtar përmes ligjëtimeve me frymë dhe natyrë nacionaliste dhe format dominuese në këtë sistem ideologjik. Kur themi kështu, nuk pretendojmë që ligjërimi është faktori i vetëm dhe më kryesor në krijimin dhe ruajtjen e grupeve dominuese (themi dominuese sepse gjithmonë një grup dominon mbi një grup tjetër e kështu me radhë), por për këtë na vjen në ndihmë dhënia përparësi e faktorëve social-ekonomikë, politikë e historikë. Teun Van Dijk e përkufizon mbizotërimin si *"... ushtrim të pushtetit social nga elitat, institucionet apo grupet, ushtrim që rezulton në pabarazi sociale duke përfshirë këtu pabarazinë politike, kulturore, klasore, etnike, racore dhe gjinore". (Van Dijk, 1988:37).*

Po ta vëmë re, kjo është padiskutim skena që dominon më së shumti në periudhën historike të Realizmit Socialist. *"Prapëseprapë regjimet komuniste nuk mund të bënin pa*

nacionalizmin, si ligjërimit për identitetin dhe sovranitetin e kombit, por duke e emërtuar si patriotizëm socialist”.(Sulstarova, 2015:60). Padyshim që dominimi apo mbizotërimi praktikohet dhe riprodhohet vetëm dhe përmes gjuhës. Historia e Shqipërisë, duke kaluar në periudha të ndryshme të saj, njeh dhe ka patur dhe format e veta të shprehjes përmes ligjërimit nacionalist, por formën e tij më të plotë e mori në shek XIX me dishepujt e Rilindjes Kombëtare shqiptare, dhe kjo e nxitur nga ligjërimet nacionaliste të vendeve ku elita shqiptare e kohës kishte emigruar, jetuar e punuar, dhe se “...me krijimet e tyre letrare e shkencore, ata sollën në Shqipëri një tip të ri kulture, një kulturë laike me përmbajtje dhe tendenciozitet të thellë atdhetar”. (Sulstarova vep. cit,2015:29). Kjo vërteton më së miri faktin se ligjërimet nacionaliste për herë të parë u nxitën dhe u frymëzuan nga parimet intelektuale të klasës intelektuale shqiptare, e cila më së shumti ishte arsimuar dhe kulturuar jashtë vendit, që herët. “Nacionalizmi shqiptar është shfaqur që me Rilindjen Kombëtare, e cila ishte një lëvizje kulturore e politike për formimin dhe përhapjen e vetëdijes kombëtare shqiptare dhe për themelimin e një shteti kombëtar. Roli i Rilindjes për nacionalizmin shqiptar është i pazëvendësueshëm, sepse intelektualët dhe aktivistët e lëvizjes kombëtare të asaj epoke krijuan përfytyrimet, idetë, mitet dhe synimet politike të kombit shqiptar”.(Sulstarova, Intervistë dhënë gazetës Shqip, datë 12 shkurt 2016).

Nëse analiza e ligjërimit e konsideron gjuhën si një mjet apo instrument për të ndërtuar identitete, ligjërimit shërben për të ndërtuar një identitet në kohë dhe në një vend të caktuar. Në rastin tonë do të analizojmë ligjërimin që krijon identitetin kombëtar në veprën e Dritëro Agollit, në letërsinë shqipe të Realizmit Socialist, thënë ndryshe një identitet kombëtar me nota të theksuara të ligjërimit kombëtar pra ligjërimit nacionalist. Mirëpo edhe kjo ka kërkesat e veta pasi kjo letërsi nuk është studiuar mjaftueshëm dhe se “*Sqarimi i plotë dhe i*

saktë i rrugës së letërsisë shqipe të Realizmit Socialist nuk mund të bëhet si duhet pa ndriçuar në mënyrë të qartë si është mbështetur ajo në traditën letrare dhe si ka ecur në rrugën e vet të forcimit të frymës novatore, në faza të ndryshme të zhvillimit letrar”. (Mato, 1983:3). Duke ditur se ligjërimi në kuptimin e praktikës sociale nënkupton lidhjen mes një lloj ligjërimi dhe situatës së krijuar, kjo do të thotë që ligjërimi vendos një lloj pushteti mes marrëdhënieve dhe strukturave (institucioneve) sociale. Në hulumtimin tonë kjo përbën një lloj lidhjeje mes ligjërimeve nacionaliste dhe identitetit kombëtar. “Për ligjërimin nacionalist kombi dhe çështja e pazgjidhur kombëtare janë temat kryesore. Ligjërimi nacionalist dallohet nga ligjërimet e tjerë politikë prej faktit se në qendër të tij ndodhet kombi”. (Sulstarova, 2015:15-20). Duke qenë pjesë e kulturës popullore, studimet mbi identitetin janë të lidhura ngushtësisht me ligjërimet nacionaliste, sepse ato ndërtohen në bazë të një origjine të përbashkët që është miti. Asnjë kulturë popullore nuk e ka anashkaluar mitin gjatë historisë së saj, dhe për këtë qëllim ligjërimet nacionaliste me bazë mitin kanë qenë dhe mbeten pikë referimi e së tashmes mbi të shkuarën. “Ligjërimet nacionaliste përmbajnë një llojshmëri mitesh, por gjithmonë gjejmë mes tyre disa tema të pandryshueshme: mite të origjinës, mite të territorit, mite të kohës së artë, mite të rënies dhe mite të ringritjes”. (Smith, 1984:105). Mirëpo, duke qenë ideologjik, ligjërimi nacionalist i Realizmit Socialist anashkalon mitet tradicionale duke ndërtuar mite të reja në përshtatje me ideologjinë dominuese komuniste.

Duke ditur nga analiza e ligjërimit, që përmes ligjërimit nuk ndërtohet vetëm një identitet i vetëm, por një shumësi identitetesh, atëherë për punimin tonë vlen vetëm një i tillë, dmth identiteti kombëtar. “Shumë shpesh, diskutimet që merren me çështje të identitetit personal, qoftë në lidhje me racën, gjininë, fenë, apo kombin, zbresin shpejt në një opozitë "ne" dhe

"ata", që pushon për të bërë punën produktive dhe helmon shpresat e ndonjë pjesëmarrësi për një zgjidhje të kënaqshme të konfliktit". (Edy,2003:15). Duke qenë se në punimin tonë i jemi referuar teorisë primordialiste për të analizuar identitetin kombëtar në veprën e Dritëro Agollit, pohojmë me bindje se lidhja e Agollit me kombëtaren është e dukshme qartë kudo në vepër, sepse vërehet një lidhje e tipareve moderne të shoqërisë postkomuniste me kulturën dhe traditën pasi "...ligjërimi nacionalist mund të jetë modern, por ai ndërtohet me elemente simbolike të së shkuarës paramoderne që ruhen në traditat e etnive". (Sulstarova, 2015:21). Ligjërimet nacionaliste mbajnë gjallë frymën e kombit, idenë kombëtare dhe legjitimojnë identitetin kombëtar të gjithësecilit prej nesh. Është e vështirë sot të flasësh për ligjërimi nacionaliste, për vetë specifikën dinamike të ngjarjeve dhe situatave sa politike aq edhe sociale që ofrohen, por gjithsesi fryma kombëtare vazhdon akoma të ruhet gjallë dhe kjo përmes brezave të shumtë sidomos të emigrantëve të cilët vazhdojnë të mbajnë ndezur ndërgjegjen kombëtare. Kjo është dhe arsyeja se pse ndërmorëm nismën për të punuar mbi këtë temë, pra identitetin kombëtar, sepse vepra e Dritëro Agolli, ligjërimi nacionalist mbi të cilin ajo ndërtohet, është aktuale në kohë dhe si e tillë do të vazhdojë të jetë.

2.5 Instrumentet e analizës.

"Gjuha na lejon të bëjmë gjëra. Kjo na lejon që të angazhohemi në veprime dhe aktivitete. Ne u premtojmë njerëzve gjëra, ne kemi hapur mbledhjet e komisionit, ne u propozojmë të dashurve tane, ne argumentojnë mbi politikën, dhe "flasim me Zotin" (lutemi) dhe këto janë ndër gjërat e shumta që ne bëjmë me gjuhën duke dhënë dhe marrë informacion. Gjuha na lejon të jemi gjëra. Kjo na lejon për të marrë identitete të ndryshme e të rëndësishme shoqërore. Për të marrë çdo identitet në një kohë dhe vend të caktuar ne

duhet të "flasim" jo vetëm "të ecim në këmbë". Në gjuhë, ka lidhje të rëndësishme mes thënë (informuar), bërë (vepruar), dhe duke qenë (identiteti)." (Gee, 2011:9). Nisur nga këto konkludime të James Paul Gee, përcaktojmë se funksionet e gjuhës në varësi të modeleve të ligjërimit janë: funksioni konstatues, funksioni performues dhe funksioni identifikues. Thënë ndryshe, sipas studiuesve, këto dy funksione të fundit, ndryshe nga i pari, i faktuar shumë heret, përbëjnë dhe misionet ndërtuese të gjuhës, të cilat janë: 1. Rëndësia, 2. Praktik/aktivitetet, 3. Identitetet, 4. Marrëdhëniet, 5. Politikat (të mirat sociale), 6. Lidhjet, 7. Sistemet e shenjave. Për shkak të fokusit të studimit, punimi ynë fokusohet në gjashtë prej tyre që janë Rëndësia, Praktik, Identitetet, Marrëdhëniet, Politikat dhe Lidhjet (ndërlidhjet), të cilat shoqërohen me pyetjen specifike përkatëse, që i vijnë në ndihmë zgjidhjes së hipotezës dhe pyetjeve kërkimore, duke i ardhur kështu në ndihmë të gjithë analizës së punimit tonë.

Teun Van Dijk përcakton "... se ligjërimi, në një kuptim më të gjerë, është një bashkim kompleks i formës gjuhësore, kuptim, dhe veprim që më së miri mund të jetë kapur nën nocionin e një ngjarjeje komunikuese apo akti komunikativ". (Van Dijk, 1988:8). Nisur nga kjo duhet të përcaktojmë së pari se kush e thotë një thënie të caktuar, duke përforcuar identitetin (e tij dhe atë kombëtar) dhe sa e rëndësishme është kjo thënie për rolin e secilit personazh. Së dyti në cilën praktikë, ky ligjërim dominon më shumë se në një praktikë tjetër dhe çfarë situatash krijon ai. Së treti, ajo që është dhe fokusi i punimit tonë, si ndikon ky ligjërim në krijimin e identitetit të folësit, dhe se si e ndihmon ky ligjërim folësin t'u atribuojë të tjerëve identitetin e tij. Së katërti, duke qenë se ligjërimi krijon marrëdhënie, themi se çfarë lloj marrëdhënieje synon të ndërtojë një thënie e një personazhi, forma e tij e ligjërimit, me të tjerët. Duke qenë se të mirat sociale janë gjithçka që një person a një grup

personash vlerësojnë dhe aspirojnë të kenë, atëherë së **pesti**, fokusohemi tek misioni tjetër i gjuhës duke shpjeguar se çfarë synimi sheh apo komunikon kjo thënie duke ndihmuar në dhënien e të mirave sociale. Dhe së **gjashti**, duke qenë se me anë të gjuhës dobësojmë apo forcojmë lidhje, shpjegojmë nëse krijon lidhje një thënie e caktuar, si i lidh personazhet apo situatat dhe si ndikon tek një situatë tjetër ligjërimore apo jo, mes personazheve. *“Kur analizojmë lloje të veçanta ligjërimi, qëllimi ynë është përqendruar jo vetëm në anën e mundshme, por edhe mbi strukturat gramatikore që karakterizojnë përdorimin e gjuhës në një formë të tillë të ligjërit. Kjo do të thotë që ne në mënyrë të nënkuptuar bëjmë krahasimin e tyre për përdorimin e gjuhës në llojet e tjera të ligjërit apo kontekstit, e cila përsëri presupozon të jetë variant i mundshëm i strukturave gramatikore në kontekste të ndryshme. Është ky variacion që është baza e stilistikës, një disiplinë që jo vetëm përshkruan variacionet e mundshme për lloje të ndryshme ligjërimore, por që në qëllimet e veçanta, të llogarisë marrëdhëniet mes ndryshimeve të tilla dhe konteksteve personale e sociale të përdorimit të gjuhës”.* (Van Dijk, 1988:10).

E kemi përmendur edhe më sipër që, përveç qasjeve teorike të analizës kritike të ligjërit, të huazuara nga James Paul Gee dhe Teun Van Dijk, do të marrim në konsideratë dhe elemente të analizës nga qasja historike e Ruth Wodak, përmes së cilës do të analizojmë kontekstin social e historik si qasje e ligjërit me faktet dhe idetë historike të kohës sepse:

1. Qasja është e orientuar tek problemi, jo e fokusuar në çështjet specifike gjuhësore.
2. Qasja është interdisiplinare.
3. Qasja është huazuese, një lëvizje konstante poshtë e lart, midis teorisë dhe të dhënave empirike është e domosdoshme.

4. Kategoritë dhe mjetet e analizës janë përcaktuar në përputhje me të gjithë hapat dhe procedurat po aq mirë sa dhe problemi specifik nën vëzhgim.

5. Aplikimi i saj ka një qëllim. (Wodak, 2010:14).

Kështu, nëse Wodak flet për një qasje ligjërimore që ka në themel të analizës makrostrukturat që lidhjen me ligjërimin në një kontekst të caktuar social dhe historik, prej saj huazojmë pikërisht përqasjen tematike dhe kuptimin e një ligjërimi specifik siç në rastin tonë është ligjërimi mbi identitetin kombëtar apo ligjërimi nacionalist.

Teoricienë e studiues të ndryshëm i përzgjedhin vetë dhe u japin rëndësi atyre elementeve të cilat ata mendojnë se i përshtaten më mirë fokusit të tyre të analizës. Në rastin konkret, duke qenë se jemi në rrafshin e analizës kritike të ligjërit, na duhet të marrim për analizë instrumenta të cilat vijnë nga qasja socio- konjitive e Teun Van Dijk. Sipas tij, për të analizuar një ligjërim të caktuar, duhet patur parasysh qëllimi me të cilin kemi marrë përsipër të bëjmë këtë analizë mbi ligjërimin e përdorur sepse “...Ligjërimi luan një rol themelor në shprehjen e përditshme dhe riprodhimin e ideologjive e në veçanti mënyrave se si ideologjitë ndikojnë nivelet e ndryshme të strukturave të ligjërit, nga intonacioni, sintaksa dhe imazhet në shumë aspekte të kuptimit, të tilla si tema, koherenca, paramendimet, metafora dhe argumentimi, në mesin e shumë të tjerave”.(Van Dijk,1988:24). Nga ky teoricien kemi marrë konceptet që lidhen me:

- 1) përzgjedhjen leksikore- pjesë të ndryshme të ligjëratës si emra, mbiemra për të emërtuar konceptet identitare dhe foljet për të sqaruar veprimet dhe situatat që krijohen në ligjërimet mbi identitetin.
- 2) sintaksa ligjërimore, përmes së cilës do të analizojmë lidhjen e fjalive në strukturën ligjërimore sipas kontekstit të dhënë/krijuar.

Analiza e veprave të Agollit do të ketë në bazë të saj fjalën. *“Në këtë lloj analize, pasi veçohet një periudhë e caktuar historike, punohet për të studiuar leksikun e kësaj periudhe në raport me sektorë të tjerë të shoqërisë: jetën politike dhe shoqërore, me publicistikën, artin, shkencën etj me qëllim që të zbulohen strukturat leksikore për të shpjeguar një shoqëri”*. (Trere & Gallegati, 1990:23).

Studiuesit S. Trere dhe G. Galligati mbështesin idenë e: **a)fjalëve dëshmi** dhe **b)fjalëve kyçe (çelës)**. Të dyja këto janë me rëndësi në punimin tonë pasi na ndihmojnë ti kthejmë përgjigje pyetjes së tretë kërkimore që lidhet me fjalët që përdoren më dendur dhe dominojnë ligjërimin për të shprehur identitetin kombëtar. Fjalët dëshmi janë elemente ligjërimore në funksion të të cilave organizohen strukturat leksikore. Përmes kësaj, në çdo sektor të shoqërisë në një periudhë të dhënë dalin dhe dominojnë fjalë që dëshmojnë dhe pasqyrojnë nocione të reja, të cilat shfaqen në shoqëri dhe përcaktojnë një koncept të dhënë. Ndërsa fjalët çelës janë fjalë që tentojnë të shprehin në mënyrë sintetike një shoqëri, ato janë njësi leksikore që shprehin gjithçka tek të cilat shoqëria njih idealet e saj.

“Gjetja dhe përcaktimi i fjalëve çelës shërben për të zbuluar strukturat leksikore të një teksti a ligjërimi si dhe vetë strukturën tematike të tij. Gjetja dhe përcaktimi i dendurisë së përdorimit të disa fjalëve, të afta për të organizuar një fushë semantike të caktuar, arrin të na zbulojë temat, problemet, interesat e ligjërimin dhe së bashku me to edhe ato të shkrimtarit”. (Trere & Gallegati, 1990:23). Përdorimi i kësaj qasjeje do të na ndihmojë ti kthejmë përgjigje pyetjes kërkimore se: Cilat janë fjalët që përdoren më dendur në ligjërim për të shprehur identitetin kombëtar dhe në përpunimin e të dhënave të tabelës së dendurisë së variablave bazë dhe variablave sinonimikë, përmes analizës së përmbajtjes.

KAPITULLI III. KONTEKSTI HISTORIK - QASJE DHE TEORI MBI IDENTITETIN KOMBËTAR.

*Nëse njeriu nuk ndien as kënaqësi as dhimbje
Nuk ndien as gaz, as hidhërim, as shpresë.....
Një gjë po jua them me ndershmëri dhe bindje
Lëreni të vdesë.*

– Dritëro Agolli-

3.1 Debate mbi identitetin kombëtar.

Historia moderne na ka treguar që doktrinat, teoritë, tezat dhe hipotezat e ndryshme, sidomos ato që gjallojnë në shkencat humane, janë gjithnjë të diskutueshme. E nga e gjithë kjo laryshi teorish e dogmash, padyshim që debatet mbi identitetin, mbi kombin, etninë, nacionalizmin e nacionalitetin zenë edhe sot kryet e vendit. *“Përkatësia ndaj një vendi ka një ndikim të madh në adaptimin dhe forcimin apo dobësimin e identiteteve të tjera si psh identiteti social. Pra, identiteti kombëtar determinon identitetin social. Është ndjenja e bashkësisë dhe e tërësisë, e cila bazohet në harmonizimin e sjelljes, veprimeve dhe gjytimeve të njerëzve” (Wheelis, 1958:27).*

Bota moderne, sot, ende nuk ka definuar një përcaktim unik, të pakorrigjueshëm dhe të pa komentueshëm mbi identitetin. Teori dhe qëndrime të shumta diskutohen gjallërisht nëpër qarqet shkencore në nivel akademik, sikur edhe në qarqe politike. Ky është një problem i hapur, i cili trajtohet gjerësisht edhe në art, letërsi, folklor, sigurisht përmes gjuhës figurative (konotacionit) dhe një elementi që pothuaj mungon në trajtesat e tjera, ndjenjave e emocioneve. Duke qenë kështu, ne mund të konstatojmë lirisht që problemet e identitetit,

nacionalizmit, etnicitetit, kombit, janë problemet më të debatueshme, ku grupe të ndryshme interesash mbajnë qëndrime të ndryshme.

Nga ky debat padyshim që dalin në sipërfaqe vlera të njëmendëta të mendimit shkencor botëror, gjë që na shërben edhe neve në punimin tonë. Kjo do të thotë që, përveç vlerave të padiskutueshme të këtyre teorive e qëndrimeve që përbëjnë një njësi monokromatike të shfaqjes së universit teorik në rrafsh filozofike, pas shpërfaqjes së tyre në botën akademike dhe pas Luftërave Botërore të Shekullit XX, të shpërthejnë “ngjyrat” e qëndrimeve e përcaktimeve. *“Shekulli XX na ka mësuar se asnjë doktrinë nuk është në vetvete, domosdoshmërisht çlirimtare, të gjitha mund të përçudnohen, të gjitha i kanë larë duart me gjak si komunizmi, liberalizmi, nacionalizmi...”*. (Maalouf. 2006:50). Kjo lidhet me faktin se, përmes qëndrimeve të reja teorike, synohet një qëndrim tjetër, ai praktik në ekzistencën e kombeve, etnive, dhe nacionalizmit duke u realizuar ajo lidhje praktike e domosdoshme që na çon drejt identitetit, këtij *“miku të rremë”*- siç vëren Maalouf. (Maalouf.2006:35).

“Po të vështrosh shumë thellë në Ferr, Ferri do të të vështrojë ty”- thotë Nitzche. Shekulli që lamë pas na solli veçse shumë shpresa edhe shumë dëshpërim. Nëse përmendim disa nga momentet më të rëndësishme të këtij shekulli që na vunë përpara mendimesh, qëndrimesh e përgjegjësish të paimagjinueshme më parë, ku edhe tradita mbeti e verbër, kemi:

a) Zhvillohet Lufta e Parë Botërore, për të cilën nuk do të ndalemi në faktorët që e stimulojnë, as në raportet e forcave pjesëmarrëse dhe as në fitimtarët apo të humburit pasi të gjitha këto janë objekt studimi i shkencës së historisë. *“Ndërhyrja apo intervenimi i shtetit modern formëson ndërtimin e identitetit kombëtar”*.(Hobsbawm, 1991:44 vep.cit). Është pikërisht reagimi, që pasoi pas përfundimit të saj, në mendimin teorik e shkencor, në qëndrimin që paraqitet rreth identitetit, nacionalizmit, kombit, sepse nxori në pah edhe

qëndrimet diametralisht të kundërta në rrafshin teoriko-filozofik për përcaktimin e nacionit, nacionalitetit, etnisë, kombit dhe për pasojë edhe të identitetit kombëtar. Është një lëvizje e gjerë, sa horizontale, pra gjeografike, aq edhe vertikale, pra teorike (kupto: politike), pasi: *“Kukuvajka e Minervës, ajo që sjell urtësinë, e fillon fluturimin në muzg. Është shenjë e mirë që tani po vërtitet përmbi kombet dhe nacionalizmin”* - thotë Hegel.

b) Në këtë periudhë siç vëren Adam Smith, *“Kristalizohen rrugët për depolitizimin e kombit përmes, 1) ndarjes së nivelit kulturor të kombit prej nivelit politik të shtetit (folklori, etniciteti, romantizmi i shek. XIX), duke humbur përmasën politike, 2) çmilitarizimit, 3) normalizimit të kombit dhe vitalizimit përmes nivelit të simbolikës, konkurrencës paqësore, artit etj”*. (Smith.2008:23). Është një qëndrim që mbart në vetvete një dualitet të dukshëm që shfaqet përmes marrëdhënieve reciproke dhe që përmban veç të tjerash edhe rreziqe. *“Njerëzimi i ka ndërtuar të dyja, si katedralet edhe kampet e përqëndrimit”*. (Stoessinger.2007:371). Në këtë rast e kemi fjalën për dy lloje rreziqesh, për atë të nivelit teorik dhe tjetri i nivelit praktik.

c) Le ta quajmë rishqyrtim të qëndrimeve pasi të kesh një shumësi faktesh të cilat kërkojnë të shikohen edhe mund të ndodhë që nga ky rishqyrtim përfundimet të jenë ndoshta edhe krejtësisht të kundërta me ato qëndrime të mëparshme. Epoka, për të cilën po flasim, është një *“epokë e vetvendosjes kombëtare”*. (Stoessinger.2007:247) sepse: *“Era moderne popullore i ngjet një Palimpsesti në të cilin janë regjistruar përvojat, identitetet e epokave të ndryshme dhe një larmi formacionesh etnike, ku të parët ndikojnë dhe modifikohen prej atyre të fundit, për të prodhuar tipin e përbërë të njësisë kulturore kolektive që ne e quajmë komb, por që në themel mbetet baza e konfliktit sot”*. (Smith.1991:72). Prania e këtij

rishqyrtimi krijon mbi sistemin filozofiko-teorik, që pasurohet me qëndrimet mes dy Luftrave Botërore, për të mbërritur në një qëndrim më të universalizuar në kohën e sotme.

d) *“A është e mundur që koncepti dhe realiteti i kombit të jetë në fund të fundit, i përjetshëm, perenial, dhe si i tillë të përcaktojë vështrimin tonë në histori, përfshirë edhe Erën moderne”?*(Smith.1991:65). Apo do të pranojmë që, meqë, *“historia avancon në çdo moment në një pafundësi rrugësh”*, (Maalouf.2006:93), atëherë është e mundshme që t’i rikthehem Heraklitit kur ai konstaton se *“Çdo gjë rrjedh/ Panata rhei”*.

e) Lufta e Dytë Botërore është ajo që i avancoi më tej këto qëndrime. Pas përfundimit të saj, shumë studiues u thelluan në shkaqet e brendshme e të jashtme që e provokuan atë. *“Historia na jep çelësin për një strategji të suksesshme”* (Stoessinger.2007:365).. Neve na intereson sa dhe si ndryshoi mendimi teorik mbi identitetin kombëtar, kombin, etninë, nacionalitetin, gjë që padyshim reflektohet edhe në ndryshimin e hartimit të strategjive sa globale, aq edhe kombëtare.

f) Përmbledhur, këto do të mund t’i paraqisim si debate që zhvillohen mes dy qëndrimesh:

1) dialektik, 2) metafizik. Raporti që krijohet mes këtyre forcave i jep kuptim të gjitha qëndrimeve që janë mbajtur në konfliktet e hapura e të mbyllura mes palësh, ku në shumicën e herës, janë kombet, ruajtja e identitetit të tyre, pavarësia etnike, shtetformimi në bazë të disa principeve që rrjedhin pikërisht nga interpretimi i këtyre faktorëve të këtij raporti. *“Identiteti është një përshkrim i përkatësisë dhe ekzistencës. Ai përbëhet nga dy shtylla kryesore, identifikuesi dhe i identifikuari. Kjo do të thotë që individ i specifikohet si vetja dhe shoqëria si tjetri”*. (Eralp.1997:19). Ndërfutja e këtij raporti dhe bërja e tij një rol përcaktues në strategjitë e sotme identitare, përbën edhe një nga qëndrimet më të dukshme e më të debatueshme sot, në kohën e globalizmit.

3.2 Identiteti kombëtar mes Primordializmit dhe Konstruktivizmit

“Të gjitha identitetet ekzistojnë në ndryshimin e tyre. Nuk ka kulturë apo identitet kulturor që nuk ka në përmbajtje tjetrin e vetes”. (Derrida 1978 :129). Pavarësisht të gjitha këtyre, neve na duhet një përcaktim i cili përbën një bërthamë të qëndrueshme vlerash në mendimin bashkëkohor. Këto vlera na paraqiten: a) si një vijueshmëri lineare e mendimit. b) pavarësisht kontinuitetit të qëndrimeve të tyre. Sikur është vërejtur, *“dy janë drejtimet kryesore ku janë fokusuar këto qëndrime”*: a) **Primordialistët** b) **Konstruktivistët**. (Gellner.1997:78). Është një debat i prirur të japë argumente në favor të njërit qëndrim, ose të tjetrit, ku në varësi të rrethanave historike, herë del njëri në pah e herë tjetri. Fakti që shtetet kanë histori të gjatë, kulture dhe tradite, janë pikat kyçe në përdorimin e nënkuptuar të teorisë primordialiste.

Primordializmi është një shkollë e mendimit e cila argumenton se kombet kanë qenë gjithmonë aty dhe se ekzistenca e tyre historike mund të gjendet në historitë e tyre, në kulturën dhe në traditat. *“Me një shtojcë primitive është menduar për një të tillë që buron nga ekzistenca sociale,*

nga vazhdimësia dhe nga njerëz me lidhje të afërta, por të qenurit i lindur në një komunitet të caktuar fetar, duke folur një gjuhë të veçantë, apo edhe dialektin e një gjuhe. Këto congruities të gjakut, të folurit, zakonet dhe kështu me radhë, janë parë të kenë një paqartësi në vetvete. Dikush është i detyruar nga farefisi, ose të qenurit fqinj dikujt, dikush sepse është bashkëbesimtar, ose si rezultat jo vetëm i dashurisë personale, domosdoshmërisë praktike në pjesën më të madhe dikush i imponohet një papërgjegjshmëri absolute sepse i atribuohet shumë lidhjes me vetveten”. (Clifford.1994:31).

Sipas Ozkirimli, primordializmi është “*një çadër*” i cili përdoret për të përshkruar faktin se kombësia është, “*si diçka natyrore, ashtu siç është procesi i të folurit, të parit dhe të ndjerit dhe se kombet kanë ekzistuar që nga kohërat e lashta*”. (Ozkirimli.2000:64). Sipas tij, Primordializmi mund të ndahet në disa trende, bazuar në faktorët më të rëndësishëm për ekzistencën dhe për vazhdimësinë e një kombi. Disa pasues të primordializmit (qasja natyraliste) pretendojnë se kombet kanë ekzistuar gjithmonë dhe se njerëzit marrin identitetet e tyre kombëtare pas lindjes së tyre. Ata pohojnë se identitetet kombëtare janë të paracaktuara dhe nuk i nënshtrohen ndryshimeve. “*Nacionalizmi mban mendimin se bota përbëhet prej kombeve natyrore; se kombet janë themeli i historisë dhe aktorët kryesorë në dramën historike; se kombet dhe personazhet e tyre janë organizma që mund të konstatohet lehtësisht nga dallimet e tyre kulturore; që anëtarët e kombeve mund dhe shpesh herë kanë, humbur vetë-vetëdijen e tyre kombëtare së bashku me pavarësinë e tyre dhe se detyra e nacionalistëve është që ta rivendosin këtë vetë-vetëdije dhe pavarësinë e kombit nëpërmjet "rizgjimit organik"*. (Smith.1998:146).

Të tjerët, (qasja socio-biologjike) argumentojnë, se ajo që ka rëndësi, janë të afërmit dhe një marrëdhënie gjaku. Për ta një komb nuk është asgjë më tepër se një komunitet i gjerë farefisnor, i lidhur së pari nga marrëdhëniet e tij socio-biologjike me historinë, kulturën dhe traditat që janë praktikuar dhe janë respektuar nga anëtarët e komunitetit. “*Përgjithësisht, ata pretendojnë se grupet etnike dhe kombet duhet të shihen si forma të grupeve të zgjeruar farefisnore dhe që të dy kombet dhe grupet etnike, së bashku me "racat", në fund të fundit duhet të rrjedhin nga disqet të veçanta riprodhuese, gjenetike*” (Smith. 1998:150). Për Pierre van den Berghe, “*eksponenti kryesor i një qasjeje socio-biologjike të etnisë dhe të nacionalizmit, me modernitetin të kombit është thjesht formale, pra është një çështje për*

plotësimin e strukturave themelore që përfshin edhe forma politike. Koncepti i kombit është një zgjerim i 'zgjedhjes së të afërmit dhe kështu kombet janë prirur të trajtohen si grupe prejardhje në të njëjtën mënyrë si grupet etnike". (Berghe, 1987:147).

Një tjetër tendencë primordialiste (qasja kulturore) promovon idenë se një komb është i bazuar në ndjenjat individuale dhe në perceptime si besimi dhe besnikëria ndaj tij dhe anëtarëve të tij, lidhet me promovimin e traditave, të kultures etj. Për Ozkirimli *"primordializmi kulturor në një mënyrë mund përkufizohet si një qasje e cila fokusohet në kuptimin nga kuptimi që kanë vetë individët". (Ozkirimli,2000:73).* Walker Connor, përfaqësues i kësaj qasjeje, beson se perceptimet publike luajnë një rol të rëndësishëm për formimin e kombeve dhe argumenton se, *"... ajo që në fund të fundit ka rëndësi nuk është ajo që është, por ajo që njerëzit besojnë se është". (Connor,1994: 37).* Ozkirimli citon të ketë thënë Smith se *"... kombet moderne janë pasardhës të linjës së homologëve të tyre të Periudhës së Mesjetës. Sipas këtij këndvështrimi, ne mund të jemi vijim i të gjithë popujve në Mesjetë dhe në antikitet". (Ozkirimli,2000:69).*

Në kontrast me primordialistët, **modernistët** thonë se kombet janë konstrukte moderne. Historia e tyre do të mund të ndiqet në fillim të shekullit XIX, ndërsa ekzistenca e tyre mund të shpjegohet nga faktorë të tillë si erozioni i shoqërive monarkiste në harmoni me industrializimin, me anti-kolonizimin, me përplasjen ndërmjet tradicionalizmit e modernizmit, demokratizimit, si edhe dëshira për pushtet dhe përfitimet që ajo sjell. *"Sipas kësaj qasjeje, kombet dhe nacionalizmi u shfaqën në dy shekujt e fundit, në prag të Revolucionit Francez dhe këto janë rezultatet e revolucionit industrial, kapitalizmit dhe lindjes së shtetit modern, Urbanizimit dhe sekularizmit". (Smith 1994:377).*

Modernistët nuk pajtohen me primordialistët në pretendimin se historia, kultura dhe traditat e një kombi janë pika kryesore në kohën e ekzistencës së tij. Këto janë shpikje të ndërtuara në veçanti nga elementet e shoqërive me synimin e qartë për arritjen e qëllimeve të caktuara. Një prej këtyre qëllimeve është ruajtja e pushtetit dhe legjitimitimi i regjimeve në sytë e shoqërive të konsoliduara kombëtare. Megjithatë, pavarësisht se është i ngjashëm në disa pika me primordializmin, modernizmi mund të ndahet në disa trende që sipas Ozkirimli mund të identifikohen si trende ekonomike, politike, dhe social-kulturore.

Pasuesit e trendit të parë argumentojnë se rezultate ekonomike, si pabarazia në zhvillimin dhe nxjerrja e burimeve nga periferitë kontribuojnë në ndarjen e shoqërive përgjatë linjave rajonale të nacionalizmit. *"Nacionalizmi lind në kërcënim dhe në shoqëritë e pazhvilluara, të cilat i ftojnë njerëzit në histori "dhe pastaj përdorin dhe modernizojnë kulturat e tyre të përditshme. Në këtë mënyrë ata janë në gjendje që të mobilizojnë masat rreth qëllimeve të zhvillimit të borgjezisë vendase". (Hutchinson, John: Smith, Anthony D.1994:47).*

Një tjetër trend brenda modernizmit argumenton se kombet dhe nacionalizmi e kanë origjinën dhe ekzistencën për shkak të faktorëve politikë duke theksuar se elitat politike përdorin ndjenjat kombëtare dhe ideologjitë me qëllim ruajtjen e pushtetit dhe përfitimet shoqëruese. Sipas Calhoun, *"Ky komb i shpikur shpesh herë është një vetë-vetëdije dhe manipulues, projekti realizohet nga elitat që kërkojnë të sigurojnë pushtetin e tyre duke mobilizuar pasuesit mbi bazën e ideologjisë nacionaliste. E vërteta mbi propozimin nuk është shumë e qartë dhe udhëheqësit nacionalistë shpesh herë manipulojnë ndjenjat dhe identitetet e pasuesve të tyre. Është gjithashtu shumë e qartë se kombet nuk janë qenie të përjetshme dhe të pranishëm si të tillë që nga fillimi i ekzistencës së tyre në kohë". (Calhoun, 1997:30).* Po kështu, edhe Hobsbawm, argumenton se "...kombi ishte një nga

shumë traditat "e shpikura" nga elitat politike, në mënyrë që elita politike të legjitimojë pushtetin e saj, revolucionin dhe demokracinë për një shekull".(Hobsbawm, 1990:82).

Pasuesit e qasjes social-kulturore besojnë se kombet janë formuar ose ndarë nga një pjesë e madhe e një komuniteti në rastin e mosekzistencës. Gellner argumenton se "*... nacionalizmi nuk është zgjimi i një fuqie të vjetër të fjetur. Në të vërtetë ajo është një formë e re e organizimit shoqëror, e bazuar e brendësuar thellë, ku edhe arsimi varet nga kulturat e larta, dhe mbrohet nga vetë shteti. Ai përdor disa kultura para-ekzistente, duke i transformuar përgjithësisht ato në proces, por të ndoshta nuk mund t'i përdorë të gjithë"* (Gellner. 2006:65).

Një tjetër përfaqësues i kësaj qasje moderniste, Benedict Anderson, argumenton se "*kombet moderne (dhe nacionalizmi) ia kanë borxh ekzistencën e tyre 'kapitalizmit të shtypur', për shkak të të cilit ideja e kombit ka qenë e shpërndarë për të gjithë publikun e gjerë. Për të një komb është një "komunitet imagjinuar", i cili ka ardhur në jetë për shkak të rënies të "bashkësisë fetare dhe sferës dinastike" që filloi në shekullin e XVII .(Gellner, Ernest, *Nationalism and Modernization from Hutchinson, John, Smith, Anthony, op cit, f. 63*). Siç bëhet e qartë, pra nacionalizmi qëndron në idenë e origjinës së shteteve kombëtare bashkëkohore.*

Nëse primordializmi i shikon kombet si subjekte historike, modernistët i perceptojnë kombet si krijime të kohëve të fundit, pasi ata shikojnë jo vetëm për faktet historike, por edhe për të afërmit dhe lidhjet e gjakut, marrëdhëniet, ngjashmërinë e kulturës dhe traditave, si edhe perceptimet publike të idesë së kombit. Modernistët i referohen forcave dhe rezultateve të industrializimit, synimit për të patur pushtet politik, shpikjen e miteve dhe traditave dhe i referohen në veçanti rëndësisë që ka "kapitalizmi i shtypur" duke synuar të propagandojnë idenë e kombit. Croce, për shembull, argumentoi se "*kërkesat praktike të*

cilat në themel të çdo gjykimi historik japin të gjithë historinë dhe karakterin e historisë bashkëkohore, sepse, megjithëse e largët në ngjarjet e kohës në këtë mënyrë tregoi se mund të duket të jetë historia një e vërtetë që referohet për të paraqitur nevojat dhe situatat e tanishme ku ndodhin ngjarje" (Croce, 1941:19). Në këtë pikë, Le Goff vë në dukje se "Historia përfshin një ristrukturim të së kaluarës, ristrukturim i cili është një subjekt social i strukturës ideologjike dhe politike në të cilat historianët jetojnë dhe punojnë. Në disa shtete historia ka qenë dhe është ende objekt i manipulimit të qëllimshëm nga ana e regjimeve politike që kundërshtojnë të vërtetën. Nacionalizmi dhe paragjykimet e të gjitha llojeve mund të kenë një ndikim në historinë e tyre për mënyrën si është shkruar ... ". (Le Goff. 1992:11). Identiteti në kohën e sotme vazhdon të jetë një çështje e debatuar edhe për faktin se bota po tenton gjithnjë e më shumë të shkojë drejt unifikimit të saj gjithëpërfshirës, e në këtë pikë të përcaktosh përkufizimin mbi identitetin bëhet e vështirë. Brenda këtyre dy qëndrimeve ka një diversitet të mëtijshëm qëndrimesh dhe një shumësi argumentesh nga të dyja palët, por ajo çka është e rëndësishme qëndrimet e tyre gjenden sot të grupuara qartazi. Kjo nga ana tjetër na ndihmon të hyjmë në analizën e veprës së Dritëro Agollit më lehtë dhe po ashtu ta analizojmë e interpretojmë atë në kapitujt në vazhdim.

Sot vihet re një shprehje nga qëndrimi tradicional, dhe një rendje e mendimit drejt interpretimit të globalizmit. Kjo nuk do të mund të realizohej në asnjë parametër, nëse nuk do të ishte në fund të fundit një prirje natyrale e zhvillimit të mendimit teorik e në të njëjtën kohë po të mos ishte i gatshëm (ky mendim), për të marrë përsipër edhe risqet, sa të vetë atij, aq edhe të shtrirjes dhe impaktit të tij në jetën sociale dhe në politikë *"përballë një uniteti defektoz të Europës". "Historia njerëzore është tragjike. Njeriu nuk mund t'i ketë të dyja, edhe progresin, edhe lumturinë, sepse progresi nuk është një bekim i pastër. Njeriu*

nuk është gjë tjetër veçse një fushëbetejë në të cilën instikti i jetës dhe i vdekjes luftojnë me njëri-tjetrin. Ai nuk mund të çlirohet kurrë nga dilema tragjike e shkatërrimit të vetvetes”.

(Fromm.1973:59). E gjithë kjo, është pasojë e përcaktimit të identitetit. Identiteti, mbetet përsëri objekt i studimit dhe lidhjet e tij me qëndrimin primordial gjithashtu por ne mund të vërejmë se ka shumë pika takimi mes tyre.

Nëse do t’i vendosnim përballë njëra-tjetrës karakteristikat dhe elementet që përbëjnë identitetin dhe atë çka quhet primordiale do të kishim këtë pamje:

Tabela 1: Karakteristika të identitetit dhe primordializmit.

IDENTITETI	PRIMORDIALIZMI
GJUHA (e nënës/ zyrtare/ e imponuar)	GJUHA (e nënës)
TERRITORI (gjeografik/politik)	TERRITORI (Toka, Atdheu)
BESIMI (fetar autokton/ zyrtar)	BESIMI (feja, paganizmi, idhujt, mitologjia)
PSIKOLOGJIA (ndjenjat, emocionet dhe relacioni mes tyre, pritshmëritë gjenetike)	PSIKOLOGJIA (reagimi ndaj realiteteve të brendshëm e të jashtëm, kërkimi i pyetjes: Kush jam unë? Dashuria dhe urrejtja, Lumturia dhe Skllavëria si pjesë krejtësisht të veçanta dhe si objekte studimore më vete)
KUJTIMET (jo shumë të hershme, më aktuale)	KUJTIMET (deri atje ku mendja dhe kujtesa njerëzore mund të shkojnë)
TRASHEGIMIA KULTURORE (etnografia, folklori, arti dhe letërsia, historia)	TRASHEGIMIA KULTURORE (etnografia, antropologjia, arkeologjia, historia, folklori, tradita popullore, ritet, letërsia)

Sipas kësaj tablele, mbërrijmë në një përfundim që do ta formulonim kështu:

1. Identiteti është pjesë e primordializmit.
2. Identiteti ka shumë pika të përbashkëta me qënqëndron më i ngurtë.
4. Identiteti është “kërthiza” e kombit, ndërsa primordializmi është trupi që e mbart këtë “kërthizë”. **Gellner**.
5. Identiteti është Pjesa, ndërsa Primordializmi është E tëra.
6. Identiteti nuk merret shumë me përkatësinë fetare, besimin, Primordializmi, përkundrazi, po. Dallimet e thella fetare prodhojnë konflikte të ashpra që çojnë në trajektore të ndryshme zhvillimi.
7. Identiteti i jep përparësi individit që është protagonist kryesor në arenën e historisë. *“Rrëshqitja nga një kuptim në tjetrin është e padukshme dhe nganjëherë na rrëmben rryma”*. (Maalouf, 2006:35). Individi është mbartësi i gjithçkaje, është ai ku e kaluara dhe e ardhmja fokusohen vetëm në një pikë, tek ai vetë.

Primordialistët mendojnë se drejtimi kolektiv është më i rëndësishëm se sa ai individual.

“Identitetet sociale dhe kultura mund të grupohen në dy kategori. 1. Të dhëna të garantuara nga koha (for granted) dhe 2. Të përfituara. Familja, etnia, kombi, shoqëria dhe civilizimi quhen granted dhe krijohen brenda procesit të shoqërizimit. Ato e shoqërojnë individin që në lindje, ndërsa identitete të zgjedhura lirisht nga individi, quhen të fituara. Identiteti kombëtar është (granted), por nuk është një identitet i natyrshëm dhe spontan i cili shfaqet i sigurtë në cdo periudhë të historisë”. (Yurdusev, 1997:27) Si përfundim, përballja e këtyre dy koncepteve ka këto qëllime:

1. Të tregojë rolin e njërit dhe tjetrit dhe nëse të dy bashkë mund të jenë të rëndësishëm dhe diktues në vendimmarrje delikate e të rrezikshme politike.
2. Të evokojë qëndrimin nacionalist për të shkuar më tej në vetpërcaktime rreth identitetit kombëtar dhe të sqarojë terminologjinë e nacionalitetit mbi bazat e historisë moderne.
3. Të na sjellë në vëmendje se këto përcaktime e vetpërcaktime na kujtojnë të shkuarën, deri në atë masë sa ajo të mos eklipsojë të sotmen dhe të na bëjë miopë për të ardhmen.
4. *“Ligjërimi i mbizotëruar nga spektri i së vërtetës, nuk është për t’u nënvlerësuar”.* (Eco.2007:113). Një qëllim që duhet të jetë patjetër parësor, ku shtrati nacionalist shërben si pritës dhe nxitës për të mbërritur tek mendimi i vërtetë, ku nuk mund të ndash më identitetin nga të qënurit primordial duke krijuar kështu *de jure* edhe përcaktimin final mbi po ato vetë.
5. Qëndrimet identitare dhe primordialiste gati të njëjtësuar gjenden brenda një vorbulle që nxitet nga grupet e interesit ekonomik, politik dhe fetar.
6. Pengjet e së shkuarës nuk na lenë rehat, gjë që më së miri pasqyrohet në letërsi dhe art. Motivët e së kaluarës heroike, heronjtë mitikë, kujtimet, dashuria për tokën, baltën, vendlindjen, familjen, babain, mëmën, për natyrën, dëshira e thellë për paqe, shërbejnë si një e shkuar, që duhet vlerësuar për të mbërritur drejt të ardhmes. Primordialistët veprojnë kështu dhe janë të suksesshëm.
7. Qëndrimi mes identitetit dhe primodalizmit konsiderohet si një zinxhir shkakësie, ku A (e shkuara) dhe B (e tashmja), jo vetëm që janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, por e shkuara projektohet në të tashmen dhe e tashmja formësohet nga e shkuara.

3.3 Primordializmi apo konstruktivizmi. Një qasje teorike.

Përcaktimi i tipareve të identitetit dhe të etnisë e kombit, në qëndrimin teorik të sotëm, nuk mund të kryhet i plotë pa trajtuar shkurtimisht tiparet e këtyre koncepteve bazë. Në mendimin europian, konstruktivizmi nis herët dhe vazhdon si filozofi krijuese e dominante në shekullin e XIX por vazhdon edhe sot e kësaj dite. Mendimi i tyre karakterizohet nga një qëndrimi sipas të cilit: *“... Ata i shohin intelektualët si formësues dhe orkestrues të konflikteve kombëtare me anë të manipulimit prej tyre të kujtimeve, simboleve dhe miteve etnike, ndjekja e strategjive racionale prej tyre, bazuar në interesat e tyre ekonomike dhe statutore, thekson në një masë të madhe formën dhe përmbajtjen e aq shumë nacionalizmave etnike në Evropën Lindore”*. (Smith.2008:93). Në emër të dashurisë për simbolet kombëtare, për Atdheun dhe në emër të evokimit të kujtimeve, konstruktivistët nuk bëjnë gjë tjetër veçse justifikojnë vrasjen pikërisht të tyre, aq sa *“harrojnë”* edhe një element shumë të rëndësishëm jetësor: Kohën, kur dihet që Koha sa është Universale, po aq është edhe Përditshmëri. Koha Universale shprehet përmes raportit E Tashme/E Shkuar, po aq sa shprehet përmes raportit E shkuar/E Ardhme, por të dyja së bashku na çojnë drejt një Kohe të Vetme – Të Ardhmes. Kjo kushtëzohet nga nënndarjet brenda konstruktivistëve, ku më të spikaturit dallohen Radikalët dhe Joradikalët. **Të parët** a) e kërkojnë dashurinë jo të kushtëzuar, b) të natyrshme, c) i mbajnë të pandryshueshme lidhjet me tokën dhe gjakun, **të dytët** a) dashurinë e kërkojnë të kushtëzuar, b) njohin strukturat hierarkike c) i japin më shumë hapësirë mendimit abstrakt, d) dhe gjithashtu njohin ligjin dhe shtetin. Këto qëndrime janë tepër të diskutueshme dhe të padefinuara përfundimisht, por nëse i referohemi Thoma D’akuinit i cili vëren se: *“T’i shohësh njerëzit si qenie arsyetuese do të*

thoshte t'i kuptoje ata si anëtarë të një diskutimi të përbashkët publik. Duke folur së bashku, ne aktualizojmë potencialet e qenies sonë për racionalitet dhe hyjmë në një botë kuptimesh të përbashkëta dhe si rrjedhim, vijmë deri te rregullimi dhe kuptimi i jetës sonë". (Faruku.2009:83,vep.cit), apo siç vëren Smith: "Asnjëri prej këndvështrimeve nuk duket i përshtatshëm për të shpjeguar natyrën e ndërlikuar të këtyre konflikteve". (Smith.1998:93).

Nga ana tjetër Primordialistët në shumë koncepte mbajnë qëndrim krejt opozitar me Konstruktivistët. *"Qëndrimi bazë i tyre lidhet me qëndrimin që ata mbajnë ndaj rolit të elitave intelektuale, rol të cilin nuk e pranojnë, ose e minimizojnë. Primordialistët i kërkojnë burimet e konflikteve në antagonizmat historike. Sipas tyre, intelektualët janë vetëm artikuluesit dhe ekzekutuesit e këtyre antagonizmave. Dallimet e thella fetare gjithashtu janë një burim konflikti, sikurse edhe trajektoret e ndryshme të zhvillimit të popullsive, gjë që krijon pakënaqësi kolektive që shfaqen brutalisht". (Smith.1998:97). Këto tipare të Konstruktivistëve, edhe të Primordialistëve, janë ato që përcaktojnë në një farë mënyre edhe intensitetin e konflikteve të hapura sepse, siç vëren edhe Spinoza: "Asgjë nuk mund të quhet e kryer apo e pakryer, e vështruar brenda llojit, sidomos pasi gjithçka që krijohet ndjek një rend të përbashkët dhe ligje të përcaktuara të natyrës". (Spinoza.2001:18).*

Edhe në këtë punim, i gjithë diskursi ngrihet nën suazën e perceptimit tonë individual. perceptim që, merr dhe ka në të njëjtën kohë një rol të pazëvendësueshëm për të gjithë pasuesit e tij, argumentet, arsyetimet, përfundimet, qëndrimet. *"Perceptimet janë si njerëzit, sa kohë janë zgjuar nuk dyshojnë, por duke e gjetur veten në gjumë- kjo ndodh shpesh-, me sigurinë se janë zgjuar, e pasi e kuptojnë se ishin gabuar, fillojnë të dyshojnë edhe për faktin nëse ishin zgjuar". (Spinoza,2001:35). Në nivel analize, për të treguar raportet mes dy qëndrimeve themelore ndaj identitetit kombëtar dhe të gjithë pasojave që rrjedhin prej tyre,*

është më e lehtë të veçosh konfliktet që kanë rrjedhur prej perceptimeve, se sa vetë perceptimet e koncepteve në fjalë. Duke qenë e tillë prirja për të unifikuar vlerat shkon në mënyrë të zhdrejtë me prirjen për t'i ruajtur këto vlera në nivelin e traditës, zakonit, gjakut, ritit, besimit etj.

Kështu, dilet në përfundimin se konstruktivizmi dhe primordializmi nuk janë cilësisht të ndarë sepse herë mbizotëron njëri e herë tjetri, në varësi të luhatjeve të interesave të momentit, apo të strategjive. Kjo bashkëjetesë e bën të vështirë edhe trajtimin në tekstet e ndryshme letrare, sikur është edhe rasti i veprës letrare të Dritëro Agollit duke qenë se qëllimi i këtij punimi nuk është ndarja e këtyre koncepteve në rrafshin teorik por analizimi i këtyre koncepteve, nga një qasje ligjëimore dhe nga mënyra se si ato veprojnë në veprën e Agollit, që e bëjnë atë të dallueshme edhe nga kjo pikëpamje, duke e afruar ose larguar nga rrafshi primordial.

3.4 Marrëdhëniet mes primordializmit dhe konstruktivizmit

Ka dy mendime të konsoliduara për marrëdhëniet mes primordializmit dhe konstruktivizmit:

Së pari, një sërë shkencëtarësh e studiuesish këmbëngulin se primordializmi është një sivëlla i konstruktivizmit. Primordializmi trajtohet si një konstruktivizëm i moderuar, sikur ndodh edhe me konstruktivizmin që jo rrallë herë trajtohet si një primordializëm modern. Sipas Gellner: *“Primordialistët pretendojnë se zanafilla e nacionalizmit është e lashtë, ndërsa modernistët (konstruktivistët), mendojnë se karakteristikat e botës moderne janë karakteristika të botës moderne”*. (Gellner.1997:24). Me këtë teori ne rikthehemi tek fakti se nga cili do të nisemi: nga konstruktivizmi apo nga primordializmi? Në këtë pikë biem në një silogjizëm që e shpjegon sërish Gellner: *“Armiqësia etnike dhe separatizmi kanë*

nevojë për dallime kulturore, sepse pa to, si do të mundeshin grupet etnike, “kombet”, ta identifikonin veten dhe ta dallonin veten nga armiqtë”? (Gellner.1997:46). Gellner shkon më tej në paraqitjen e mendimit të vet se: “Anonimati i përkatësisë së të qenit pjesëtar në “kombin” tërësor, të pandërmjetshëm nga ndonjë nëngrupim i rëndësishëm, është ajo që e dallon kombin modern. Ka vetëm një mënyrë për të mbërritur shpejt tek homogjeniteti i kombit-spastrim etnik”. (Gellner.1997:63).

Një përfundim i hidhur me pasoja edhe më të hidhura, në rastet kur është marrë nga konteksti i trajtimit teorik dhe thjesht është përdorur si një justifikim i veprimeve politike të forcave të ndryshme pushtetmbajtëse. “Margjinalizimi gjithmonë e në rritje i hebrenjve, në një shoqëri që konsideronte identitetin e unifikuar të krishterë si një karakteristikë përcaktuese, i paralelizoi zhvillimet në Perandorinë Bizantine.... Megjithatë, vendosmëria e sundimtarëve për të çrrënjësuar këtë popull “të ri” që kishin krijuar politikën e tyre, la një trashëgimi të tmerrshme, ku në periudhën moderne u shfaqën përsëri këto shqetësime fanatike për pastërtinë e gjakut”. (Geary.2003:235).

Gellner është i kujdesshëm duke na treguar elementet që përcaktojnë rolin e identitetit dhe marrëdhënien e tij me primordializmin e konstruktivizmin dhe se primordializmi më shumë se sa konstruktivizmi është më shumë pjesëmarrës në përcaktimin e konceptit mbi kombin, mbi identitetin kombëtar. Nga ana tjetër: “Në brendësi të çdo konteksti shoqëror, do të ketë një numër të caktuar identitetesh të lidhura dhe me mundësi përkatësie, të cilat mund të klasifikojnë në terma rëndësie dhe pranueshmërie”. (Sen.2010:44), pasi “... edhe idetë i nënshtrohen çoroditjes”. (Spinoza. 2001:55). Kjo shpjegon edhe thëniet e kundërthëniet për të njëjtin problem sepse edhe “intelekti nuk reflekton mjaftueshëm mbi vetveten ngase ne pohojmë dhe mohojmë shumë gjëra, sepse këto pohime e mohime ndjekin natyrën e fjalëve

dhe jo atë të gjërave, kështu që, duke mos ditur, ne do të merrnim për të vërtetë atë që është e gabuar”. (Spinoza.2001:58).

Së dyti, Anthony Smith, thekson se nacionalizmi ndahet në dy grupime të mëdha: **1. Nacionalizëm i ngushtë; 2. Nacionalizëm i gjerë**. Sipas tij një nacionalizëm i ngushtë ka të bëjë më së shumti “... me përkatësinë gjuhësore dhe etnike dhe kjo është një karakteristikë e popujve të vegjël, periferikë në zona shpesh të prapambetura, ndaj formacioneve politike anakronike të perandorive osmane, cariste, habsburge”. (Smith.1991:22). E gjithë historia e krijimit të shteteve-kombe të Evropës së sotme e ka fillesën e saj këtu dhe me shumë qëndrime të tjera që kanë lidhje me ekzistencën e shtetit si ligjshmërinë, besimin, kulturën, traditën, ekonominë që i bashkëngjiten përcaktimit territorial e gjuhësor. “Ndryshimet tona nuk i përkasin një dimensionit të vetëm”. (Sen.2006:659), sepse edhe vetë “njerëzimi i ka ndërtuar të dyja, si katedralet dhe kampet e përqendrimit”.(Stoessinger.2007:371).

Nacionalizmi i gjerë sipas Smith, përfshin jo vetëm territorin dhe gjuhën, po mbi të gjitha qëndrimet politike dhe interesat ekonomike. Rasti i “*gjakut të pastër*”, është një nga elementet e tjerë me të cilët nacionalizmi i gjerë mban gjallë vetveten. Ky nacionalizëm është më i prirur të jetë pranë masave, të manipulohet më së shumti nga politika dhe feja dhe gjithashtu të ketë fatkeqësinë të jetë më pranë lindjes së regjimeve totalitare e diktaturave të llojeve të ndryshme. Siç vëren Stoessinger: “*Faktori i vetëm, më i rëndësishëm në përshpejtimin e shpërthimit të luftës është perceptimi i gabuar*”. (Stoessinger.2007:347), dhe po aty ai e shtjellon më tej mendimin e tij kur ofron edhe faktorët që çojnë në këtë perceptim të gabuar, “... lufta merr fund kur kombet formojnë një perceptim më realist për forcën e tjetrit. (Stoessinger. 2007:347).

Shtrohet përsëri pyetja: Si shestohet marrëdhënia mes primordializmit dhe konstruktivizmit në këndvështrimin e teoricienëve të mendimit shqiptar? Për shkak të rrethanave specifike, vërejmë se primordializmi më shumë se sa konstruktivizmi është ai që udhëheq në teori dhe në praktikë. Rilindja Kombëtare Shqiptare funksionoi duke përqafuar të gjitha kanonet e Rilindjes Evropiane, si: miti, gjuha, toka, mëma, atdheu, sublimimi, idealja dhe për vetë zhvillimin historik të shqiptarëve, të cilët bënë pjesë në ato *“etnitë periferike”*, primordializmi del në plan të parë dhe i pakonkurrueshëm. Nuk bëhej fjalë për një qëndrim konstruktivist për aq kohë sa nuk kishe një shtet. Ndoshta përpjekjet e Rilindasve, përveç shtratis të pamohueshëm primordialist, në mënyrë krejt sporadike, artikuluan edhe qëndrime konstruktiviste. Nga kjo pikëpamje, traktati i Sami Frashërit *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është, dhe ç’do të bëhet”*? mund të jetë edhe përpjekja e parë e mendimit shqiptar drejt qasjes në këtë qëndrim. Qëndrimi filozofik i Sami Frashërit, është një qëndrim që nuk i sheh si dy pole të ndryshme, të ndara nga njëri-tjetri, por si një vazhdim i njëri-tjetrit. Ky qëndrim, që përcaktoi edhe qëndrimin e Rilindasve të tjerë por edhe të Postrilindasve, vjen për shkak se favorizohet nga kushtet historike, politike, etnike në këtë periudhë. Dihet që në atë kohë Shqipëria ishte në zgrip të ekzistencës së saj, sepse ose mund të asimilohej dhe të kthehej në një provincë të humbur të Perandorisë Osmane duke humbur kësisoj gjuhën, identitetin, besimin, ose të qëndronte, të ruante me fanatizëm ekstrem gjuhën, besimin, me raste edhe territorin. Shqiptarët zgjodhën të ruajnë lidhjet me token, gjuhën e tyre, dhe besimin e tyre, kësisoj ruajtën identitetin e tyre, të pangjashëm me fqinjët e tyre gjeopolitikë dhe ky qëndrim nuk është gjë tjetër veçse qëndrim primordial.

Nga sa më sipër, dilet në përfundimin se primordializmi ëshë baza e mendimit dhe e veprimit shqiptar i cili do të na duhet kur të tregojmë lidhjen e veprës së Dritëro Agollit

pikërisht me primordializmin. Në rastin shqiptar, nëse e trajtojmë konstruktivizmin si një nocion periodizues ai nuk është gjë tjetër veçse vazhdim i primordializmit. Po nëse e trajtojmë si një nocion tipologjik, atëherë analiza merr tipare të veçanta pasi primordializmi dhe konstruktivizmi trajtohen si dy qëndrime të cilat kanë pikëlargime, por kanë edhe pikëprerje në mënyrë të ekuilibruar. Ky ekuilibër përkon edhe me situatën specifike të historisë së Shqipërisë, ku këto koncepte në fakt nuk janë të artikuluar qartë edhe pse duhet sqaruar se prania e konstruktivizmit është në nivel shenjash që herë spikasin e herë neutralizohen, pavarësisht rrethanave politike. Konsolidimin e këtij qëndrimi konstruktivist në mendimin tonë, shqiptar, e pengon “vështirësia e pjekjes” së situatës historike. Shqipëria për shkak të kushteve historike nuk e “pjek” këtë qëndrim, asaj nuk ka ç’i duhet konstruktivizmi, ajo nuk ka shtet, ajo nuk ka komb, ajo diskuton identitetin e saj!

Ndryshon pak situata me aktin e Shpalljes së Pavarësisë ku lidhjet me primordializmin, me idealet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare ishin të pathyeshme si në nivele intelektuale, edhe në nivele populiste. E njëjta situatë përsëritet edhe gjatë periudhës 1945-1990, ku shtetit të formuar tashmë, me komb të përqëndruar, me gjuhë të ruajtur, me besim, me identitet të mirëpërcaktuar ku roli i primordializmit mbeti i pazëvendësueshëm, megjithëse brenda tij përfshiu qëndrime dhe elemente konstruktivistë. Rënia e diktaturës komuniste në vitet ’90-të, bashkëshoqërohet me ëndrra të mëdha si ajo e rilindjes së njeriut të lirë duke u konsideruar edhe si “fundi i ideologjive” ku përsëri primordializmi qëndron në krye të vendit. Janë momente rivlerësimi të dashurisë për atdheun, tokën, atin, të cilave u shtohen në këtë kontekst koncepti i lirisë, i së drejtës, e drejta e fjalës, e drejta për të jetuar, pra një sërë elementesh me bazë konstruktiviste, por që funksionojnë përsëri të mbivendosura mbi primordializmin. Për lehtësi studimi le t’i paraqesim këto marrëdhënie në një tabelë:

Tabela 2. Pikëtakimet dhe pikëlargimet mes primordializmit dhe konstruktivizmit përmes historisë dhe lidhjes me atdheun:

	Niveli	Primordializmi	Konstruktivizmi
Të përbashkëtat	Filozofik	Lidhje mitike	Lidhje mitike por me bazë reale
		Lidhja me besimin e trashëguar	Lidhja me besimin e trashëguar, por edhe bashkëkohës, sipas nevojës së mbijetesës
		Lidhja e pazgjidhshme dhe gjithnjë primare me token	Lidhje me tokën e cila nuk është gjithnjë vendlindja
		Lidhja me Atdheun, ai është i shenjtë, mbrojtja e tij parësore dhe sublimuese	Atdheu është i shenjtë, ai mbrohet, por jo dhe aq në nivele sublime
		Mitet janë të shenjta e të pandryshueshme	Mitet trashëgohen dhe krijohen
Dallimet	Praktik	Cdo gjë e trashëguar është e shenjtë	Trashëgimia është një element, një pjesë, por jo e tëra
		Ne jetojmë të sotmen duke u mbajtur tek e kaluara	Përsëritja ciklike e historisë e përjashton të kaluarën

Tabela 2/1. Pikëtakimet dhe pikëlargimet mes primordializmit dhe konstruktivizmit përmes gjuhës dhe simboleve.

Të përbashkëtat	Niveli	Primordializmi	Konstruktivizmi
	Praktik	Gjuha është primare	Gjuha e nënës është primare
		Territori është i imi kur unë jetoj në të	Territori është i imi por edhe i të tjerëve që punojnë në të
		Simbolet janë të shenjta dhe nxitëse të nacionalizmit	Simbolet duhen për tu dalluar prej të tjerëve
Dallimet	Filozofik	Gjuha, besimi, miti, simboli janë elementet kryesore të nacionalizmit	Gjuha, besimi, miti, simboli elemente të perceptimit të nacionalizmit
		Tradicionalja është e pranishme fuqimisht në vendimet	Tradicionalja nuk e kushtëzon marrjen e vendimeve
		Atdheu është dashuria sublime dhe e shenjtë, i patjetërsueshëm dhe i pazëvendësueshëm	Atdheu është dashuri e madhe, e thellë, mund të quhet “atdhe” edhe vendi ku punon e jeton, por jo ku ke lindur, i zëvendësueshëm
		Historia është mësuesja më e mirë dhe kultura ruhet me fanatizëm	Historia nuk na duhet edhe aq dhe kultura trajtohet si një e ndryshueshme

Të gjithë argumentet i përmendëm më lart me qëllim, që të mbështesim faktet rreth proceseve të krijimit të kombeve e të konsolidimit të identitetit përmes primordializmit. Gellner, na jep një përkufizim mbi nacionalizmin ku vëren se *“Nacionalizmi është një parim politik, sipas të cilit ngjashmëria kulturore përbën veglën themelore në shoqëri”*. (Gellner.1997:14). Në trajtesat e tij teorike, sistemi i vlerësimit bazohet në funksion të argumentit se primordializmi është më relevant dhe më i pranishëm në ndërtimet identitare. Nga ana tjetër ky qëndrim thekson se, që të arrish drejt përfundimeve apo përcaktimeve të ndryshme, duhen të kihen parasysh edhe shumë faktorë të historisë në misionin e përmbushjes së përcaktimit identitar.

Gellner vëren se *“kultura dhe organizimi i shoqërisë janë universale dhe të përhershme. Shtetet dhe nacionalizmi nuk janë të tillë. Asnjë teori që nuk arrin ta pranojë këtë nuk mund të shpresojmë t’i japë zgjidhje të drejta problemit”*. (Gellner.1997:16), ku në të dyja rastet kemi të bëjmë me elemente të njohura si riti, tradita, besimi, dashuria mëmësore, atdheu, përcaktueshmëria historike, roli i heroit, përkatësia e tij identitare pra elemente që na çojnë drejt primordializmit. Në të njëjtën kohë nacionalizmi, gjithashtu lind, zhvillohet, vdes i kushtëzuar nga rrethanat historike dhe nga rrethanat shtetformuese përmes këtij raporti:

nacionalimi si histori vs nacionalizmi si realitet

Nacionalizmi përbën pa dyshim një ndër forcat më të rëndësishme që kanë ndikuar gjatë historisë së botës moderne. Gellner eksploron dukurinë e nacionalizmit duke gjurmuar që nga lindja e rrënjët e tij kur u krijua shteti-komb modern, deri tek lidhjet e tij me romantizmin, liberalizmin, marksizmin dhe Islamin. Siç vëren Gellner: *“Çështja nuk është thjesht te përfaqësimi i ndjenjave nacionaliste, por tek shpjegimi i tyre.”* (Gellner.1997:3). Që çdo njeri ka ndjesi nacionale, kjo është natyrale, por që një njeri të ketë ndjesi

nacionaliste, këtu çështja ndryshon pak por edhe komplikohet. Kjo ka të bëjë së pari me përcaktimin e termit, konceptit nacional dhe konceptit tjetër, nationalist. Për sa i përket nacionales, është një ndjesi që lind me njeriun në rastet më të shumta, në momentin që ai lind dhe vendi i lindjes, bëhet kështu përcaktues i nacionalitetit të tij. Territori është elementi i parë, më i prekshmi nga kushdo, por territori nuk është një i dhënë e i pandryshueshëm, sepse siç e ka vërejtur dhe Maalouf *“Identiteti ndryshon dhe zhvillohet”*. (Maalouf.2006:13).

Pasi kemi treguar alternativat me të cilat një individ mund të përcaktojë dhe të vetpërcaktojë identitetin e tij edhe nacionalitetin, dhe ta marrim të mirëqenë këtë përcaktim e vetpërcaktim, cilido qoftë ai, vijmë në raportin e këtij përcaktimi e vetpërcaktimi me nacionalizmin. Sigurisht nacionalizëm do të thotë edhe qëndrim i përqëndruar rreth këtij koncepti- nacionalitetit, është lëvizje me dëshirë e vetvetes, e individit por edhe në grupe të caktuara. Nacionalizmi ka mekanizmat e tij të veprimit, ku padyshim që më i forti është politika, e cila drejton dhe orienton nacionalitetin, ndjesitë nacionale drejt nacionalizmit, drejt të vepruarit në emër të identitetit kombëtar. Politika shërben për të zgjuar atë që ne e etiketojmë si ndërgjegje kombëtare. Të jesh nationalist, të kesh mendime nacionaliste, të veprosh si nationalist nuk bën gjë tjetër, veçse ruan identitetin tënd. Të jesh nationalist dhe ti shërbesh nacionalizmit ke dy mundësi, e para, të mbetesh nacional e të ruash identitetin tënd kombëtar, e dyta, ta humbasësh atë, si të vetvetes ashtu edhe të të tjerëve, sipas parimeve të kushtëzuara nga epoka historike.

“Nacionalizmi është një parim politik sipas të cilit ngjashmëria kulturore, përbën veglën kryesore në shoqëri”. (Gellner.2006:14). Kultura e trashëguara dhe e krijuara rishtazi na kujtojnë që shoqëria njerëzore është e ngjashme, sepse vetë njeriu është i tillë i përngjashëm

me tjetrin. Nga ana tjetër, po kultura sjell lindjen, zhvillimin e përpunimin e fantazisë, artit, letërsisë gojore e të shkruar. Pra janë një shumësi elementesh të pranishëm gjithmonë në jetën e një shoqërie njerëzore të cilët bëjnë diferencën mes tyre, por duke ruajtur nga ana tjetër thelbin e njëjtë. Natyrisht që të gjitha këto pasuri shoqërore kulturore përbëjnë një prapavijë të fuqishme për çdo lëvizje politike, njëra prej të cilave është edhe nacionalizmi. Në fakt, ne themi nacionalizëm, po gjithnjë këtë e identifikojmë me nacionalitete të ndryshme, sepse diferencat mes njërës e tjetrit nacionalitet janë pikërisht diferencat mes kulturave të tyre. Ne nuk mund të pretendojmë për një nacionalizëm global. Por ne mund të pretendojmë lirisht për nacionalitete globaliste. Por kjo, për trajtesën tonë nuk është objekt, ndaj ne mjaftohemi me faktin që jemi përpara kësaj situate dhe e pranojmë si të tillë. Gellner vëren: *“Nëse shtetet nuk janë universale, atëherë pak universale është edhe vetë nacionalizmi”*. (Gellner. 2006:17)... *Kultura dhe organizimi i shoqërisë janë universale dhe të përhershme, ndërsa shtetet dhe nacionalizmi nuk janë të tillë”*. (Gellner.2006:15-16). Ky qëndrim nuk është vetëm i Gellner por edhe i autorëve të tjerë që janë marrë me studimin e kësaj çështjeje delikate. Të pranosh se nacionalizmi është aksidental është mendjeshkurtësi dhe nuk mund të mendohet se gjërat ndodhin rastësisht. Jemi brenda logjikës së materializmit dialektik, marksist. Dhe po në të njëjtën kohë ne mund të pohojmë lirisht se *“Nacionalizmi i ka rrënjët tek modernizmi”*. (Gellner.2006:24). Është e kuptueshme sepse më parë nuk flitet për shtete e kombe, por vetëm për grupe bashkësish të lidhur me njëri-tjetrin etnikisht, në bazë të atyre elementeve të cilat i kemi përmendur disa herë në punimin tonë, që janë gjuha, territori, besimi, dashuria për tokën, atin, nënën etj. Siç e vëren edhe Gellner, një silogjizëm i tillë i rrezikshëm mund të jetë edhe ky: *“Armiqësia etnike dhe separatizmi kanë nevojë për dallime kulturore, sepse pa to, si do të mundeshin*

grupet etnike, “kombet” ta identifikonin dhe ta dallonin veten nga armiqtë e tyre”? (Gellner. 2006:46). Po ky nuk është argumenti më i mirë që mund të kemi për të justifikuar lakminë dhe etjen për pushtet. *“Harmonia e interesave në treg nuk është veçse një iluzion: aty fshihet një konflikt i thellë dhe i pazgjidhshëm interesash ku shqetësimi real nuk është nënshtrimi politik i shumicës së favorizuar”*. (Gellner.2006:47).

Mund të ketë shumë faktorë që çojnë drejt konflikteve të hapura në Ballkan ku: 1.*Njëri është i trazirave normale për kushtet e largëta malore*”. (Gellner.2006:57). Me këtë ne mund të kthehemi në histori shumë mbrapa përmes Ciklit të Kreshnikëve, nga i cili mësojmë se kemi një bashkësi të ngulitur në male, që lufton për mbijetesë dhe përpiqet të zgjerojë territorin e vet, përmes luftërave lokale. Individidi luante një rol vendimtar për bashkësinë, kur fjala e tij ishte ligj e zbatohet prej të gjithëve, kur hero i ishte pranishëm, real, dhe aktiv, kur dallimi mes mitit dhe reales ishte ende i pazgjidhshëm, dhe kur jetonin sipas një simbioze gati biologjike, edhe për shkak të vijimësisë gjenetike. Fakti që Cikli i Kreshnikëve ekziston jo vetëm tek shqiptarët, por edhe tek boshnjakët, serbët, kroatët, grekët, etj, e vërteton mendimin tonë. 2. *“Jemi në mes të qëndrimit të atyre që e vetquajtën veten Zot = muslimanë, dhe atyre që u quajtën Të Egrit = Krishterë*. (Gellner.2006:57) shkurt jemi në rolin e fesë në këto konflikte (fetare). Do të ishte naive të besonim që feja është gjithçka dhe se nacionalizmi lidhjen kryesore të tij e ka pikërisht me fenë. Nëse e vërejmë nuk po citojmë besimi, por feja dhe po i ndajmë sepse kur vjen fjala për besimin, cilido qoftë, ai është universal, sepse, njeriu, qenia njerëzore beson. Ndërsa kur vjen puna tek etiketimet, pra dallimet e këtyre besimeve, gjithësecili prej tyre ka identitetin e vet që shfaqet në ligjet e kanonet e tyre. Nacionalizmi sigurisht që qëllimin e tij kryesor ka besimin, por rruga për të mbërritur tek ai kalon përmes fesë. *“Kombi është një popullatë e*

emërtuar, që ka të përbashkëta, mitet dhe kujtimet, kulturën publike të masave, një atdhe të dhënë, njësim ekonomik dhe të drejta e detyrime të barabarta për të gjithë anëtarët e saj”. (Smith, 2008:68).

Nga kjo pikëpamje Gellner gjithashtu konstaton se *“rebelët Ballkanas nuk ishin thjesht rebelë, por nacionalistë”.* (Gellner. 2006:59). Një pikënisje e mirë për qëllimet si të Rilindasve për krijimin e kombeve e shteteve, ashtu edhe për këto shtete e kombe për të shprehur e lakmuar ekspansion ndaj të përngjashmëve të tyre. Koha tregoi se, pavarësisht etiketimit, politika ndoqi rrugët që iu dukën më të përshtatshme për plotësimin e qëllimeve të veta, duke patur si qëllim final homogjenitetin. Siç vëren përsëri Gellner *“... në zona me kompleksitet të madh etnik, sikurse është Europa Lindore, nuk ka mundësi që parimi të zbatohet ndershmërisht. Serbët fjala vjen, nuk përbëjnë shumicën në Kosovë, por cila do të ishte mendja nacionale që do të mohonte se ata mund të ndahen nga viset e katastrofës së tyre më të madhe kombëtare?”*(Gellner.2006:60). Atëherë kthehemi në nivelin e fillimit të këtij diskursi. Nacionalja apo nacionalizmi? Identiteti apo globalizmi? *“Shtrohet pyetja kush do të mbizotërojë? Demografia? (elementi më i manipulueshëm), Historia? (vijimësia historike), Gjeografia (kompaktësia territoriale)”.* (Gellner.2006:129). Një vend të vecantë Gellner i kushton edhe marrëdhënieve të fesë, besimit me nacionalizmin sepse nuk mund të kuptohet nacionalizmi pa besimin, pa fenë e tij, por në fillim duhet të jemi të qartë dhe të ndajmë besimin nga feja. Nëse bëhet fjalë për besim, atëherë mund të flasim edhe për nacionalizëm. Ata shkojnë bashkë, nuk kanë lindur në të njëjtën kohë, por vijat e tyre takohen në momente decizive të bashkësive etnike. Kur flasim për fenë, gjërat ndryshojnë sepse nuk kemi më një marrëdhënie binom, por trinom, ku elementi i tretë padyshim që është politika. Problemi më i madh sot është problemi Islam, që sikur vëren Gellner:

“...duket i aftë që të konkurrojë suksesshëm me nacionalizmin, e ka ose jo, shtetin nën kontroll”. (Gellner.2006:110). Po në fakt nuk do të ndalemi gjatë në këtë pikë pasi kjo nuk është objekt i yni, por sa për të theksuar vështirësitë në të përcaktuarit e koncepteve të nacionalizmit, nacionalitetit dhe identitetit kombëtar.

Gellner në mënyrë metaforike e përmbledh të gjithë mendimin teorik, në dy veçori: 1. E çon këtë mendim përpara, përmes analizave të thella dhe fakteve të shumta nga realiteti social; 2. Na çon përsëri në fillim të mendimeve tona në pyetjen tonë të pare dhe po ai vetë përgjigjet: *“Kjo është një çështje e vijimësisë, apo më saktë, tërësive vijimësirash” si: Kulturat, Strukturat e pushtetit, Njohja e një kulture të caktuar si një diçka, Si entitet (si objekt dashurie, luajaliteti dhe identifikimi), Përdorim politik i identifikimit dhe diferencimit kulturor. A ruhen të gjitha këto përmes kufirit, pavarësisht se ku e vendosim, mes tradicionales dhe modernes?”* (Gellner.2006:114).

Si përfundim, nacionalizmi përbën padyshim një ndër forcat më të rëndësishme që kanë ndikuar gjatë historisë së botës moderne. Kjo është një teori e njohur nga studiuesit, si një teori sa e thellë, aq edhe provokuese sepse mes të tjerash përmbledh në vetvete të gjithë përvojën e tij si studiues. Kjo teori eksploron dukurinë e nacionalizmit, duke gjurmuar që nga lindja e rrënjët e tij kur u krijua shteti- komb modern, deri tek lidhjet e tij me romantizmin, liberalizmin, marksizmin dhe Islamin. Gellner shpresonte për një *““aleancë të mbrapshtë”, mes konsumizmit dhe një nacionalizmi të moderuar, jo territorial, një Europë federale e cila do të mund të impononte autoritetin e saj me qëllim që të parandalonte katastrofat ekologjike dhe terroriste, gjithashtu dhe trafikeve të drogës e të armëve, por duhej të ishte një Europë që do të ruante pluralizmin e saj territorial dhe kulturor”*.(Gellner,2006:128).

3.5 Identiteti kombëtar në rrafshin primordial

“... është ndjenja e cila kërkon të jesh një individ duke qenë i identifikuar në grupe dhe njerëz të tjerë”. (Fromm, 1955:134). Koncepti mbi identitetin ndryshon në varësi të trysnisë që ushtrohet mbi të. “Bota është një makinë e ndërlikuar që nuk mund të zbërthehet vetëm me një kaçavidë”. (Maalouf.2006:31). Nisur nga ky përcaktim metaforik, mbërrijmë në një përfundim se ka shumë qëndrime përreth përcaktimit në terma shkencorë mbi identitetin i cili e ndërlikon edhe pajtueshmërinë apo jo të qëndrimit tonë rreth identitetit. Epoka të reja sjellin qëndrime të reja, të cilat nuk janë të rastësishme, por janë pjesë e një procesi të gjatë, të zhvillimit historik të njerëzimit. “Identiteti nuk jepet njëherë e përgjithmonë, ai formohet dhe shndërrohet përgjatë gjithë ekzistencës sonë” (Maalouf.2006:27). Identiteti bëhet kështu “zëdhënës” i një shoqërie që ka ndërgjegjen e ndryshimit e që pos të tjerash vazhdon të ngrejë shumë pikëpyetje rreth përcaktimit të vetë atij. Këtu, kërkimi i etiketimit të vetvetes, identitetit, herë trajtësohet me modelet e kahershme të ngulitura në ndërgjegjet tona, e herë iket prej tyre drejt një finishi të panjohur. Për shkak të këtij realiteti identitar “streha” më e mirë ku ne mund të gjejmë një përcaktim të saktë padyshim që janë fjalorët shpjegues të gjuhës. Sipas *Larousse- dictionnaire de francaise*, 1986, Paris, kemi këtë përcaktim: “1. *Ce qui fait qqch est de meme nature qu’une autre- Une identite de gouts, de sentiments (Accord/Diference, Opposition); 2. Ensemble des caracteres (singlement) des circonstances (etat civil), qui font que qqn est recony comme etant telle personne, sans confusion avec une autre. La carte d’identite.*” Ndërsa në fjalorin dy gjuhësh frengjisht/hebraisht ky përcaktim mjaftohet vetëm: “*Identite= carte d’identite*” (Marc M. Cohn.1996:116)

Ndryshon puna në shpjegimin që jepet në fjalorin shpjegues të *Oxford Advanced Learner's Dictionar*, ku përcaktohen disa përdorime e emërtime: “1. *Who or What- There is no clue to the identity of the killer*; 2. *A case of mistaken identity- When the wrong person is arrested by mistake*; 3. *The British do not have a strong national identity- She had an identity crisis when she was sixteen*; 4. *(with sth) the state of being closely involved with or part of sth- develop a sense of identity with the organization*; 5. *L'identity card- card bearing the holder's name, signature etc, and often a photography, carried or worn by sb to show who they are*”. Ndërsa në Fjalorin Shpjegues të Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 1980, *Identiteti* përcaktohet: “1. *Barazi, ngjashmëri e plotë e një sendi ose e një dukurie me sende e dukuri të tjera, të qenit identikë, njëjtës, përputhje e plotë*; 2. *Të qenët i veçantë nga të tjerët dhe i njëjtë vetëm me veten në disa veçori e tipare që shërbejnë për t'u njohur pa vështirësi.*”

Siç shihet, vetëm me një vështtrim të thjeshtë krahasimtar mes atyre që duhej të ishin më të saktët në përcaktim dhe më unikët, ka mospërputhje dhe dallime. Synimi ynë ishte që të vërtetonim mendimin e Maalouf të cilit iu referuam në fillim të këtij konstatimi. Ky krahasim na çon drejt vështirësisë në rritje për vendosjen e piketave prej të cilave kanë rrjedhur edhe ato përcaktime nga ku ne përmendim disa si më të rëndësishmet:

- A) Identiteti i përcaktuar si i tillë në bazë të gjuhës.
- B) Identiteti i përcaktuar si i tillë në bazë të territorit gjeografik.
- C) Identiteti i përcaktuar si i tillë në bazë të së kaluarës së përbashkët të një bashkësie.
- D) Identiteti i përcaktuar si i tillë në bazë të besimit fetar.
- E) Identiteti i përcaktuar si i tillë në bazë të trashëgimisë kulturore (folklor, ritet pagane, konstitucioni shpirtëror).
- F) Identiteti i përcaktuar si i tillë në bazë të psikikës së bashkësisë.

Shihet qartë, se sa shumë elemente ka për të dhënë një përcaktim, ku secili prej tyre ka historinë e vet, ka territorin e vet, trashëgiminë e vet, besimin, psikikën. Sipas A.Smith *“...vetja individuale bazohet në 4 kategori. 1-gjinia e cila është kategoria më e dukshme dhe konstante. Ajo paraqitet universale dhe është origjina e ndryshimeve dhe varësive të tjera. 2- terrain apo patria; vend ose komb, ku identiteti lokal apo regional është i përhapur në kohërat pre moderne. 3-Kategoria e tretë është ekonomike-shoqërore, ku klasa paraqitet si identitet unik kolektiv dhe i vetmi transformues në historinë e teorisë marksiste. 4- identiteti etnik-fetar”.* (Smith, 1986:16-28).

Secili grup bashkësie njerëzore që përpiket të definojë nocionin e identitetit, patjetër që do mbartë me vete edhe të gjithë këto elemente që do të bëjnë dhe përcaktimin e konceptit identitet. Adam Smith në “Origin of Nations” thotë: *“Në njërën anë vendi, të drejtat dhe detyrat e përbashkëta dhe të ndërsjella, janë prioritetet kryesore në modelet territoriale, në anën tjetër është modeli etnik i ndërtimit të kombit, etnia dhe gjuha; (Smith, 1989:349).* Por në rastin tonë kjo nuk ndodh, sepse qëndrimet dhe përpjekjet për përcaktime janë më shumë subjektive, pasi vetë identiteti është në ndryshim e në lëvizje. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se jo gjithmonë jemi përpara të njëjtës situatë me këto tipare. Nëse themi se vetpërcaktimi i sotëm tenton më së shumti drejt zgjedhjes politike me një bazë të fuqishme pragmatike, kjo nuk do të thotë se ky proces i fshin ato që ndërkohë janë vetpërcaktuar. Kjo marrëdhënie mes elementeve të ndryshëm të përcaktimit të asaj që duhet të quhet identitet, ka sjellë edhe përparësi të ndryshme për grupe bashkësie të ndryshme. *“Secili nga ne ruan dy trashëgimi: 1) Vertikale- që vjen nga tradita, nga paraardhësit; 2) Horizontale- që e ka burimin tek Epoka jonë, tek bashkëkohësia.”*(Maalouf.2006:96). Pikërisht për shkak të kësaj laryshie interesash strategjike, ky koncept është i vështirë të

emërtohet prerazi, sipas një përcaktimi të vetëm, ndaj pranohen si të mirëqena të gjitha karakteristikimet e deri më sotme.

Bota sot është e shumëtrajtshme, më shumë se sa në të kaluarën, por kjo nuk do të thotë që e kaluara mbetet thjesht e tillë, përkundrazi, *“Historia nuk përsërit veten, jo saktësisht. Ajo na mëson përmes analogjive”*. (Stoessinger.2007:370). Ky deduksion duhet të na vlejë në vendosjen e raporteve mes koncepteve të vjetra dhe atyre të kohës moderne, bashkëkohësisë duke sqaruar se: *“... ka një hendek midis asaj që jemi dhe asaj që pandehim se jemi”*. (Maalouf, 2006:97), sikur duhet të jemi krejtësisht të ndërgjegjshëm e të khtjellët se nuk mjafton të ndjesh, të kesh ndjesi identitare, por më e rëndësishme është të arrish të shpjegosh. *“Liria është dhuntia kryesore e natyrës”*. (Da Vinci.1999:100). Duhet të jemi patjetër të lirë që të arrijmë të shpjegojmë edhe atë që në pamje të parë duket e pashpjegueshme.

Në kohën tonë të sotme moderne, bota është e prirur drejt një qëllimi: *“Qëllimi i largët i procesit botëror nuk është njeriu, si kurorë e krijesës. Ky qëllim i largët drejt të cilit shkon krijimi, është i panjohur nga ne deri tani dhe porsa ka filluar të realizohet”*. (Fogelman, 1997:83). Bota moderne dhe përpjekjet e saj për të përcaktuar e shpjeguar dukuritë dhe fenomenet identitare, në epilogun e tyre përmbyllen me prologun e kësaj drame mbarënjëzore. *“Parimi i papërcaktueshmërisë ka patur pasoja të thella mbi mënyrën se si e përfytyrojmë botën”*. (Hoking.1997:55). Në këndvështrimin tonë, kjo shumësi prurjesh teorike-filozofike-politike, duhet të klasifikohet për sa i përket tipareve dominante të tyre. Në analogji të thjeshtë pyetja jonë do të mund të formulohej kështu: A ka shumë variante të identitetit në rrafshin primordial? Ajo çka ne u përpoqëm të shpjegojmë dhe të përcaktojmë rreth identitetit, pra rreth kritereve që e përbëjnë atë dhe se si ne e gijkojmë qenësinë e

identitetit, nuk është se ndryshon shumë nga qëndrimi primordialist. Edhe primordialistët kanë disa elemente parësore përmes të cilave ata klasifikojnë elementet me të cilat ata vetë etiketohen. Sipas tyre: *“Primordializmi është ndjenja e lidhjeve të qëndrueshme etnike midis pasardhësve të bashkësisë fillestare, kudo ku mund të ndodhet”*. (Maalouf.2006:47).

Le ta zbërthejmë këtë përmes interpretimit: -Ndjenja e lidhjeve të qëndrueshme.

Së pari, vihet re se ka ndjenja, gjë çka është tepër e rëndësishme për përqasjen ndaj identitetit dhe kjo për faktin se, pikërisht shpërfaqja, në një mënyrë të caktuar e llojeve të caktuara të ndjenjave, përcakton në një element, identitetin.

Së dyti, këto ndjenja janë solide ndaj lidhjeve të qëndrueshme, çka do të thotë që kemi një lidhje, ose shumë lidhje, si lidhje gjaku, territori, kujtimesh, ndjenjash, mbijetese, strategji për këtë mbijetesë, kërkim për rrugë të reja zhvillimi, konflikte, luftëra, humbje, fitore, urrejtje, dashuri, etj, ku përsëri kemi shpërfaqje të elementeve të përcaktimit të identitetit.

Së treti, përcaktohet termi të qëndrueshme, gjë që nuk bën tjetër veçse shënjon vazhdimësinë lineare të kësaj lidhjeje sepse dhe vazhdimësia e elementeve të ndryshëm specifike përbën një pjesë të identitetit.

Së katërti, të gjitha, sa përmendëm më lart, e kanë një emërues të përbashkët, që në tekst paraqitet me fjalën **etnike**, e cila ngërthen në vetvete ndjenjat, lidhjen, qëndrueshmërinë.

Së pesti, pasardhësit, janë ata që mbartin në vetvete të shkuarën, të cilën ne nuk e njohim sa dhe si duhet, sepse është ajo që na njeh ne më mirë se çdo gjë tjetër. Në mënyrë të pavetëdijshme, instiktive ne i rikthehemi të kaluarës sonë dhe në këtë proces ne njohim aq sa ajo e kaluar na lejon. *“Ligjet e shkencës nuk bëjnë dallim ndërmjet drejtimeve të ardhshme dhe të shkuarës së kohës. Megjithatë, të paktën ka tri shigjeta kohe që dallojnë të shkuarën nga e ardhmja: 1. Shigjeta termodinamike- drejtimi i kohës në të cilin çrregullsia*

shtohet; 2. *Shigjeta psikologjike- drejtimi i kohës në të cilin ne kujtojmë të kaluarën e jo të ardhmen.* 3. *Shigjeta kozmologjike- drejtimi i kohës në të cilin Gjithësia zgjerohet në vend që të tkurret*”. (Hoking.1997:152).

Së gjashti, përcaktohen pasardhësit e etnisë që janë të bashkësisë fillestare, nga ku këta pasardhës, kanë qenë së bashku, janë njohur si të tillë, janë identifikuar, kanë patur identitet, janë të ndryshëm nga një pjesë tjetër, nga pasardhës të tjerë, nga një bashkësi fillestare tjetër, por që të dyja të kenë ekzistuar paralelisht dhe të vazhdojnë të ekzistojnë po kështu, duke vijimësuar vetveten përmes elementeve që përbëjnë themelet e identitetit si ndjenjave, kujtimeve, tokës, familjes, besimit, të shkuarës, etj.

Së shtati, *kudo që të ndodhet*, - është fraza përmbyllëse e këtij përcaktimi. Lidhet me një tjetër drejtim, që Hoking e quajti *Shigjeta Psikologjike*, pra luajti me ndjenjat etnike të serbëve, duke u përkujtuar dhe kërkuar “*për të mos e ndarë kurrë këtë territor të debatuar*”. Siç vëren edhe Patrick Geary, “*Politikëbërësit dhe madje edhe shumica e studiuesve të Lindjes dhe të Perëndimit dinë shumë pak për këtë periudhë dhe akoma më pak për procesin aktual të etnogjenezës që solli në ekzistencë shoqëritë Europiane. Ndoshta nuk ka periudhë tjetër më të errët në histori dhe më të errësuar nga historiografia nacionaliste dhe shoviniste sesa kjo fjalë. Është pikërisht ky errësim që bën pre për propagandë etnike nacionaliste*”. (Geary.2003:35).

3.6 Ndikimi politik në rindërtimin e identitetit kombëtar

Edhe kur nuk duket në sfond politika vepron fuqishëm në prapaskenë sepse nuk mund të kuptohet krijimi i një identiteti kombëtar pa një politikë të caktuar përcjellëse. Janë raporte të dukshme, pavarësisht se ndoshta mund të ketë edhe qëndrime të cilat i shikojnë të

shkëputura këto elemente. Sigurisht që identiteti kombëtar nuk mund të quhet i konsoliduar nëse nuk ka kaluar përmes një politike të caktuar, e cila nga ana e saj mund të jetë një politikë e brendshme, ose e jashtme. Janë qëndrime me referencialitet të dyfishtë, sipas të cilit identiteti lidhet me dy boshte referuese:

a) politikë e brendshme

b) politikë e jashtme.

Së pari, raporti që krijohet përmes procesit të krijimit të identitetit kombëtar dhe politikës së brendshme. Sigurisht që këtu na del punë për të përcaktuar se për ç’lloj produkti politik bëhet fjalë. Ky produkt ka qenë i ndryshueshëm për epoka të ndryshme dhe kështu dihet që bota ka kaluar në disa sisteme të njohura politike, ku secili prej tyre ka patur karakteristikat e veta, strategjitë e veta në lidhje me pranimin e individit si një qenie identitare që zhvillohet drejt një identiteti kombëtar. Pa këtë analizë është e kotë të pretendojmë të dalim në përcaktime e përfundime rreth identitetit kombëtar pasi sisteme të caktuara politike kanë mbajtur qëndrime të caktuara ndaj individit dhe dëshirës së tij për të shpërfaqur një identitet të caktuar.

Me politikë të brendshme sipas qëndrimit tonë kuptohet ajo që ne mund ta etiketojmë duke e përafruar edhe me qëndrimin primordialist. Politikë e brendshme do të thotë ajo çfarë ne e komandojmë vetë për veten tonë, ajo çka ne e vetvlerësojmë vetë po ashtu për veten tonë, dhe e fundit ajo çka ne presim nga vetja jonë. Nuk kemi dhe aq ngatërresa sepse edhe elementet me të cilët ne kemi punë janë të pakta: toka, atdheu, simbolet, territori, gjuha, besimi, pra ato që më parë i kemi karakterizuar si elementet përcaktues të primordializmit. Të gjitha këto ngrihen mbi vetëdijen identitare me qëllimin e vetëm për të zhburgosur

pikërisht vetë identitetin, për t'i dhënë atij më shumë hapësirë dhe rol në krijimin e një identiteti më të rëndësishëm, atij kombëtar.

Struktura e identifikimit identitar vetëpërcaktohet duke e pasur si një aleat të fuqishëm edhe politikën. Ajo më shumë anon nga interpretimi i miteve të trashëguara, se sa në strategji e ideologji të mirëfillta. Lidhja me mitet e shtyn individin drejt dëshirës për të kuptuar qëllimin e ekzistencës së tij dhe në të njëjtën kohë e shtyn edhe drejt rrugëve për të paracaktuar sa më shumë vetveten. Politika gati identifikohet me mitin, mitologjinë dhe ai intuitivisht e vë këtë në përdorim të vetvetes. Nëse kemi parasysh se ideologji do të thotë “një strukturë mendore e bazuar mbi dogma”, dhe nga ana tjetër dogma është “tezë, e vërtetë absolute, saktësia e së cilës nuk është e vërtetueshme”, mund t'i përafrohemi edhe zbulimit të përcaktimit identitar me bazë ideologjike. Nga ana tjetër, prania e mitit dhe ritualit të inicimit ka si qëllim të “ushqejë” zbulesën identitare. E gjithë kjo shprehet nëpërmjet:

- a) Interpretimit të rolit të heroit mitik në vijimësinë trashëguese të grupit
- b) Potencimit të pranisë të simboleve si një kërkesë e brendshme individuale
- c) Ndërthurjes së paevitueshme mes këtyre të dyjave me qëllim vetëdallimin edhe si individ edhe si një bashkësi e mirëpërcaktuar.

Dhe ndodh që në momentin që kjo politikë e brendshme piqet, (kupto: qëndrimi primordialist qartësohet), të kemi fillimin drejt një hapi tjetër ku rolin më të rëndësishëm e luan politika e jashtme.

Së dyti, me politikën e jashtme edhe analiza jonë ndërlikohet, pasi në skenë dalin plot elemente të reja të cilat bëhen të domosdoshme dhe here - herë edhe relevante, e herë primare në përcaktimin identitar. Del në pah konstruktivizmi si një qëndrim shumë herë më i dallueshëm dhe primordializmi merret si i mirëqenë. Kuptojmë që jemi në kohën e

formimit të shtet-kombeve dhe fillesa e tyre paraqitet “si një bashkësi e pjesshme dhe jo shkrirje mes tyre”. (Seymour Siegel,2009). Nga ana e tyre këto fillesa ngërthejnë në vetvete disa qëndrime, ose më saktë, disa fakte, të pakundërshtueshme prej të cilave mund të përmendim:

a) “*Antonimia e parë- njeriu është i vecantë dhe universal në të njëjtën kohë*”, (Siegel.2009:62), përcaktim që na bën të vëmendshëm mbi dualitetin e përcaktueshmërisë së qenies dhe në të njëjtën kohë edhe të papërcaktueshmërisë së saj.

b) “*Antonimia e dytë pohon se krijimi i shtet -kombeve nuk mund të jetojë e zhvillohet pa formimin e një organizmi sado i vogël politik*”. (Siegel,2009:62)

c) “*Antonimia e tretë na shpie tek ekuilibrat që duhen vendosur në raportet e forcave, mes luftës dhe paqes*”. (Siegel.2009:66).

Roli i ideologjisë bëhet kryesor në këto moment, pasi njerëzit janë më të gatshëm të dogmatizohen dhe të mbajnë ideologjitë e tyre fort duke pretenduar se kështu arrijnë një shkallë zhvillimi, mbi të cilat më kryesori, mbetet krijimi i shteteve kombe. Por edhe në rastet kur kjo etapë është tejkaluar ne kemi një shtet të konsoliduar në bazë të të gjitha normave e parimeve, dhe gjasat për t’i dhënë karakter demokratik, apo totalitar janë pothuaj të njëjta, pra çdo anim i politikës nga njëri apo tjetri krah kushtëzohet vetëm nga interesat e pushtetarëve të momentit. Në rastin kur shoqëria anon drejt demokracisë, lidhjet me ideologjinë janë më të zbehta dhe kjo qëndron si një sfond ku veprojnë strategjitë afatgjata të zhvillimit të shtetit/kombit që po kjo vetë e merr si të mirëqenë. Ndërsa në rastin kur shoqëria anon drejt totalitarizmit, lidhjet me ideologjinë janë ekzistenciale për këtë të fundit. Ideologjia bëhet kështu promotori i veprimtarisë dhe i strategjisë afatgjatë të shtet/kombit dhe jo rrallë herë ideologjia i jep përparësi kombit në kurriz të shtetit, nën një maskë

kombëtare (dashuri për atdheun, tokën, nënën, gjuhën, besimin), kjo shoqëri nuk bën gjë tjetër veçse çimenton pushtetin e vet. Në kristalizimin e qëndrimeve identitare dhe të rrugëve që na shpion atje, ideologjia patjetër që është një qëndrim, një fakt që duhet marrë në konsideratë në nivel analize.

Si përfundim mund të definojmë se ideologjia me paraqitjen e saj nën politika të caktuara, është një element i pranishëm në përcaktimin e identitetit kombëtar, se ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me formimin e shtet – kombeve, dhe po ashtu bëhet përcaktuese në etapa të caktuara duke ndërruar vendet mes qëndrimeve primordialiste dhe konstruktiviste, sigurisht duke i dhënë përparësi këtij të fundit. Ideologjia dhe roli i saj në përcaktimin e koncepteve tona mbi identitetin kalon përmes shndërrimit të qëndrimit nga një politikë e brendshme/ primordialiste, në një politikë të jashtme/ konstruktivistëve. Në të dyja rastet produkti është i njëjtë- qenësia identitare dhe identiteti kombëtar. *“Të farkëtosh Europën e Re, do të thotë të farkëtosh një koncept të ri identiteti”*. (Maalouf.2006:148). Po a kemi një koncept të ri për identitetin?

3.7 Identiteti kombëtar si ideologji

“Dhomat e vogla, dhomat e shtëpive të banimit t’i mbledhin mendimet, dhomat e mëdha, sallat t’i shpërndajnë mendimet”. (Da Vinci.1999:18). Identiteti si një koncept bashkëkohor shënohet me dominante të ndryshme, mund të konsiderohet si proces i përzierjes së elementëve përbërës përcaktues pasi që, edhe pse dukuria është e ngjashme, qëllimi i kësaj rimarrjeje është i ndryshëm. Kjo do të thotë që nga njëra anë kemi

funksionimin e identitetit si i tillë dhe nga ana tjetër ky identitet po ashtu funksionon, por i transformuar në atë që e quajmë identitet kombëtar.

Historia na tregon se është eksperimentuar në këtë drejtim, mbështetur në disa shtylla të rëndësishme, bazike mbi të cilat janë të gjitha mundësitë e mbështetjes nga ana e individëve e bashkësive të ndryshme. Një nga këto shtylla të politikës është ideologjia. Loja që luhet prej tyre është e gjatë, zhvillohet shumë herë në kushte të pabarabarta. E shohim të arsyeshme të risjellim qëndrimet e shkencëtarëve në këtë rast, dhe kjo për të vetmen arsye sepse i shërben analizës sonë: *“Për të krijuar kombe të unifikuara dhe të veçantë, si edhe për të dhënë një ndjenjë të fatit të përbashkët për anëtarët e tyre, krijuesit e kombeve nxjerrin në pah dhe shfrytëzojnë në mënyrë të përshtatshme burimet dhe simbolet e ndryshme etnike që kanë në dispozicion (p.sh. kufijtë, toponimet, heronjtë, mitet, ikonografinë e shtetit e të tjera”*. (Bohr.1998:144). *“Rregulli i parë që ne duhet të ndjekim është ai i karakterit kombëtar: që e ka çdo popull, ose që duhet të ketë. Një karakter të cilin në qoftë se nuk ka, duhet të fillojë për t’a patur një të tillë”*. (Smith, 1991:75). Në *“Teologjia Politike”*, Baruch Spinoza shkruante se *“kur lexon se çfarë është shkruar nuk duhet verbërisht të ndjekim tekstin, por gjithmonë mos harroni ato që janë të fshehura në tekstet që lexohen, sepse kjo është një nga kërkesat e periudhës kohore dhe qëllimet e një regjimi në pushtet. Ai e jep këtë këshillë në mënyrë që lexuesi do të marrë në thelbin e diskutimit subjekt / çështje dhe nuk do që lexuesi të mashtrohet nga supozime dhe deklarata të rreme”*. (Spinoza.2001:38). Ky është një udhëzues mjaft i arsyeshëm dhe asnjë interpretim i fakteve apo ngjarje nuk mund të quhet objektiv: edhe historianët, ashtu si të gjitha qeniet e tjera njerëzore, janë subjekt i ndikimeve të ndryshme - emocioneve, vlerave të përbashkëta, besimeve, kërkesave të regjimeve etj.

Kur lexon Spinozën, dikush mund të arrijë në përfundimin, se regjimet politike ishin duke përdorur shkrimin, me qëllimin kryesor për të manipuluar opinionin e gjerë publik. Autorët nxjerrin në pah dhe theksojnë ngjarje të caktuara historike, si edhe i portretizojnë këto ngjarje si shumë të rëndësishme për ndërtimin e një shteti bashkëkohor. Ky veprim nxit për të pyetur nëse një logjikë e tillë e mbart një interpretim për të sfiduar atë në bazë të objektivitetit. *“Studiuesit, politikanët dhe poetët e shekullit të XIX nuk e shpikën*

ashtu thjesht të shkuarën: ata iu referuan traditave para-ekzistuese, burimeve të shkruara, legjendave dhe besimeve edhe kur i përdorën ato në mënyrë të re për të fabrikuar unitet politik apo autonomi. Procesi specifik nëpërmjet të cilit nacionalizmi i shfaq si një ideologji politike potente ka ndryshuar nga zona në zonë nëpër të gjithë Europën dhe përtej saj. Në rajone ku mungonin organizmat politike si në Gjermani, nacionalizmi dha një ideologji për të krijuar dhe shtuar pushtetin e shtetit. Në shtete të tjera si në Francë e Britaninë e Madhe, qeveritë dhe ideologët, i shtypën pa mëshirë gjuhët e minoriteteve, traditat kulturore dhe kujtimet e ndryshme të së shkuarës së tyre, në dobi të historisë së unifikuar kombëtare dhe të gjuhës e kulturës homogjene që do të pretendonte që të shtrihej thellë në të kaluarën. Në perandoritë polietnike, si në ato të osmanëve apo të hasburgëve, duke e identifikuar veten si anëtarë të minoriteteve të shtypura, individët e përdorën nacionalizmin për të pretenduar të drejtën jo vetëm për një ekzistencë të vecantë kulturore, po si rrjedhojë, edhe për autonomi politike. Nacionalizmi mund të përpiqet që të merret me kushtet ekzistuese të zgjedhjes së grupit të tij, por nuk mund të prodhojë vetë kushtet ekzistuese. Konteksti intelektual në të cilin u lind nacionalizmi modern ishte fillimisht të qenët të mrekulluar prej botës antike, gjë që krijoi skenën për një kthesë radikale të vetperceptimit dhe identitetit, duke përfshirë një herë e përgjithmonë shekuj të tërë identitetesh shumë të ndryshme sociale”. (Geary.2003:50).

Nga regjimet është i argumentuar përdorimi i institucioneve arsimore si një mjet për përhapjen e ideologjive kombëtare dhe krijimin e identitetit kombëtar, si edhe krijimin e identitetit në vendet përkatëse. Adresat e para të teorive të nacionalizmit dhe perceptimi i historisë të tyre janë primordializmi, modernizmi, dhe etnosimbolizmi. Nuk duhet lënë pa përmendur këtu edhe ndikimin e ideologjisë komuniste, sepse edhe këto vende u përfshinë nga ky sistem. Mund të kemi analiza interesante në prezantimin e rolit të ideologjisë në çështjen kombëtare, si edhe në përpjekjet për të shmangur atë rol të imponuar prej politikës së unifikuar komuniste përmes të cilave mund të kuptojmë më shumë edhe zhvillimet në trojet shqiptare. Kjo mund të përshkruhet në fazën e ardhshme si procesi i ndërtimit të kombit. *"Me heqjen e hegjemonisë së Moskës nga Azia Qëndrore, ish nderimi i detyrueshëm për Rusinë dhe rusët papritmas u zhduk. Në të njëjtën kohë, diskreditimi i imponuar i ideologjisë leniniste-marksiste krijoi një vakuum të çastit, duke i lejuar elitat kulturore të flasin me mendjet e tyre". (Allworth, 1998:84)*

Nevoja për të mbushur vakuumin udhëhiqet nga faktet sipas të cilëve ideologjia ndihmon për të bashkuar anëtarët e shoqërisë në një shoqëri më shumë ose më pak homogjene dhe në një grup të kontrollueshëm; dhe ideologjia ia mundëson regjimit në pushtet që të legjitimojë veten me anë të manipulimit dhe indoktrinimit. Ideologjia mund të perceptohet si një kordon i shoqërisë dhe mungesa e saj mund të përbëjë një kërcënim të kohezionit mes grupeve të ndryshme dhe individëve që banojnë në një komunitet.

Identiteti: besimet, idealet dhe aspiratat që kishin qenë të lidhura me sistemin sovjetik u diskredituan, ndërsa simbolet e kthyen të pakuptimtë.

Produktet artificiale të kufizimit kombëtar – kjo ishte e hapur për pyetje.

Projektet ideologjike synonin konsolidimin e shoqërive dhe ri-formimin e kombit.

Identitetet ose përditësimi i tyre për t'u përshtatur me realitetin e ri edhe në legjitimimin e regjimeve politike.

Megjithatë vlen për t'u vërejtur edhe një veçori e këtyre projekteve ideologjike. Përkundër këtyre qëllimeve origjinale, ideologjitë e reja do të kenë kontekste kombëtare në mënyrë që shënohet largimi nga e kaluara sovjetike dhe për të theksuar çështjen e pavarësisë kombëtare. Edhe për përdorimin e nacionalizmit, është e nevojshme të përmendet se në duart e aparatit shtetëror jodemokratik ai u bë një tjetër mjet për të arritur qëllime të veçanta.

Glenn argumentoi se *"karta kombëtare është luajtur për të mobilizuar masat për të mbështetur dhe për të përkrahur një interes të veçantë sektorial brenda shoqërisë dhe kjo nuk është vetëm e shkruar në një gjuhë që të kuptohet lehtësisht, por ajo është e përforcuar gjithashtu edhe nga premtimi se interesi kombëtar/ interesi i përgjithshëm i njerëzve do të jenë të garantuara me krijimin e një shteti që qëndron mbi interesat e ngushta sektoriale ekzistuese në shoqëri". (Glenn. 1999:41).*

Kjo analizë na ndihmon edhe ne për të përcaktuar vendin e shqiptarëve, qëndrimin që ata kanë mbajtur në raport me konceptet mbi identitetin kombëtar dhe nacionalizmin. Shqiptarët vijnë nga një e kaluar komuniste, ku ideologjizimi i jetës përbëntë hallkën kryesore të funksionimit të pushtetit. Përkufizimi marksist-leninist mbi kombin: *"... i cili është një bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar në bazë të bashkësive të gjuhës, territorit, jetës ekonomike dhe formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës"* (Agolli.1980:15), u bë në atë kohë baza e të gjithë qëndrimeve. Shqiptarët u formuan shumë vonë si shtet, si pasojë e mbetjes si një bashkësi periferike nën Perandorinë Osmane. Edhe në momentin që Shqipëria u shpall si një shtet më vete *"e lirë dhe e mosvarme"*, (Deklarata e Pavarësisë, 28

Nëntor, 1912), qëndrimi nacionalist (kupto: primordialist), nuk u zbeh aspak, përkundrazi, vazhdoi të rritej në regjistra të paparë që nga koha e Skënderbeut, por vlen të theksohet, me një ndryshim të madh: nëse në atë kohë, ky qëndrim primordialist ishte i kushtëzuar në bashkësi të vogla etnikisht të njëjta që tentonin një bashkim, po atëherë sa realiteti tentonte t'i ndante, më 1912, ky bashkim është kryer dhe bashkësitë e vogla kanë realizuar bashkimin e tyre nën një etni të vetme kombëtare, që do të thotë një perceptim i përgjithshëm si një komb më vete si në nivele elitare, ashtu edhe në nivele populiste.

Baza e arritjes së këtyre qëndrimeve padyshim që është qëndrimi primordialist, nacionalizmi i trashëguar dhe identifikimi ndryshe prej kombeve të tjerë fqinjë me shqiptarët. Siç vëren edhe studiuesi gjerman Johan Tunman: *“Asnjë popull tjetër i pjesës së botës në të cilën jetojmë nuk është atëherë i panjohur për ne evropianët e Perëndimit, përse i përket prejardhjes, historisë dhe gjuhës së shqiptarëve dhe vllahët. E, megjithatë, ata janë popuj kryesorë, popuj të lashtë e të rëndësishëm, që çdo historian do të dëshironte t'i njihje: historia e tyre do të plotësonte zbrazëti të mëdha në historinë e lashtë e të re të Europës.*

Por sot ata nuk luajnë më ndonjë rol, ata janë popuj të vegjël, të nënshtruar, ata janë fatkeqë dhe historiani shpesh herë është po atëherë i padrejtë sa edhe njeriu i zakonshëm: ai nuk i përfill atëherë që nuk i ka punuar fati.” (Tunman.1990:53). Kjo, por edhe faktorë të tjerë, sollën atë qëndrim edhe nihilist të Europës, qëndrim që e hasim edhe sot në nivele të politikave të BE. Historia dhe gjuha e shqiptarëve, përgjithësisht ka qenë një *“terra incognita”* për Evropën shkencore. Shqipëria as nuk ishte ende një shtet i pavarur dhe autonom, e rrjedhimisht, historia dhe kultura e saj u pa vetëm në kuadrin e një entiteti më të gjerë politik të Perandorisë Osmane, brenda së cilës, ajo nuk formonte më tepër se një

provincë europiane por mbeti mes Lindjes dhe Perëndimit, një fushë ku u përplasën si forcat centrifugale historike, ashtu edhe forcat centripetale të huaja.

“...Prej këtyre fuqive centrigugale shpjegohet fakti që shqiptarët kanë punuar e luftuar më tepër për të huajt sesa për vendin e tyre. Këto fuqi kanë qenë shkatërruese edhe për tërësinë nacionale sepse kështu ka humbur për kombin shumë pasuri populli e gjuhe, në kontrast me këto lëvizje centrifugale të popullit shqiptar janë derdhur mbi Shqipëri si kundërfuqi rryma centripetale të popujve të huaj. Shqipëria nga fati i saj gjeografik si qoshja më perëndimore e Gadishullit Ballkanaik të orientalizuar dhe në lidhësi më i afërm e tij me botën oksidentale të Gadishullit të Apenineve, si celësi i Adriatikut dhe si pike takimi i botës romane me botën greke e sllave, ka qenë, nevojisht, gjithmonë vend kalimi si pak vende të tjera dhe pikë lakmimi pushtuesish të huaj. Ky qëndrim i ndërmjetëm midis Perëndimit e Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë. Kjo shprehet në krejt mënyrën e jetesës, dhe në historinë kishtare, në zakone e doke dhe në poezi popullore të popullit shqiptar. Duhet shënuar me këtë rast se Shqipëria ka qenë më tepër e orientuar nga Perëndimi sesa fqinjët e saj. Lëkundja e Shqipërisë ndërmjet Ballkanit e Perëndimit na shfaqet, pothuaj ashtu si në Dalmaci, edhe në pikëpamje politike dhe jo më në fund gjuhësore, në mënyrë që elementet latine kanë pësuar në të dyja këto gjuhë një trajtim të ngjashëm”. (Çabej.1994:19).

Ky është shtrati në të cilin “u ngjiz” pak a shumë identiteti shqiptar, i cili më shumë se sa një ideologji, vjen si një qëndrim nacionalist me bazë të fuqishme primordiale. Nëse do të kërkonim më tej për këtë ideologji, ajo do të mund të kufizohej më së shumti vetëm nën një hark kohor të përcaktuar pra nga 1945-1990, periudhë e sunduar nga komunizmi. Në të gjitha periudhat e tjera historike, identiteti shqiptar pothuaj nuk ka lidhje me ideologjitë. Ai

buron nga dashuria e individit për tokën, vendin, trashëgiminë jetësore e kulturore dhe i shërben po aq fuqishëm kësaj dashurie e gjithë të tjerave, me një fjalë, thjesht, primordiale. Në etapa historike, kjo periudhë shihet që nuk ka peshë, kjo edhe për faktin se në thelb ajo ishte një ngjitje artificiale. Duke qenë e tillë natyrisht nuk do të mund të kishte jetëgjatësi, por vetëm të merret si një e dhënë dhe të zhduket me një “*deux ex machine*” politik.

Si përfundim, konkludojmë se ideologjia në rastin e identitetit shqiptar nuk ka qenë një faktor deciziv, por ajo më shumë ka qenë një zgjidhje artificiale konform zgjedhjeve politike të momentit të caktuar historik. Edhe në rastin kur ajo u imponua të ekzistojë, ajo kurrë nuk u bë faktor, megjithë presionin e fuqishëm nga ana e pushtetit. Në këtë periudhë të komunizmit letërsia dhe arti u ndikuan më shumë sesa jeta tjetër sociale, gjë që u pasqyrua edhe në tekstet e tyre letrare. Por edhe brenda tyre, siç do ta shohim më pas, pati përpjekje për autonomi të mendimit dhe mosbindje ndaj regjimit dhe kërkesave të tij për ideologjizim artistik. Edhe autorë që i dhanë tonin zhvillimit të letërsisë së asaj kohe si Agolli, Arapi, Kadare, etj, veç bindjes së detyruar, kush më shumë e kush më pak, kush më hapur e kush më kamufluar, arritën të ruajnë të pastër mendimet e ndjesitë e tyre kombëtare pa i përzier me ideologjitë e kohës. (P.S. Të mos harrojmë trysninë e pushtetit!)

3.8 “Shthurja” e variantit tradicional në rindërtimin e identitetit kombëtar

Përpara se të shkojmë në detajet teorike, përmendim se në dritën e fakteve, teori të ndryshme të nacionalizmit ofrojnë shpjegime të ndryshme edhe për ndërtimin e identitetit kombëtar dhe për rolin e historisë në këtë proces. Do të përdorim vetëm dy prej tyre:

primordializmin dhe modernizmin (konstruktivizmin) dhe kjo për dy arsye: Teoritë e nacionalizmit si edhe tendencat brenda tyre janë të larmishme pasi aty ekzistojnë edhe disa mosmarrëveshje ndërmjet kontribuesve mbi natyrën dhe origjinën e kombeve dhe nacionalizmit. Disa priren të besojnë se kombet kanë ekzistuar shumë kohë para shndërrimit të tyre në shtete moderne (nacionale), të tjerët argumentojnë se kombet janë (krijuar) sidomos kohëve të fundit për shkak të rrethanave të ndryshme që u shkaktuan. *“Politika e migrimit emocionalizon dhe mobilizon në fund të shek XX masat popullore në të gjitha vendet europiane më shumë se probleme të tjera. Kjo shpjegohet më pak me interesat konkrete materiale sesa me vlerën simbolike të çështjes që lidhet me identitetin kombëtar”*. (Alternat,2002:107).

Rikthehemi edhe njëherë në qëndrimin e mbajtur midis primordializmit dhe modernizmit, por kjo e parë nga një tjetër këndvështrim nga ku raportet mes primordializmit dhe konstruktivizmit, kufirin e tyre kanë tendencë ta zbusin dhe ta tjetërsojnë me vetëdije, jo si një detyrim i rrethanave historike, por si një domosdoshmëri në përcjelljen e kuptimit të strategjive identitare kombëtare pasi edhe pse dukuritë janë të ngjashme, qëllimi i rimarrjes është i ndryshëm ku nga njëra anë funksionalizon qasjen subjektive të individit ndaj qëndrimit kombëtar, nga ana tjetër ndihmon në potencimin e globalizmit, universalizmit identitar në kohën moderne. Rrafshet e ndryshme na çojnë drejt fillimit të analizave duke i përcaktuar së pari nën një bosht koordinativ, ku në aksin vertikal do të kishim vendosur qëndrimin primordialist e në aksin horizontal do të kishim vendosur konstruktivistët. Tek primordialistët e kaluara është e trashëguar dhe pjesë organike identitare, (aksi paradigmatic), aksi i përzgjedhjes, referencialisht tek dashuria për atdheun, vendin, token, baltën, fisin, nënën dhe gjithë elementet e njohur tashmë; tek konstruktivistët historia e re

është më e rëndësishme, (*aksi sintagmatik*), ose aksi i kombinimeve. Çdo njësi e aksit sintagmatik përbëhet nga një ose më shumë krijime të shteteve në kohët tona duke u bërë përherë e më globaliste, një proces që primar ka shpërbërjen e qëndrimit tradicional në ndërtimin e kombeve e qëndrimeve identitare. Nga kjo del se kuptimi në ndërtimin e sotëm të kombeve e identiteteve kombëtare, lidhet me aftësitë e bashkësive për të dekodifikuar mesazhet e kriptuara nga historia. Nga kombinimet e ndryshme politike përftohet një qëndrim i ri mbi koncepte tepër të njohura. Kjo është arsyeja që në kohën tonë qëndrojnë përballë njëri-tjetrit nën marrëdhënie reciproke si primordializmi ashtu edhe konstruktivizmi, si identiteti kombëtar i mirëpërcaktuar në Kohë e Hapësirë, i ngurtësuar tashmë po prej kësaj Kohë e Hapësire, ashtu edhe identiteti kombëtar i papërcaktuar në Kohë e Hapësirë, gjithnjë në kërkim e lëvizje pikërisht në këtë Kohë e Hapësirë.

Kemi kështu një ndryshim të dukshëm në ndërtimin e identitetit kombëtar. Nëse më parë primare ishte gjuha e përbashkët e një bashkësie, territori, jeta, ritet e zakonet, besimi fetar, të cilët e veçojnë këtë bashkësi nga të tjerat dhe kështu ajo i ka të gjitha shanset të krijojë kombin e vet e më pas shtetin e vet. Tashmë primare bëhen faktorët e jashtëm, politika e momentit, interesat ekonomike, gjuha, territori etj e kjo para se të kthehet në një çështje përmbajtjeje është një çështje forme me ruajtjen të një koncepti të vetëm-rrënjët. *“Nocioni rrënjët, përkundër statusit ose arsyes si themel i identitetit ka pasur forcë të madhe tërheqëse dhe rrjedhoja të thella. Natyrisht, riorganizimi i shoqërisë, nga srukturat e ngurta hierarkike të pellgjet e ndryshueshme të njerëzve me të njëjtën kulturë të lartë dhe të mbrojtur nga i njëjti autoritet politik, solli një preokupim shumë të madh për Rrënjët”*. (Gellner.1997:91).

Bota sot dhe gjithëherë, është në luftë dhe këto luftëra herë zmadhohen e përfshijnë brenda tyre shumë kombe, shtete dhe për pasojë edhe përfundimet e tyre janë me pasoja shumë të thella, nganjëherë edhe të pariparueshme e herë pas here këto luftëra zhvillohen nën një spektër më të ngushtë, më të heshtur, por në thelbin e vet po luftëra mbeten. *“Të kuptosh Romën, -pohonte Agustini- do të thotë të kuptosh “dashurinë e Romës për madhësi. (libido dominandum). “E vetmja paqe e arritur ndërmjet kombeve, pohon Agustini, është ajo që quhet “paqe e varrezave” dhe ndodh atëherë kur për një kohë të gjatë fitimtarët drejtojnë të rëthuar nga një lloj heshtjeje”.* (Rains.2002:75). Siç shihet edhe nga kjo parashtrësë e shkurtër përsëri arrijmë në përfundimin se të përcaktosh sot identitetin nuk është edhe aq e thjeshtë. *“Duke u mbështetur në të njëjtat libra, mund të pranojmë skllavërinë apo ta dënojmë, të respektojmë ikonat ose ti hedhim në zjarr. Teksti vepron mbi realitetin, i cili, në disa epoka ndalet në fjali të caktuara dhe në disa të tjera, shkon shkarazi pa i parë ato. Për këtë arsye nuk ia vlen të pyesësh se ç’thotë me të vërtetë krishtërimi, islamizmi apo marksizmi. Shekulli i XX na ka mësuar se asnjë doktrinë nuk është në vetvete domosdoshmërisht çlirimtare, ... të gjitha i kanë duart të lyera me gjak, komunizmi, liberalizmi, nacionalizmi...”.* (Maalouf.2006:49-50).

Ky proces sot ndodh duke respektuar disa tipare dalluese të kohës sonë: 1. Prirja drejt konservimit të identitetit të përditshëm që realizohet përmes: A) Njerëzit për arsye tepër praktike, të mbijetesës ekonomike vrapojnë të gjejnë punë në kombe e shtete të tjera. Për të qenë sa më i integruar, atij i duhet të përshtatet, kjo do të thotë, që ai e mbyll thellë në kujtesë përkatësinë etnike, e kështu i jep një kuptim të ri identitetit të tij. B) Përmes prirjes së harresës, qoftë për atë brezin e parë në vendin pritës, e aq më shumë për brezat pasardhës.

2. Nga rendja drejt afërisë shpirtërore, gjuhësore e besimit, konvertimet e nxituara të këtyre besimeve duke e rritur artificialisht masën e kriptove. Kësisoj identiteti mbetet përsëri peng i shumë pikëpyetjeve.

3.9 Nga nacionalja drejt identitetit kombëtar

Qëllimi i kësaj përjasjeje teze është për të testuar hipotezën mbi rolin e historisë në krijimin e identitetit kombëtar dhe në proceset e formimit. Thënë edhe në mënyrë më të saktë, janë testuar disa supozime mbi dy raste me ndihmën e teorive ekzistuese të nacionalizmit: primordializmi dhe modernizmit në veçanti. Të dyja këto teori përfshijnë në identitetin dhe (ri)projekte kombëtare të ndërtimit dhe për të arritur qëllimet e tyre ata e ri-shkruan historinë e shteteve të tyre. Projektet për formimin e identitetit të tyre kombëtar mund të ofrojnë dy lloje rezultatesh - pozitive dhe negative. Nacionalizmi qytetar – domethënë identifikimi publik i bazuar në shtojcën qytetare dhe /ose identifikimi me shtetin dhe konsolidimi i shoqërisë rreth ideve politike, ndërsa pjesëmarrja dhe zhvillimi demokratik mund të perceptohet si një rezultat mjaft pozitiv. Krejtësisht e kundërta ndodh me nacionalizmin etnik – domethënë me identifikimin përgjatë vijave të tilla etnike si gjuha, kultura dhe tradita, me etnitë e caktuara “të ngulitur dhe të paracaktuara”. *“Rolet në procesin e jetës dhe të politikëbërjes sociale janë që të perceptohet si diçka shumë negative rezultati i projekteve për formimin e identitetit”*. (<http://www.msu.edu/user/hillrr/161lec16.htm>. (parë më 30 prill 2014).

Kjo shërben jo vetëm për interesa të caktuara politike, por edhe për shkak se ajo përçan çdo shoqëri përgjatë vijave etnike dhe presupozon konfliktet etnike. Krahas identitetit, bazuar edhe në besnikërinë historike ndaj elitave të pushtetit rritet qasja për pushtet në grupe të

caktuara brenda shoqërisë dhe vendoset autoritarizmi. Ashtu si edhe Shirin Akiner ka vënë në dukje, *"Shtetet nuk janë njësi mono-etnike, por në kompleks janë shoqëri plurale me popullsi të mëdha të emigrantëve. Privilegji i trashëgimisë së një grupi mbi të tjerët në mënyrë të pashmangshme krijon pakënaqësi të shumta, por krijon gjithashtu edhe frikën e dominimit etnokratik. Në kohën e këtij stresi akut social dhe ekonomik, lehtësisht kjo gjë çon në polarizimin etnik dhe marginalizim". (Akiner,1995:363).* Ky është studimi i historisë kombëtare (ose më mirë i historisë së ri-shkruar, të ri-thënë dhe të imponuar nga regjimet politike) që ndërtojnë këto lloje rezultatesh.

Qëllimi për të studiuar të kaluarën sigurisht që nuk ka asgjë të keqe dhe nuk ka pse të qëndrojnë e fshehur axhenda prapa studimit të pushtuesit. Për të kuptuar më mirë logjikën e këtij projekti, është e nevojshme të kontrollohen teoritë ekzistuese të nacionalizmit. Njëra prej këtyre teorive do të jetë teoria e ndërtuar në mënyrë primordiale. *Cornell dhe Hartman (1997) argumentojnë se identitetet nuk janë asgjë më pak se sa vetë konceptet artificiale që pohohen apo caktohen për opinionin publik. "Njerëzimi," origjina e përbashkët", dhe "lidhjet e gjakut", nëse pohohen apo caktohen, formojnë në shumicën e kulturave një sërë obligacionesh të fuqishëm ndërnjerëzorë, por gjithësesi fuqia e tyre nuk është e natyrshme. Ajo shtrihet në rëndësinë njerëzore, në qeniet që i bashkëngjiten atyre, pra një domethënie që është e ndryshueshme dhe një kontigjent krejtësisht të krijimit të njeriut". (Cornell, Stephen, Douglass Hartman, 1997:89).*

Këto ide kur zhvillohen duhet të mundësojnë përfundimin se projektet e ndërtimit të identitetit qëndrojnë nën mbulesën e *"rilindjes kulturore"* nismave të nisura nga regjimet. Nacion – është njësia kuptimore që del nga bashkimi potencial i këtyre elementeve, që do të thotë komb. Historia e formimit të shteteve mbi bazën e kombeve të konsoliduara, na tregon

disa raste. *“Nacionalizmi nuk është as universal i domosdoshëm, as i rastësishëm e aksidental, frut i penave të ngeshme e i lexuesve naivë. Ai është rrjedhojë e domosdoshme ose dukuri korelative e kushteve të caktuara sociale, kësisoj, nacionalizmi nuk është aksidental, ai ka rrënjë të thella, ai ka qenë fati ynë. Kësisoj pozicioni ynë lidhur me problemin e domosdoshmërisë e rastësisë, është ai i mesit: - i mohon të dyja ekstremet - dhe pohon se nacionalizmi është me të vërtetë një domosdoshmëri në kushte të caktuara (që duhen specifikuar), por vetë këto kushte nuk janë universale”.* (Gellner.1997:24). Të mbash kursin e nacionalizmit në kushtet e globalizmit nuk është edhe aq komode. Kjo, për faktin se gjithnjë nacionalizmi, (ai ekstrem), ka gjeneruar dhunë e luftëra me humbje të mëdha. Nëse përdoret vetëm në nivele teorike të elitave politike, nuk ka asgjë të keqe, veç identifikimit të vlerave identitare të grupeve të ndryshme etnike, e kombeve. Por nëse përdoret po prej këtyre elitave politike, jo më për qëllime paqësore, atëhere raporti përmbysset dhe do të kishim vetëm luftë irredentiste, pushtime, ekspansion, dhunë, masakra, gjenocid. Siç vërehet edhe në Konferencën e Ambasadorëve të Paqes, në Maj 2012, në Prishtinë: *“Fakti që deri tani BE ka qenë e drejtuar dhe monopolizuar nga elitat politike, ka prodhuar një asimetri të rrezikshme. Është e nevojshme të zbatohet një integrim politik i bazuar në mirëqenie sociale, në mënyrë që pluralizmi kombëtar dhe pasuria kulturore e biotopeve të Evropës së vjetër, mund të mbrohen nga sheshimi i një globalizmi gjithnjë e më të shpejtë”.* (Habermas.2012:127).

Vëmendja ndalet tek etiketimi *“pluralizëm kombëtar”*, një term i ri ky që mbart në vetete politika të reja. Është e kuptueshme që ky emërtim ka ardhur si pasojë e studimeve rigoroze të epokës sonë dhe të prirjeve të saj dhe ka një destinacion të cilin e mbart me vete si shenjim i lindjes së po atij vetë. Kuptohet që jemi në kohën e pluralizmit që ngërthen jo

vetëm idetë, besimin, kulturën. Shoqëria jonë, edhe ajo e dalë nga sistemi komunist, është një shoqëri pluraliste. Por qëndrimi i Habermas e shtrin këtë koncept më gjerë kur flet për kombet, të cilat i merr si të mirëqena, por jo të plotësuara në raport me kombe të tjera dhe na jep këtë koncept. Pluralizëm i kombeve do të thotë interferim me njeri-tjetrin në nivele besimi, kulture, sistemi. Ky koncept i lejon kombet të ruajnë integritetin e tyre, ta pasurojnë atë me atë të kombeve të tjera e në të njëjtën kohë të kenë identitet kombëtar të paprekur. Në fakt është një problem shumë i mprehtë sot, kur bota vrapon pas globalizmit duke e trajtuar këtë të fundit *“herë si një gomë shpëtimi, e herë si një trap lundrues”*. Prania e këtij koncepti në praktikë nuk është gjë tjetër vecse Europa e Bashkuar. Nuk është objekt i këtij punimi, por vetëm sa do ta cekim për referim, sa për të vazhduar analizën tonë faktin që *“...në botë ka më shumë se 5000 grupe etno-kulturore në kombinime të panumërta. Problemi i vërtetë që has BE është multikulturalizmi, një term i përdorur si fakt”*. (Blair, Toni, 2010).

Si përfundim, së pari, mund të theksojmë që nacionaliteti dhe identiteti kombëtar janë të lidhur pazgjidhshmërisht me mijëra fije herë të dukshme e herë të padukshme. Së dyti, Nacionalja e përcakton identitetin, po aq sa ky i fundit, përcakton nacionalitetin. Së treti, deri diku identiteti ka pika të ngjashme me nacionalitetin dhe kushtëzohet prej tij, por në pikat e tij të veçanta nacionaliteti e humb kuptimin e parë. Së katërti, pjesë të identitetit përbëjnë nacionalitetin, korniza është nacionaliteti, ndërsa identiteti janë copëzat e mozaikut. Së pesti, në kohën e sotme, në bashkëkohësi, konceptet e identitetit dhe nacionalitetit janë sfumuar, kanë dalë në plan të dytë, sepse romantizmi relevant e idealist ka mbetur në hije si dëshmi e një kohe që nuk është më. *“Konfliktet nacionaliste kanë shkaktuar vuajtje shumë të mëdha, drejtpërdrejtë ose tërthorazi. Nacionalizmi nuk është thjesht një fenomen, është*

gjithashtu një problem. Nuk ka asnjë formulë magjike për ti paqtuar konfliktet etnike e për ti zëvendësuar ato me ëmbëlsi dhe dritë. Ai do shërim dhe dritë. Duke iu bashkangjitur shumicës së heshtur, çdo individ ose grup i veçantë i shton mundësitë e Pages”. (Gellner.1997:126).

3.10 Identiteti dhe dhuna

Krijimi i popujve në të gjithë botën ka një fillesë të vetën, e cila herë duket në rrjedha të historisë e herë na zhduket dhe ne e kemi shumë të vështirë të shkojmë deri tek gjeneza. Kjo ka ndodhur edhe për popullin shqiptar. Etnogjeneza ilire-shqiptare ka qene prej kohësh, që nga shekulli XIX objekt studimi, sepse vetë prania e shqiptarëve, prania e një gjuhe të ndryshme nga të gjithë popujt fqinjë si dhe emërtimet e ndryshme na sjellin një përfundim: që jemi një popull shumë i lashtë me një etnogjenezë të mirëpërcaktuar, por të keqinterpretuar e të anashkaluar nga historiografia politike. Kështu ajo që na bie në sy padyshim mbetet dhuna. Vendosja e supremacies së pushtetit e ligjit, sundimi me dorë të hekurt nuk është gjë tjetër veçse dhunë ndaj identitetit të individit dhe asaj që ai ndjehet biologjikisht. Sa për Shqiptarët vlen të theksohet se parardhësit e tyre, ilirët, nuk u asimiluan, mbetën po në ato territore, ndërruan pafundësisht pushtues duke përqafuar me dhunë vetëm pjesën “nën një ligj...” po jo atë “...nën një emër”. Në këtë mënyrë ata arritën të ruajnë veçantinë e tyre si popull edhe pse ishin të dallueshëm prej të tjerëve sa shumë herë u trajtuan si barbarë, por përsëri kjo nuk i pengoi ata që të ruanin traditën e tyre, të veçantë. “*E rëndësishme në pikëpamje të historisë së kulturës na paraqitet pyetja nëse Shqipëria duhet konsideruar si një njësi apo si një mozaik. Kur nga mesi i shekullit të*

kaluar filluan studimet rreth Shqipërisë prej burrash të pajisur me kulturë mendore të lartë e të gjerë si Ami Boue, Hahn etj, u duk e natyrshme që Shqipëria me gjithë ndryshimet e saj lokale, t'u kqyrte si tërësi e njëjtë e të vihej si e tillë përkundrejt viseve të tjera të Ballkanit. Për të kuptuar duhej rrahur vendi nga njëra anë në tjetrën. Populli shqiptar paraqitet gjeografikisht si njësi. Kulla, që e ndeshim kudo ku ka shqiptarë nëpër Ballkan është edhe në natyrën individualiste të shqiptarit. Me rritjen e familjes zmadhohet oborri, bëhet lagje, fis dhe së fundmi katund i tërë fisnor. Edhe sot katundet janë të tillë". (Çabej.1994:29).

Dhe ja tek jemi, duke vazhduar së bëri zgjedhje, për të përcaktuar përparësinë që i bashkëngjitet të gjithë përbërësve të identitetit tonë. Shpesh herë zgjedhje të tilla janë të qarta, por të komplikuar dhe në pamje të parë duket se është e tepërt të flasim për dhunë ndaj identitetit tonë. Kemi një dhunë të fshehur që vepron në ne dhe na orienton drejt qëndrimeve tona. Ky proces ndodh brenda nesh dhe ne veçse i bindemi instiktit të mbijetesës dhe zërit të arsyes që na orienton drejt përzgjedhjeve identitare. Në këtë rast, e vetmja që na ndriçon e na udhëheq është dëshira për të jetuar si të tjerët (europianët). Meqë ata, na përjashtuan ne nuk tërhiqemi po gjithnjë tentojmë të bëhemi ata. Në këtë rast do të kishim një dhunë të pjesshme, por të mos harrojmë se bëhet fjalë për dhunën që ndodh brenda nesh e provokuar nga rrethanat e jashtme.

Tiparet specifike të krijimit të identitetit nën këtë referencialitet multiplanesh, nuk i shmangin asnjë prej tyre. Përftesat identitare (teritori, gjuha, besimi) ndihmojnë në operacione të tilla si: ekzistenca, zvogëlimi, shndërrimi, humbja, rilindja. Në këtë mënyrë identiteti nën dhunë, lidhet me “*botën jashtëmeditative*” nga njëra anë, por pa humbur tipare të qenësishme të tij si artefakt filozofik. Kjo e mesme e artë (që lidhet me përcjelljen e objektives/ asaj që ka ndodhur/të vërtetës, nëpërmjet dhunës), është specifike e teorive të

ngritura mbi identitetin. Nuk mund të lemë pa përmendur faktin se gjithnjë dhuna që ushtrohet mbi identitetin ka një referencialitet të shumëfishtë, që mund të jetë kështu:

1. Identiteti i krijuar me dhunë të brendshme. Një individ i cili kërkon me patjetër dhe shumë shpejt të identifikohet nga një bashkësi që nuk është e vetja dhe për të cilën nuk ka kohë as dëshirë të përshtatet si një kundërpeshë për të qenë ai që kërkon tjetri. Individu e bind veten shpejt, për tu identifikuar dhe ky veprim nuk është gjë tjetër veçse një dhunë.

2. Individu shkon drejt identitetit të vet duke iu përmbajtur traditës. Ruajtja dhe rimarrja e traditës në tërësinë e jetës në bashkësi, në njësinë etnike ku gjendet ky individ. Nëse do e kërkonim dhunën në këtë pikë, ajo padyshim do të ishte tek mohimi i traditave të tjetrit, në emër të pohimit të traditave të veta dhe kjo është një lloj dhune ndaj tjetrit.

3. Identiteti i krijuar me luftë të jashtme. Ka lidhje të drejtpërdrejtë me politikën, kërkesat, mekanizmat dhe mjetet që na çojnë drejt krijimit të një identiteti të ri, të ndryshëm nga ai i pari, megjithëse jo plotësisht i pastër. Kështu ne kemi një përqindje trashëgimie dhe sa më e ashpër dhuna, aq më i shpejtë procesi i riidentitetit.

4. Identiteti i zhvilluar nën pasoja rrethanash. Individu fokusohet drejt një identiteti të ri, të imponuar nga rrethanat dhe gjendet përballë një alternative të vetme: ose të jetojë, ose të zhduket me familje e fis. Është e kuptueshme që ai do të zgjedhë të jetojë por ka edhe përjashtime ku popuj me vetëdije të fortë identitare kanë zgjedhur flijimin, por jo asimilimin, tjetërsimin. Ne jemi dëshmitarë të ikjeve të shqiptarëve drejt perëndimit, jemi dëshmitarë të pranimit prej tyre të kushteve të tjetrit, nënshtrimit ndaj rrethanave, psh kur ndërrojnë zyrtarisht emrat dhe përkatësinë fetare.

5. Identiteti i humbur. Proces që ndodh nën pushtime të egra e gjakatare. Dhuna e përhershme, egërsia gjithnjë e në rritje e ushtrimit të saj, mungesa e plotë e çdo hapësire tjetër për të jetuar, trysnia që vjen prej fesë së dhunuesit, pushtetarit, ndalimi i arsimimit në gjuhën amtare, ndëshkimi model për këdo që tenton të mendojë e të veprojë ndryshe përbëjnë premisa të mjaftueshme që një individ i ndodhur në të tilla rrethana të humbasë identitetin e vet. Është një proces që zgjat me shekuj deri sa individ i të mos mbajë mend më kush ishte në fillim.

Në të vërtetë është mjaft e vështirë të zhdukësh kujtesën e një kombi, një etnie. Por historia edhe këtu është kokëfortë dhe na servir fakte ku etni e popuj janë zhdukur, janë transformuar brenda një kornize të caktuar. Është ende e freskët përpjekja sllave për të humbur identitetin e shqiptarëve, gjë që nuk ndodhi. Në njëfarë mënyre, heronjtë e Agollit, kush në një mënyrë e kush në një tjetër, secili përmes një bote të vetën, përpiqen të gjejnë dhe krijojnë identitetin e tyre të qenësishëm, duke vërtetuar atë që thotë Amartia Sen se *“Dhuna lind nga ato identitete të vetme dhe armiqësore, të imponuara në njerëz me lehtëbesim, të përkrahura nga mjeshtra të zotë të terrorit”*. (Sen. 2011: 18).

6. Identiteti i përhershëm. Është dukshëm, i prekshëm dhe vital dhe që evoluon me zhvillimin e gjithë shoqërisë por nuk humbet. Ai na dhuron diversitet etnish, kombesh, kulturash, gjuhësh, besimesh dhe është ai që na paraqet hartën e sotme. Ka perceptim të fuqishëm për veten, nuk i ndërron kollaj mendimet e qëndrimet e tij, e ushqen veten gjatë gjithë kohës me kulturë, besim, dashuri, e në të njëjtën kohë respekton ligjin. Shqiptarët janë shembulli më i mirë i këtij qëndrimi. *“Fati i shtetit të ri ishte i pasigurt pasi ai kërcënohej nga ujqërit fqinjë dhe mbrohej nga patriarkë të largët. Shqipëria kishte një popullsi prej një milionë banorësh dhe ishte shteti më i prapambetur ekonomikisht dhe intelektualisht në*

*gadishull. Bashkimi i vendit ndalohej nga lufta mes blloqeve në veri, nga ekzistenca e feudit dhe nga mosmarrëveshjet fetare aq sa qeveria e vendit nuk arriti të bashkonte trevat shqiptare. Shpërthimet e brendshme vazhdonin. Padyshim një shtet shqiptar do të ndihmonte ruajtjen e paqes në rajon, dhe do të ishte një mrekulli nëse do të krijohet brenda një dhjetëvjecari pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore". (Schevill,2002:416). Në këtë rast qasja identitare është e kthjellët dhe një nga qasjet më të dukshme është ajo klasore. Problemi i shqiptarëve kthehet në një identitet klasor brenda territorit të tyre, brenda ruajtjes së gjuhës së tyre, e besimit në tërësi. Është një qëndrim perceptues i realitetit që i vendos palët e së njëjtës etni në një iluzion që pjell dhunë, sepe në këtë mënyrë u hiqet mundësia e lirisë së mendimit. Ndonëse *ex catedrae*, këto konflikte ndërtohen pikërisht mbi iluzione, në shtrembërime të pafajshme të realitetit. Po nëse kjo dhunë, ky konflikt do të zhvillohet, atëherë detyrimisht individët shkojnë drejt dhunës së kultivuar dhe kjo shoqërohet me gjakderdhje të mëdha e me luftëra. Në këtë mënyrë nuk bëhet gjë tjetër veçse pretendohet që individët që përbëjnë një bashkësi të caktuar klasore, etnike, besimi e kulture, të mos funksionojnë më si një e dhënë multifunksionale, por të rriten si qenie njëdimensionale, të privuara nga mendimi i lirë dhe nga e drejta e fjalës. Këto janë veprime që bëhen vetëm në kushtet e ekzistencës së një identiteti të përhershëm.*

Si përfundim: Në këtë kapitull trajtuam rastet e shfaqjes së elementit të dhunës në ekzistencën e identitetit. Treguam arsyet dhe faktorët që çojnë në përdorimin e saj, treguam pasojat dhe eksperiencat historike në përdorimin e dhunës dhe në veprimin që ajo ndikon në identitet. Treguam se identiteti i përhershëm është në fakt shtrati më i përhershëm i përdorimit të dhunës ndaj identitetit. Vumë re gjithashtu se liria jonë për të perceptuar veten, ashtu sikur të tjerët na perceptojnë ne është e kufizuar nga vetë mendja jonë. Jo gjithmonë

fajtorë janë fitimtarët e luftrave në humbjen e identitetit. Posaçërisht Ballkani ka konflikte të hapura gjë që e bën të paqëndrueshëm këtë rajon, politikisht, dhe shumë konservator etnikisht. *“Duhet të kujdesemi mbi të gjitha, që mendja jonë të mos përgjysmohet nga horizonti”*. (Sen.2006:194).

KAPITULLI IV. ANALIZA E VEPRAVE.

“Ne identifikohemi kollaj. Kemi identitetin tonë dhe duhet ta ruajmë me fanatizëm”.

Dritëro Agolli

4.1 Hyrje

Identiteti kombëtar dhe kombëtarja, në letërsinë shqipe të Realizmit Socialist në përgjithësi dhe tek Agolli në veçanti, është mjaft i dukshëm. Kjo, jo vetëm për shumë arsye që u trajtuan në kapitujt e mësipërm, por edhe sepse identiteti është forma më e mirë e përfaqësimit dhe e qasjes së vetvetes me të tjerët dhe ndaj të tjerëve. Agolli këtë tipar e ka sjellë dhe risjellë në krijimtarinë e tij duke u fokusuar tek një larmi personazhesh që dukshëm përbëjnë ndryshimin.

Kapitulli i katërt i punimit, duke u bazuar në metodologjinë dhe modelin teorik e historik, analizuar në kapitujt e mësipërm, kërkon dhe arrin të shqyrtojë mënyrën se si ndërtohet dhe përcillet identiteti kombëtar duke u fokusuar në elementë të ligjërimit dhe në ligjërimin specifik të secilit prej personazheve që luajnë rol kryesor në këtë krijimtari letrare. Ky identitet i tyre përveçse ligjërimor kompletohet dhe me elemente politike e ideologjike, e lidhur kjo dhe me tipare të periudhës kur u shkrua vepra, periudhës kohore (historike) së cilës i referohet dhe kontekstit historik në të cilin merr jetë dhe vitalizohet.

Duke qenë se janë përzgjedhur 11 vepra letrare, elementet dhe konceptet ligjërimorë janë marrë herë për ndonjë vepër a personazh në veçanti, e herë për disa prej tyre në përgjithësi duke i përfshirë në grupe sipas specifikave të ngjashme. Karakteristike në ndarjet e para është përdorimi i termave *Heroi* dhe *Njeriu i Ri* për disa arsye specifike që lehtësojnë objektin e studimit. E para, heroi sepse personazhi i Agollit, është hero që lufton me forcën e vet së brendshmi e së jashtmi, duke krijuar situata të ndryshme ligjërimore dhe duke u

përballur me to për të ndërtuar dhe legjitimuar identitetin e tij personal (individual) dhe atë kombëtar. *“Njeriu është fuqia e brendshme e veprës së Dritëro Agollit...i cili si rregull njësohet me vetë autorin, ndërsa në prozë e dramaturgji, në të kundërtën, njeriu personazh shfaqet i pavaruar nga autori”.* (Sinani.2009:268).

Secili prej këtyre rasteve shpjegohet përmes kritereve të analizës kritike të ligjërimit dhe situatave që krijohen. E dyta, Njeriu i Ri, sepse, këtu u largohemi miteve tradicionale dhe u referohemi miteve që krijoi vetë sistemi politik i kohës. *“Realisht Njeriu i Ri” shqiptar, shfaqet thelbësisht i ushqyer me moralin komunist. Është një njeri thellësisht etik dhe vjen nga poshtë. Prej kësaj rrjedh se ... fshatarët, të varfërit, punëtorët, bujqit përfaqësojnë origjinën sociale të preferencave për të patur një njeri të Ri, të vërtetë”.* (Nikolla, A, 2012:32). Ky hero vepron në vetvete nën një trysni ideologjike siç ishte teoria e Realizmit Socialist për formimin e Njeriut të Ri me të gjitha dimensionet për t’iu nënshtruar sistemit dhe pushtetit të tij. Kjo sepse... *“Njeriu i Ri nuk është një njeri intelektual (ai që di), por një njeri që karakterizohet nga sjellje të përcaktuara nga morali komunist (ai që bën). Një intelektual e ka të vështirë të bëhet një njeri i ri”.* (Nikolla. 2012:32). Edhe këtu kemi analizën e ligjërimit të personazheve nën këtë frymë dhe të situatave apo ngjarjeve ligjërimore që krijojnë.

4.2 Prezantim i shkurtër i romaneve të marrë në analizë.

***Komisari Memo (1970),** ndoshta për shkak të ngjyresës së fjalës "komisar", është një libër që shpesh është gjendur i ekspozuar kritikës. "Komisari Memo" është një vepër tipike e realizmit socialist, në kuptimin e nënshtrimit ideologjik (ndaj frymës së partisë) dhe artistik

(ndaj kanoneve). Vështirë të thuhet po. Së pari, sepse vetë figura qendrore e romanit, komisari Memo, është brenda llojit të "njerëzve të krisur" që përmban në tërësinë e vet letërsia e Dritëro Agollit. Ai nuk është një komisar i ngrirë në rregulla e mendime, si dy paraardhësit e tij, që komandanti Rrapo i kishte përzënë pa e zgjatur. Komisari Memo, "patriot i një kohe të re", e gjen pa vështirësi gjuhën e komunikimit me "shqiptarin e vjetër patriot" komandantin Rrapo, që ngjan si i thirrur prej kohës së komitëve. Ai është një hero që herë-herë e shkel disiplinën, bën gabime, dashuron një vajzë në një kohë kur për cënim të kësaj tabuje, mund të merrje vendimin e pushkatimit nga gjyqi partizan, nuk bën "trimëri sokolash".

*** Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo (1973).** Kontributi më i rëndësishëm letrar i Agollit në prozë është "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" (1973). Ky roman është kronikë e karrierës së palavdishme të një zyrtari "në vijën e Partisë", por në të njëjtën kohë është dhe pasqyrë e pozitës së mjerë të vartësit të tij, Demkës, një kalemxhi i stërvitur, që pak nga pak është ndarë me talentin. Në këtë roman humoristik të Dritëro Agollit, Zyloja dhe Demka, si shkurtime të emrave "Zylyftar" dhe "Demir", aty ku nuk merret vesh ku fillon "modernizimi" dhe ku mbarojnë "përkëdhelja/ përqeshja", e meritojnë plotësisht njëri-tjetrit. Të dy janë shkaktarë situatash që e bëjnë lexuesin të shkulet gazit, por edhe të pezmatohet disi. Produkt i njëri-tjetrit, ata janë njëherësh bashkëfajtorë për lëngatën që e vuajnë vetë. Shoku Zylo është një nga qindra e qindra nëpunësit e mesëm të një aparati shtetëror me shumë instrumente. Ai nuk është pa merita pune, por këto merita në peshoren e shoqërisë kanë peshë shumë më të vogël se në mendjen e Zylos. Natyra e dyfishtë, mospërputhja ndërmjet qëllimit dhe përfundimit, i jep lexuesit emocione tejet të kundërta

dhe cilido që të jetë emocioni: dhimbje, keqardhje, përqeshje, lexuesit i shkakton ndjenjën e refuzimit ndaj pozitës së personazhit.

***Njeriu me top (1975).** Mato Gruda jeton në hasmëri me familjen e plakut Mere Fizi. Ai ka fshehur një top të cilin ëndërron ta përdorë kundër Mere Fizit, dhe ka marrë në shtëpi si rob edhe një italian që e thërret Agush i cili i mëson përdorimin e topit. Njeriu me top jeton ditët e tij me urrejtjen ndaj Fizëve. Shpërfillës i ngjarjeve madhore kombëtare në fillim, simpatizant besues i komunizmit, Mato Gruda i qëndron gjithsesi fiksimit të tij për të shlyer peshën e hakmarrjes që rëndon prej kohësh e ku hedhin valle hijet e të vdekurve të tij. Vetëm pasi ndodhet përballë ballafaqimeve në sheshin e fshatit se kush ka qëlluar me top mbi Fizët, Mato pushtohet nga një ndjenjë sikleti e turpi. Për një çast ndërgjegjia i flet me zë të ulët duke ia pohuar vetvetes se është ai njeriu që ka shtënë me top mbi Fizët, se partizanët janë të pafajshëm e se Tosun Baçi si akuzator është një gënjeshtar. Si të gjithë frikacakët që kanë në dorë fuqinë e marrëzisë së vdekjes mbi të tjerët, personazhi i Mato Grudës pluskon në këto konflikte të brendshme të lidhura sa me aspektet më humane e kombëtare, tek ato ngushtësisht personale, të mbajtura në tension nga ankthi, frika dhe dëshira.

***Dështaku (1985).** Në qendër të romanit është Xhelo Mara, komunist idealist dhe Hatixheja, një vajzë fshati, e ku takimi i rastësishëm i tyre, më vonë shndërrohet në një takim intim për të dy personazhet. Kështu, që nga takimi i parë e deri në fund, ata i ndjek një mallkim dhe urrejtje e pakuptueshme dhe krejt e paarsyeshme. Struktura e romanit "Dështaku", ka ndërtim të harmonishëm dhe ka përputhmëri të rrjedhshme me të gjithë mjetet artistike. Heronjtë e romanit janë të çiltër edhe pse në fillim janë të luhatshëm, vizatohen të heshtur dhe të menduar. Fabula e romanit nxit shtytjen e tekstit të romanit,

duke bërë lidhjen nga ngjarjet në botën e personazheve ose edhe në të kundërtën. Heroi është, një njeri i thjeshtë që kthehet nga lufta, i përmbajtur, i tërhequr, s'bëhet vegël e burokrateve të kompromentuar, ka botëkuptime liberale etj. Pikërisht këto tipare të tij pengojnë të tjerët, që ngrihen kundër tij. Fabula është një shuplakë e rëndë për atë periudhë të sundimit. Romani paraqet njeriun e thjeshtë e të palodhur që ballafaqohet me ingranazhet e hekurt të një sistemi shoqëror absurd. Romani sa është i karakterit shoqëror po aq është edhe i karakterit politik, ku politika e paraqitur në këto faqe është tërësisht e dështuar.

4.3 Identiteti kombëtar, “Njeriu i ri” dhe idealizmi për atdheun.

“Atdheu ... është, ja ky oborr, ajo copë tokë, ata dy qe që pëllasin, i dëgjon si pëllasin? Atdheu është ai plep, ai gardh, ai oxhak atje. Zhduken këta, zbehet atdheu”. (Agolli.1991:119).

Në Fjalorin Shpjegues të Termave të Letërsisë, termi hero përcaktohet: “*Hero-i (i veprës letrare)= Personi veprues më kryesor në një vepër letrare, i karakterizuar nga shkrimtari në mënyrë të plotë, të shumanshme, që luan një rol vendimtar në zhvillimin e përmbajtjes ideore të veprës. Tek heroit, shkrimtari mishëron idealin e vet njerëzor dhe estetik, prandaj heroit është bartës i cilësive më pozitive që me tiparet e karakterit, të botëkuptimit dhe veprimtarisë së vet përfaqëson njeriun përparimtar të kohës dhe zgjon tek lexuesi dëshirën për ta imituar. Në figurën e heroit shkrimtari na jep në mënyrë të përgjithësuar të dendësuar, ato tipare që ekzistojnë në realitet tek përfaqësuesit më të mirë të shoqërisë”.* (Leka, Podgorica, Hoxha.1972:87). Në letërsinë e Realizmit Socialist, qëllimi i heroit u zëvendësua me ndërtimin e Njeriut të Ri, pasqyrimi i të cilit si hero, varet nga epoka historike, nga botëkuptimi i shkrimtarit, nga metoda artistike që ndjek ky i fundit. Në

ligjërimit e kësaj lloji letërsie, takojmë shumë heronj që janë pasqyrimi artistik i njerëzve realë, që kanë luftuar për çlirimin e vendit të pa idealizuar në veprimet dhe qëllimet e tyre...

Të tillë janë komisari Memo në romanin homonim, Mato Gruda dhe Xhelo Mara për të cilët vetë Agolli ka thënë: *“Përveç mbajtjes parasysh të një raporti të tillë të drejtë, vëmendje të veçantë në trajtimin e figurës së heroit meriton mësimi i shokut Enver Hoxha se Njeriu i Ri i mirë duhet të ndërtohet në libër dhe të paraqitet në skenë me thjeshtësinë e tij, për arsye se në thjeshtësinë spikatin të fuqishme virtytet e mira, të cilat nuk duhet të idealizohen, pse hero të përsosur nuk mund të ketë në jetë”*. (Agolli 1979:55).

*“Atyre u pihej ujë dhe u ndalën te **burimi** që dilte nga **rrënjët** e një **lisi** të madh. Memoja hoqi kapelen dhe **u ul në gjunjë** për të pirë ujë. Rustemi **shikonte** të vëllanë tek pinte ujë dhe **mendja i vinte për keq**. Kur u ngrit Memoja, në burim i vuri buzët Rustemi. Ai e **thithte** shpejt ujin e në fyt i **dëgjohej** një gurgullimë e lehtë”*. (Agolli,1970:11). Vihet re që emrat me të zeza **burimi**, **lisi**, të vëllanë janë tipikë emra primordialë, emra që lidhen me traditën dhe kombëtarën, ndërsa foljet **u pihej**, **u ndalën**, **dilte**, **u ul në gjunjë**, **shikonte**, **i vinte**, **thithte**, **i dëgjohej** tregojnë se heroi është ushqyer nga kjo tokë por edhe se situata e krijuar sikur paralajmëron fatin e heroit, Memos. Gjatë gjithë kohës, Memo paraqitet si hero që mbart me vete ideale të epokës, si komunist i devotshëm që mund të japë dhe jetën për vendin e vet. Burimi që rrjedh simbolizon rrjedhën e fatit të tij, si diçka e ardhur që nga kohërat, të familjes së tij dhe në fund gjithë historinë e popullit të tij. Pra, asgjë nuk e veçon Memon nga personazhet e tjerë dhe pikërisht për këtë Agolli e ravijëzon Memon me tiparet më të denja për të qenë hero. *“Ndërtimi i socializmit në Shqipëri e ka pasuruar botën shpirtërore të njerëzve dhe ka nxjerrë në skenë një njeri të ri, të përparuar, me ideale të*

larta shoqërore. Ky njeri kërkon pasqyrimin e tij më të plotë. Dhe këtë mundësi e ka metoda e Realizmit Socialist”. (Agolli. 1978:193).

Është koha që i kërkon heronjtë të tillë dhe kjo formë ligjërimi ruan me fanatizëm cilësitë më të mira popullore, vishen me një kostum ideologjik marksist në rastin tonë dhe çdo gjë është në rregull. Në këtë rast jemi tek misionet ndërtuese të gjuhës ku thuhet *që gjuha bën dhe gjuha thotë*. Ligjërimi i Memos legjitimon identitetin e tij, dhe kështu identitetin kombëtar me të cilin ai është brumosur. Memo është i vetëdijshëm për këtë. Vëmendja në ndërtimin e këtij tipi hero i si Memo, dhe në ligjërimin e përdorur prej tij, zhvendoset nga jashtë, brenda. Ka po aq shumë rëndësi dhe dukja e brendshme e cila duhet të jetë gjithnjë perfekte. Ndërsa bota e brendshme e tij anashkalohet, ai nuk ka asnjë dyshim me vetveten, me identitetin e tij. I vetmi dyshim që bren Memon është dyshimi nëse do të arrijë premtimet e dhëna në mbledhjet e Partisë për të rritur besimin në popull. Kjo sepse “... *Njeriu i Ri mund dhe duhet të ndërtohet vetëm përmes punës dhe sepse pa punë dhe pa luftë, njohja e komunizmit e marrë prej librave është absolutisht pa vlerë*”... (Nikolla. 2012: 32), por edhe sepse mbledhjet janë forma më e mirë e përhapjes së propagandës dhe ideologjisë komuniste por edhe ku përhapej më së miri fryma kombëtare.

*“Ne **duhet të mbledhim** përgjegjësit e këshillave të fshatrave në Lajthizë- tha Memoja. Sonte mbas mesnate duhet t’i mbledhim. Në disa fshatra këshillat **kanë rënë në heshtje** e nuk veprojnë. Sali Protopapa pothuajse **i ka paralizuar**. Ka vënë kryepelq të rinj dhe na ka nxjerrë telashe”. (Agolli,1970:10).*

Zgjedhjet leksikore, pra grupet foljore **duhet të mbledhim**, **kanë rënë në heshtje** dhe **i ka paralizuar** tregojnë aktin e të vepruarit që karakterizon heroin komunist, të cilin ai duhet të ndër marrë për të zgjuar frymën kombëtare. Memo asnjëherë nuk është i vetmuar, asnjëherë

nuk e bren vetmia, ai është gjithnjë në kushte sociale. Nuk tregon që nuk është aspak një hero tragjik, edhe pse tragjizmi është prezent në realitet. Ai paraqitet komunikues-transmetues i ideologjisë, si pasojë ka një gjuhë të varfër dhe është në gjendje të ndjejë dashuri në kuptimin e plotë të saj, sepse përta i përket kësaj të fundit ai na paraqitet për së jashtmi duke na e servitur si të mirëqenë dhe të suksesshme dashurinë e tij.

“Zgjidhe thesin tjetër!- urdhëroi Memoja... Motra, ato që kanë marrë kripë të mos presin kot, të tjerat të vijmë e të marrim tek unë- tha Memoja më në fund”. (Agolli, 1970:20).

Lidhur me sa kemi thënë që ligjërimi është praktikë sociale, personazhi i Memos na paraqitet i tillë, pra social. Emrin **motra** ai e përdor për të bërë të afërt njerëzit e thjeshtë të popullit të vet. Situata që krijohet kur ai ia merr kripën tregtarit dhe ua shpërndan grave tregon natyrën e ndjeshme të Memos dhe dashurinë që ai ka për popullin e vet dhe kjo e bën atë hero. Pothuaj të gjithë heronjtë e letërsisë së realizmit socialist janë të tillë dhe e kanë vendosur veten nën të tilla korniza.

Në momentin kur Memo merr atributet e një heroi, kuptohet që edhe ligjërimi ndaj identitetit kombëtar pëson ndryshimet e veta, ndryshon kahja. Tek format totalitare ku ideologjia dhe dogma janë mbizotëruese është i kuptueshëm ky ligjërim. Kjo vjen pasi ndërtimi i këtij heroi si Memo, Xhelo Mara apo dhe Mato Gruda shtrihet në shumë plane.

Autosugestionimi i një jete të pasur, të begatë e të lumtur, është një nga qëllimet kryesore të ideologjisë në pushtet, duke e bërë Njeriun e ri, individin të besojë se është i lumtur padyshim që edhe pushteti e ka më të lehtë të vazhdojë sundimin e tij, sepse një njeri, një individ i lumtur nuk merr për të mirëqenë atë çka të tjerët, pushteti, i propozojnë.

Limitimi i hapësirës është një element, po ashtu i rëndësishëm, ku Njeriu i Ri përgjithësisht karakterizohet nga paraqitja e një karakteri unik, gjë që pasqyrohet edhe në

nivel strukturor. *“Askujt nuk mund t’i shkonte në mend që Mato Gruda të bëhej vrasës. Ai fliste me gjithë qeniet e gjalla: me qenin e me lopën, me kaun e me mushkën, me barin e me lisat... Ai kurrë nuk mund të therte dot një qengj se i vinte keq. Kur mbante Ziguri ndonjë manar dhe kur vinte koha për ta therrur, Mato Gruda vuante shpirtërisht”*. (Agolli, 1975:128). Në letërsinë e realizmit socialist kjo dukuri shpreh madhështinë e ideologjisë dhe dogmës marksiste, të cilën shkrimtari vetëm e pasqyron, por nuk e zgjidh dhe përdor klishetë e gatshme. Pothuaj të gjitha veprat e kësaj periudhe kanë heronj të tillë si: *“Para agimit”* i Shefqet Musarajt, *“Përsëri në këmbë”* i Dhimitër Xhuvanit, *“Komisari Memo”*, *“Njeriu me top”* të Dritëro Agollit, *“Një vjeshtë me stuhi”*, *“Këneta”* i Fatmir Gjatës, *“Belxhiku që këndon vendçe”*, *“Tre ngjyrat e kohës”*, *“Përballimi”* i Teodor Laços etj, janë disa nga titujt më të dalluar të kësaj letërsie që përmban të tillë heronj.

Portreti i ideologjizuar i Matos apo i Memos priret drejt motivimit ideologjik, sepse në këtë letërsi nuk parapëlqehen heronjtë mitikë që vijnë përmes ligjërimit të traditës popullore gojore. Ata lihen mënjane nën pretekstin se mbartin mbi vete një identitet kulturor tjetër që bie ndesh me identitetin e formuar tashmë. Ndryshimi identitar klasor që mbartet nga e kaluara nuk shihet me sy të mirë, dhe shkrimtarët në të vërtetë as që i afrohen këtyre heronjve mitikë. Historia nga njëra anë krijon tipin e Njeriut të Ri, pozitiv (ai që përmbush detyrat që rrjedhin nga ideologjia e klasës në pushtet), dhe nga ana tjetër kalcifikon heronjtë mitikë duke rrezikuar kështu humbjen e tyre por edhe humbjen e së kaluarës identitare. *“Sot është koha të zgjidhim dicka më të madhe, rrugën për t’u bërë njerëz. Njeri, pastaj artist- shtoi Memoja.... Dhe ky njeri duhet të zgjidhë enigmën, nga cila anë do ti derdhë energjitë, nga ana jonë apo nga ana ... Ne duhet ta bëjmë këtë që tani, që më vonë, kur të shohim hapat e lënë pas, të mos skuqemi”*. (Agolli, 1970:110).

Togfjalëshat: *për t'u bërë njerëz, të zgjidhë enigmën, ti derdhë energjitë* tregojnë se heroit ynë përmes portretit dhe karakterit të tij, kërkon të përmbushë qëllimin ideologjik të sistemit për ndërtimin e njeriut të ri, dhe brumosjen e tij me idenë kombëtare e patriotike.

Nga ana tjetër, personazhet tanë heronj karakterizohen nga një humbje e ndjeshme që paraqitet si arritje e sukses gjë që trumbetohet si ekzistencë shembullore, e në fakt është një humbje e tij. Njeriu i Ri real-socialist humbet integritetin e tij dhe kthehet në një instrument të një vije strukturore teksti që i shkon për shtat ideologjisë që ai përfaqëson.

“Ne do të bëjmë transformime të mëdha në sektor. Do të vendosim një metodë dhe një stil pune të kohës, siç e kërkon stadi i sotëm i zhvillimit të shoqërisë, siç e kërkon niveli i përgjithshëm i kulturës së njeriut të ditëve tona”.(Agolli, 1973:22).

Heronjtë janë kopje identike të njëri-tjetrit, nga një ligjërim letrar në tjetrin psh Mato Gruda apo Xhelo Mara. Mungesa e fantazisë, liria e veprimit të munguar dhe klishetë e përdorura nuk e lejojnë heroin të jetë i ndryshëm nga të tjerë heronj. *“Andresë iu kujtua kovaçhana: iu kujtua edhe farka që nxirrte nga goja shkëndija, edhe Xhemali që godiste me çekan në kudhër dhe dukej si një kryengritës që i kishte shpallur luftë botës së madhe”.* (Agolli,1970:111). Zgjedhjet leksikore emra, te tipit: *kovaçhana, farka, çekan, kudhër* (gjetje primordiale) jepen në një lidhje mjaft të fortë (madje duke e përforcuar atë) me shprehjen stilistike të përzgjedhur nga Agolli që e shfaqin personazhin ... si një kryengritës që i kishte shpallur luftë botës së madhe.

Njeriu i Ri është racional, dhe kjo duke treguar se ne e ndjekim fatin e heroit dhe të personazheve të tjera duke e ditur shumë mirë edhe fundin, sepse struktura e ligjërimit është po ajo, e pandryshueshme. Ky hero përcjell mendimin se fati nuk ekziston, pra as fataliteti nuk duhet të jetë prezent, sepse gjërat nuk shkojnë sipas rastit, por çdo gjë duhet të jetë e

studiuar dhe në funksion të ideologjisë. Portreti i Memos, Xhelo Marës e i Mato Grudës, nga ana tjetër vjen e rritet, me karakteristika të qarta e të pandryshueshme. Në këto vepra ai vetëm sa i shpërfaq këto veti që i mbart si çmim të ideologjisë dhe kuptohet që kemi një shformim të identitetit, apo më saktë të mendimit tonë për të.

Heronjtë, në luftën për identitetin kombëtar, paraqiten “... si pasqyrim i ligjeve të zhvillimit historik, që do të thotë, zhvillimit komunist pasi pothuaj në të gjitha veprat heronjtë janë komunistë, që mund të jenë komunistë në Luftë ose komunistë në Socializëm, por në të dyja rastet i shërbejnë drejtpërdrejtë ideologjisë”.(Bulo,1982:158), dhe kjo bën që njeriu i Ri i ideologjizuar është në qendër, e jo ngjarja dhe kjo është e kundërta e “tragjedisë greke, ku në qendër nuk ishte njeriu por ngjarja, interesi i saj, që nuk përqëndrohet në fatin e individit, por në fatet e popullit nëpërmjet figurës së përfaqësuesve të tij”. (Bjelinski.1977:93)

Njeriu i Ri, në këtë rast, nuk është gjë tjetër veçse një pseudohero që përpiqet të paraqitet ai që nuk është. Për hir të së vërtetës, duhet të theksojmë se kjo nuk e përjashton faktin që ky njeri-hero ka në vetvete tiparet më të mira të popullit të vet saqë madje shkrimtari kujdeset që këtë hero ta ndërtojë kështu. “*Patosi heroiko-romantik, akordet madhore patetike, fryma patriotike, janë tipari kryesor i këtij heroi*”. (Bulo.1982:22). “*Dy javë të tëra u sfilit Zyloja me këtë raport. Gjer më dymbëdhjetë të natës ka punuar. Por nuk më vjen keq sepse e ka bërë të mirë*”. (Agolli, 1973:17). Fjalja lidhet në një kontekst më të gjerë se kaq duke na treguar se personazhi është aq idealist më tepër sesa veprues.

Në përfundim të kësaj, themi që Memoja, Mato Gruda, Zylo dhe Xhelo Mara, në përgjithësi Njeriu i Ri i letërsisë së Realizmit Socialist, është një personazh i cili në plan të parë ka ideologjinë dhe dëshirën e flaktë për t’i shërbyer me devotshmëri asaj. Heronjtë e

ndërtuar për llogari të ideologjizmit janë gjithashtu tipikë për këtë lloj letërsie. Ata paraqiten njëlloj në rrethana tipike, të ngjashme. Me gjithë përpjekjet për ta paraqitur si një Njeri të ri, ai mbetet po ai, i vjetri, ose më saktë *“heroi zero”*, heroi i krijuar njëherë, që vetëm vrapon në hapësira të ndryshme gjeografike duke mos ndryshuar asgjë.

Ai është i dhënë një herë e përgjithmonë, nuk ka një diagramë rritjeje si personazh, sikur nuk ka asesi as humbjeje. Ky njeri i anashkalon heronjtë e tjerë paraardhës të kombit të vet, sepse ai tjetri nuk përmbush kriteret e të qenit pjesë e ideologjisë, nuk i shërben asaj. Ky njeri pretendon të krijojë një identitet të ri kombëtar, por me gjithë iluzionet e mirë orientuara, ai nuk ia del të jetë i vërtetë, dhe në këtë luftë ai humb, pasi, padashje ai harron që edhe konstruktivizmi që mbështetet në ideologji, bazën e ka tek primordializmi, tek elementet që ai mbart. Siç shihet një njeri i formësuar në këtë lloj forme nuk mund të ekzistojë gjatë, është jetëshkurtër. Së pari, sepse vetë lexuesi duke e mësuar modelin e braktis atë dhe nuk e ndjek më, pasi nuk ka ç’ të mësojë prej tij. E dyta, që në fakt nuk duhet harruar, është edhe kënaqësia estetike që marrim nga leximi. Por në një kontekst ligjërimit, ku veprojnë heronj të tillë kallp, emocioni ynë zbehet, dhe zhduket.

4.4 Identiteti kombëtar, “Njeriu i Ri” dhe ideologjia.

Njerëzit duken se tërhiqen më shumë nga problemet e përditshmërisë dhe i marrin si të mirëqena, pra të padiskutueshme nga njëra anë dhe të apeluar nga ana tjetër, pikërisht ato arritje që tek e fundit krijuan shtetin- pra fokusimin tek problemet identitare. Në një moment të tillë historik këto probleme janë tejkaluar. Por siç vëren edhe Nathalie Clayer: *“...ekzistonin gjithmonë një ose dy grupe që pak nga pak i drejtoheshin shqiptarizmit dhe fillonin të quheshin patriotë. Për këtë mund të hynin në lojë shumë motive,*

që vinin nga instrumentalizimi që i bëhej shqiptarizmit, pa qenë e mundur sidoqoftë, të përcaktohet realisht shkalla e instrumentalizmit. Nga ana tjetër nuk mund të thuhet se përqafimi i shqiptarizmit ishte një gjë që ndodhte sistematikisht vetëm për shkak të grupimeve që kërkonin të shtinin në dorë pushtetin lokal”. (Clayer.2012:528).

Në të dyja rastet ajo që duhet, krahas gjithë gjërave të tjera, padyshim që figura e Njeriut të Ri luan një rol të padiskutueshëm qoftë në krijimin e shtetit ideologjik, qoftë në ruajtjen dhe zhvillimin e përparimin e tij, sidomos në etapat e para. Atributi heroik i tij mbetet në qendër të të gjithë ligjërimeve. *“Historikisht, tregimet, mitet dhe manifestime të tjera kulturore si muzika dhe artet vizuale, teknologjite, kuzhina dhe kostumet formojnë atë që ndonjëherë quhet kulturë kombëtare”. (Fairclough.2003:138)*

Për të mos hyrë në analiza historike të cilat nuk janë objekt i këtij punimi, thjesht po përmendim faktin e atij paralelizmi në ndërtimin e heroit, nga koha e Rilindjes sonë Kombëtare, deri në letërsinë e Dritëro Agollit dhe ajo që të bie në sy është pikërisht vitalizimi i heroit-Njeriut të Ri identitar. Krijimi i shtetit komunist kërkonte padyshim atë që u quajt “Njeriu i Ri”, i cili le të nënkuptohet: Heroi tradicional (primordial, etnosimbolist etj) + hero i ideologjik = Njeriu i Ri

Heroi i Agollit barazohet kështu, në një formë qeverisjeje totalitare, që e zbërthyer do të thotë se ai i zgjidh të gjitha, është kudo, ndihmon këdo, vetflijohet duke përkuar kështu me cilësitë e së drejtës, e së mirës, tipare të reja që e lidhin fuqishëm me të shkuarën. *“Ç’janë këto stërhollime shoku Feti? Ku t’i shpija lopët e qetë? T’i lija jashtë nëpër shi që të ngordhnin, që t’i hanin ujëqit? – tha Xhelaja me rrëmbim, duke i ndërprerë fjalët nga kolla.*

-Për hir të parimit, t’i lije jashtë!- tha Feti. – Të ngordhnin? Parimi mbi të gjitha! – tha ai prerë dhe me cinizëm.

Xheloja tundi kokën me keqardhje. Ç'mendime dhe ç'paturpësi, mendoj ai!

-E unë nuk jam vrasës! Këto parime që thua, unë i quaj krime. Parimi dhe krimi ndryshojnë.

Po të ishte ti në vendin tim, kur shfryu lumi, ç'do të bëje???

Nga ana tjetër ky hero, pra Njeriu i Ri, nën emra të përveçëm, Komisari Memo, Xhelo Mara apo Mato Gruda, janë “...konceptuar si një karakter me domethënie të gjerë shoqërore, dhe të vizatuar me tipare të gjalla individuale, përmes të cilave shprehet në mënyrë plastike thelbi i tipit social që ai përfaqëson dhe qëndrimi emocional i autorit ndaj tyre”. (Bulo.1982:238)

Edhe pse Njeriu i Ri, gjithësesi mbetet një hero, në fakt i “thirrur për ndihmë”, nga nevoja urgjente e ruajtjes së identitetit në kushte të reja politike e sociale. “... historia na ka mësuar se midis qenieve njerëzore gjenden individë që janë paraprijës së kohës, të cilëve koha më vonë u ka dhënë vendin që u takon”. (Falaschi.1997:81). Dritëro Agolli nuk bën gjë tjetër veçse na sjell këtë njeri-tip, me të cilin ai plotëson nevojën urgjente identitare. “... Ja ku po ju them, mësuesi është edhe i kësaj edhe i asaj!- përfundoi plaku duke bërë me gisht edhe sikur **shkruante**, edhe sikur **hiqte këmbëzën e pushkës**”. (Agolli, 1970:135). Siç vihet re, lidhja mes foljes **shkruante** dhe grupit foljor **hiqte këmbëzën e pushkës** krijon antitezën mes dy gjendjeve në kohë lufte e paqe të cilat lidhen mjaft mirë me dy veprimet e plakut përmes gjesteve me dorë: *edhe i kësaj edhe i asaj*. Përmes kësaj, personazhi arrin të orientojë lexuesin drejt një identiteti për të cilin në fakt ai është i përgatitur.

Për t’ia bërë më të lehtë këtë orientim lexuesit e në të njëjtën kohë edhe masave, Memo kthehet tek njeriu-tip i kohës së Rilindjes sonë Kombëtare, të cilin lexuesi, pra edhe masat e njohin dhe e admirojnë. Në këto kushte terreni për të patur një diagramë zhvillimore, edhe ideologjike, të heroit, bëhet më e kapshme nga të gjithë dhe në raport me ndërtimin

tipologjik të heroit na paraqitet si një aleat. Kjo për faktin se ne e shikojmë më qartë figurën e heroit, e ndjekim atë në rrugën e tij dhe ndjejmë vitalitetin e tij.

Komisari Memo është një i tillë, një njeri-hero vital. Ai është gjithë energji individuale. Mato Gruda gjithashtu. *“Mato Gruda i shëmbëllente një njeriu që kishte pirë tërë natën dhe të nesërmen i kishte dalë rakia: veçse me një ndryshim: Mato Gruda kishte vetëm dëshpërimin e këtij njeriu, por jo indiferentizmin. Kjo gjendje e përgjithshme shpirtërore nuk kishte të bënte vetëm me frikën e tij, ... Ishte diçka tjetër, që nuk e dinte ta shpjegonte. Ndoshta ishte ndjenja e njohjes së kotësisë së veprimeve të tij”.* (Agolli, 1975:132). Të dy sëbashku vitalizojnë vetveten dhe e kthejnë vëmendjen e publikut drejt këtij identiteti me elemente të reja, të cilat janë në përputhje me shndërrimet politike, sikur janë në përputhje me heroin e trashëguar, heroin historik-njeriun historik. Ky njeri-hero lindet i paplotë, i njëanshëm dhe si i tillë i ka të gjitha premisat të jetojë për aq kohë do të jetojë ideologjia e cila e lindi. Jashtë kontekstit të saj ai nuk ekziston, pa identitet (personal) kombëtar.

Por jemi të ndërgjegjshëm, që heronj ideologjikë ka patur, edhe do të ketë, sepse edhe ideologjia vazhdon të ekzistojë. Sikur mund të ndodhë edhe një rikthim, gjithnjë në varësi të ekzistencës së ideologjisë, gjë e cila nga ana e saj kushtëzohet gjithnjë vetëm nga politika dhe interesat e grupeve, që gjithësesi nuk përfaqësojnë kombin. Ajo që duam të theksojmë është fakti që heronjtë duhet të kenë lirinë e fjalës e të veprimit, shkrimtari në fakt më së shumti. Duke i pasur këto ai është në gjendje të eksperimentojë dhe të na paraqesë personazhe të reja, plot vizione e fantazi, ndërtuar me figura të pasura artistike e stilistike që tek e fundit na krijojnë kënaqësi estetike gjatë leximit, duke përmbushur kështu një nga funksionet e ligjërit (letrar).

4.5 Konflikti për rindërtimin e identitetit kombëtar.

“Shkruar në kushtet e një shoqërie rreptësisht të kontrolluar, për t’u lexuar, si çdo letërsi tjetër, edhe në kushtet e shoqërisë së hapur, letërsia e realizmit socialist nuk mund t’i shmanget pyetjes nëse brenda saj ka njerëz të vërtetë, që zhvillohen në mënyrë të pavarur prej ideologjisë sunduese. A ka brenda kësaj letërsie më shumë liri se në jetën e shoqërisë së kohës? Ligjërimi i Agollit përmban një galeri njerëzish e karakteresh, që e bëjnë më të lehtë këtë përballje të vështirë për letërsinë e re shqipe në tërësinë e saj. Njeriu është fuqia e brendshme e veprës së Dritëro Agollit”. (Sinani.2011:267)

Sigurisht që si çdo shoqëri në çdo etapë të zhvillimit të saj edhe kjo i ka konfliktet e veta. *“Kultura e të mundurve shkatërrohet nga fituesit. Vetëm “toka mëmë” është në gjendje t’i ruajë në gjirin e vet, deri sa të mundet, ato mbeturina arkeologjike dhe epigrafike, të cilat do të dëshmojnë një ditë, mbi atë lulëzim të madh të kohëve të shkuara”.* (Falaschi.1997:65). Komisari Memo, Xhelo Mara dhe Mato Gruda janë që të tre personazhe heronj-traditionalë. Këta personazhe nuk janë gjetje të shkrimtarit Agolli, por vetëm pasqyrim i një realiteti konfliktual i cili i bën ata të shfaqin disa nga tiparet e tyre dhe disa nga mënyrat përmes të cilave ata i zgjidhin këto konflikte të pashmangshme. Memo është në konflikt me klikën pushtuese dhe me dogmën e pushtetit të Sali Protopapës, Xhelo Mara është në konflikt me Bame Vorbullën dhe të gjithë ata që nuk besonin në idealet e tij dhe Mato Gruda ishte në konflikt e gjakmarrje me familjen e Mere Fizit.

Duke patur një të shkuar biografike të mirëdetajuar, është në fakt tradita e kombit të vet, është identiteti i tij i formësuar dhe i plotësuar gjatë rrugës së gjatë të zhvillimit historik. Si i tillë ai mbart në vete edhe tiparet e perceptimit të konflikteve dhe mënyrë e zgjidhjes së

tyre. Kështu, Komisari Memo siç e kemi vënë në dukje edhe më herët në punim, si Memo Kovaçi, fshatar 100%, edhe konfliktin e zgjidh si fshatar, duke qenë pragmatik. “*Na thesin dhe **nisu!** Kripa u shpërnda. Bidonët e vajgurit **hajde** merri nesër, pasi ti ndajmë nëpër fshat. ... Memoja nxorri një fletore, diçka shënoi me laps e ia zgjati Mazllumit. **Na!** Kur të çlirohet Shqipëria, **paraqite** këtë deftesë që të marrësh paratë. Tani para nuk kemi”*. (Agolli, 1970:22). Dialogu ka peshën e nxitjes së një konflikti mes Memos dhe tregtarit, dialog të cilin Memo gjen mënyrën diplomatike ta shuajë. Foljet në mënyrën urdhërore e orientojnë Memon të shuajë konfliktin me Mazllëmin, ti japë një zgjidhje atij dhe të besojë se e nesërmja do jetë me ta dhe se e ardhmja do jetë më e mirë.

Gjuha e përdorur në këtë rast tregon se ky konflikt nuk ishte i rëndësishëm së veçantë dhe ai e anashkalon thjesht me një shpotitje humori. Nëse konflikti do të ishte më i thellë dhe brenda të njëjtit lloj, pra me bashkëfshatarët e tjerë, atëherë ai mund të zgjidhë atë me dialog ose në raste më të rralla me dhunë. Por kjo tregon që, kur konflikti është mes tij dhe të huajit pushtues, atëherë ai e zgjidh vetëm me dhunë dhe shtysa që e çon drejt saj është vetëm ruajtja e identitetit të tij. Por kur **Memo Kovaçi** është **Komisari Memo**, qëndrimet janë shumë të qarta e të kthjellta: luftë e pakompromis ndaj të huajit pushtues, dhe dialog mirëkuptues me bashkëfshatarët e bashkëkombasit që mendojnë njëlloj si ai vetë, pra si pushteti i ri, e kur fjala është për të tjerët bashkëfshatarë e bashkëkombas që nuk janë në të njëjtën anije politike, atëherë edhe në këtë rast pretendohet zgjidhja me dhunë, e cila vjen pas shumë tratativash bindjeje. Zgjedhja leksikore në këtë rast është loja mes të kundërtave. “*Komisarët janë te gjithë **komunistë**, -qeshi Memoja*”. Vihet re që e gjithë fjalia ka ideologjizim brenda por fjala **komunistë** mbart peshën kryesore si fjalë kyçe, e cila tregon që Memo është i dhënë me mish e me shpirt në misionin e tij politik dhe kombëtar.

Ndërsa në rastin e Mato Grudës gjërat janë më të thjeshta, ai na paraqitet më bardhë e zi, që do të thotë është më konservator në ruajtjen e traditës dhe pranimin e ideve të reja komuniste. Si zgjedhje leksikore këtu shërben kontrasti dhe lufta me të vjetrën. Ai është i plotësuar nga kjo traditë dhe nuk e ndjen nevojën e ndryshimit të identitetit, ndërkohë që kjo përbën një konflikt më vete që lind brenda tij.

Në dallim nga Memo Kovaçi, që i ka përqafuar idetë e reja dhe i duket e arsyeshme, madje e domosdoshme që të zhvillojë identitetin e tij në regjistra të tjerë reale, Mato Grudës i duhet kohë të pranojë pikërisht këtë realitet imponues. Kodi i komunikimit lidhet me biografinë e tij familjare e cila është më kokëfortë, për të ajo ka vlera të padiskutueshme dhe nuk mund të bëhet ai ndryshuesi i saj. Fakti që ai e adhuron deri në mitizim tokën e tij, parmendën me të cilën ushqehet, ritet, duke përfshirë edhe atë të hakmarrjes, e bën Mato Grudën një individ që ruan me xhelozë identitetin e tij, që dyshon në çdo pretendim për ndërhyrje në të, sepse beson se ai është i shenjtë. Por Maton e bren ndërgjegjja. *“Në fillim ai pati një gëzim të castit: **shtëpia jetonte** dhe njerëzit nuk ishin lënduar! Në djall të vejë dhe kjo punë! Më mirë që nuk qëllova në shenjë. Njeriu i zi përpiqet, **lëron arat, mbjell farën, ndërton shtëpinë, bën fëmijë** dhe pastaj del një i krisur me një gjyle e të bën hi. Njeriu mbetet atëherë i shtrirë përgjithmonë me majat e këmbëve përpjetë. Po sa kane ecur ato këmbë!... ngjitu në mal e zbrit në fushë, futu në dëborë, e ngulu në baltë, ftohu në akull e ngrohu në vatër.....I shkreti njeri”!* (Agolli, 1975:129). Përmes fjalive dëftore, Mato flet për njeriun dhe vuajtjet e tij për t’u identifikuar, nga ana tjetër fjalitë dëshirore thirrmore shprehin anën njerëzore të heroit. Kjo padyshim që nuk është gjë tjetër veçse intuita popullore. Gjithashtu, po kjo intuitë e bën Maton të ketë parësor ruajtjen e identitetit të vet kombëtar i cili *“... ka mbijetuar duke*

ngrirë kulturën e vet, ndryshe nga kulturat e tjera që u shteruan krejtësisht”.
(Falaschi.1997:63).

Thellësia i bën ata të karakterizohen nga një motivim i fuqishëm psikologjik, proces ky shumë i rëndësishëm në letërsinë e realizmit socialist dhe kjo i bën ata, figura të cilat dashur pa dashur vendosen në qendër të konfliktit, jo vetëm se realiteti i kërkon aty, por edhe me misionin e lartë për ta zgjidhur këtë konflikt, i cili është sa i jashtëm po aq edhe brendshëm.

“Copat e baltës së çizmeve i kërcenin dhe i binin pas pantallonave lart mbi pulpat e mëdha.

Djersët i bashkoheshin me shiun dhe të kripura i zbrisnin në buzët e trasha. Në qenien e tij ishin ngjallur hijet dhe zërat e të parëve dhe oshëtimat e luftës. Në këto çaste ai nuk ishte
Xhelo Mara i arave me baltë, por Xhelo Mara i shtigjeve të luftës, i biri i Hysen Qorrit, që hidhte njerëzit në betejë, ku vinte erë gjak e vdekje dhe se përpara nuk kishte mitralozë dhe tanke, por valë uturuese dhe të frikshme tymi”. (Agolli, 1985:29).

Jemi në momentin kur Xhelo po u hakërrehet punëtorëve për shkatërrimet që po ndodhnin në fshat nga shirat e dendur dhe se ata duhet të lëviznin për të shpëtuar pronën e përbashkët, tokat nga përmytja, depot e drithit apo stallat e lopëve. Kodi ligjërimit këtu ruan ato vlera për të cilat është vetë letërsia e realizmit socialist që i jep më shumë rëndësi dukjes, pra anës së jashtme të heroit i cili në rastin më të mirë nuk duhet të ketë dilema e konflikte me veten, por vetëm me të huajt. Siç e kemi përmendur më parë këta personazhe janë vëllimorë, që do të thotë personazhe të rrethuar nga aureolë drite e drejtësie që luftojnë pa u ndalur deri në vetmohim pikërisht për të ruajtur këto tipare të shoqërisë së cilës ata i përkasin. Në këtë rast biografia e heroit merr karakter primar sepse ajo shërben në të njëjtën kohë si taban për të legjitimuar e për të bërë më të besueshëm pikërisht këtë hero. Agolli këtë e realizon përmes figurave të dyta dhe sfondit ku zhvillohet ngjarja, që në rastet e romaneve Komisari Memo,

Dështaku dhe Njeriu me top, është fshati. “*I gjithë **fshati** vraponte drejt **koshereve të misrit** dhe **stallave të bagëtive**. Dhe që nga kosheret, edhe pleqtë, edhe plakat, edhe fëmijët nxitonin me **thasë** dhe me **kosha** në shpinë. **Qetë dhe lopët**, që dilnin nga stallat, pëllisnin dhe **viçat** i ndiqnin pas duke u hedhur. Edhe Bamja, i bërë qull nga djersa, merrte në kurriz thasë me misër dhe vraponte drejt shkollës. Xhelos i tingëlluan në vesh fjalët e tij :”S’të dhimbsen vetëm ty”.* (Agolli, 1985:31). Të gjitha detajet janë primordialiste, lidhen me Realizmin Socialist (*I gjithë **fshati** vraponte drejt **koshereve të misrit** dhe **stallave të bagëtive***) sepse përbëjnë luftën e heronjve për të mbrojtur atë që është kombëtare. Vini re, Xhelo është në konflikt të vazhdueshëm me Bamen, dhe është pikërisht ky i fundit që e vret Xhelon në fund të romanit në mes të tokës me kallamishte. Në këtë mënyrë, duke luftuar e duke u përpjekur të arrijnë shuarjen e konflikteve, të tre këta heronj janë të ngjashëm në fatin e vet.

Si përfundim themi se qëndrimi që duhet të kihet parasysh në castin kur analizojmë veprimet e “Njeriut të Ri” të Agollit në raport me ruajtjen e identitetit, padyshim që lidhen me nacionalizmin. Ai është filli që i mban, është rruga ku ata ecin të sigurt, është tradita e në të njëjtën kohë është drita e së ardhmes. Është fjala, është besimi, është vetëmohimi. A nuk bëjnë kështu Komisari Memo, Mato Gruda dhe të gjithë heronjtë e Agollit? Konflikti i tyre në këtë rast merr një tjetër ngjyrë, atë nacionaliste. Heroi i vërtetë nuk ka se si mos ti ketë edhe këto qëndrime në vetvete, të cilat i japin shtysën përpara drejt zgjidhjeve përfundimtare. Pyetjes Hamletiane: *të kesh a të mos kesh identitet* edhe në kushtet e një shoqërie komuniste, heronjtë agollianë i japin fund duke zgjedhur të kenë identitet. Sikur zgjedhin të marrin pjesë në konflikt, të vihen në qendër të tij me synimin e zgjidhjes. Heronjtë agollianë janë njerëz të thjeshtë, të mbështetur në traditë dhe e duan atë, sikur

adhurojnë vendlindjen, gjuhën, besimin. Ata na paraqiten të gatshëm të luftojnë deri në fund me vetëmohim në ruajtje të asaj që besojnë se është e shenjtë: identitetit. Heronjtë agollianë kanë shumë armë në këtë luftë, por nacionalizmi është karta e fitores së tyre.

Gjurma e historisë shqiptare është e mbarsur më së shumti me konflikte që shumë herë e kanë vënë në zgrip edhe identitetin tonë kombëtar. Heronjtë e Agollit, jo vetëm nisen nga dëshira e mirë për ti sheshuar këto konflikte, por edhe për të lartuar veten dhe vendin në ato përmasa që ajo çka në të vërtetë ishte një ëndërr të kthehej në një realitet të pranueshëm nga të gjithë, sidomos për të huajt, për ata që historikisht e kanë sulmuar dhe janë përpjekur të shuajnë identitetin e shqiptarëve. E gjitha kjo legjitimon imazhin e tyre si heronj në konflikt të përhershëm me të huajt. Për të ndryshuar imazhin, atë që Kadare e vëren si: *“Klisheja krejtësisht e gabuar e përfimit të Shqipërisë si vend ndërmjetës, një sanduiç midis Lindjes dhe Perëndimit, një qytetërim as kështu, as ashtu, thënë ndryshe një vend i as as-it, nuk na bën kurrfarë nderi”*. (Kadare.2006:55)

4.6 Identiteti kombëtar dhe heroit mitik.

Mitet e para kanë qenë përvoja e parë e njerëzimit në shpjegimin e dukurive njerëzore e fenomeneve të natyrës. Ai në kohët e lashta ishte një formacion sinkretik, i ndërlikuar që kompensonte mungesën e shkencës. Bashkësi njerëzore të ndryshme kishin mitologji të ndryshme, por të gjitha kishin ngjashmëri të përbashkët: atë të pranisë së heroit mitik.

E gjithë letërsia jonë e Rilindjes Kombëtare i dha një rëndësi tejet të veçantë studimit dhe gjetjes së miteve, tashëgimisë së tyre në emër të ruajtjes së identitetit etnik, kombëtar. Kjo letërsi është e mbarsur me njerëz-heronj e superheronj që vetëm potencojnë dëshirën e flaktë

për krijimin e një identiteti unik kombëtar dhe njohjen e tij nga të tjerët dhe që e kryen me shumë sukses misionin e tyre sa historik, aq edhe shpirtëror. Heronjtë e kësaj periudhe letrare që të gjithë evokojnë të kaluarën e lavdishme, luftërat, fitoret, nderin, dashurinë për tokën e të parëve, gjuhën e nënës, dashurinë për cdo gjë të mirë të karakterit të trashëguar të të parëve të tyre duke u bërë mishërimi i këtyre tipareve. *“Mua më shikojnë sikur jam **perëndi!** – tha Memoja. Ndoshta se gjithnjë kam qenë larg shtëpisë. Kur të mbarojë lufta, do ti marr me vete. Hm! Ata kanë besim të madh se lufta do të mbarojë shpejt dhe ne do të fitojmë”*. (Agolli, 1970:142).

Triumfi i shpikjes mitologjike dhe i heroit mitik e shoqëron ligjërimin gojor të popullit ndër shekuj. Pasuria popullore trashëgohet e përpunohet më tej, pa ia humbur karakterin primar të saj dhe pa ia ndryshuar drejtimin. Është një pasuri e jashtëzakonshme fakti i ruajtjes me fanatizëm të tyre në ndërgjegjen e njeriut, sepse është dashuria dhe urrejtja e shprehur përmes të parave figura letrare, simbolit e metaforës, është një art i pavdekshëm. Arsyeja që ne sot i konstatojmë heronjtë tanë edhe me këto elemente, vjen si pasojë e vetë ekzistencës së mitologjisë, e cila nga ana e saj, duke patur edhe disa veçori të tjera, i mbart ato si një pjesë organike, të pandashme, të vetat.

Sigurisht që forca e madhe fizike dhe shpirtërore e heroit në letërsinë e Agollit, (dhe jo vetëm tek ai), fillësën padyshim që e ka në mitologjinë e lashtë. Por edhe hiperbolizimi, që haset në ndërtimin e personazhit, në kalimin nga nga një personazh i zakonshëm në atë heroik dhe idealizmi i këtyre heronjve agolllianë, fillësën e kanë pikërisht në mitologji.

I përmendëm këto veçori për të pasur më të qartë edhe qëndrimin e Njeriut të Ri Agollian, për të parë se si qëndrojnë raportet e brendshme, të trashëguara identitare të tij dhe për të kuptuar më mirë se cilat janë shtysat dhe premisat e një qëndrimi të sotëm të tij, sepse dhe

“Njeriu i Ri” te Agolli është një lloj miti, një lloj heroi mitik si dhe për të kuptuar cilat janë ato tipare që i atribuohen më së shumti këtij heroi dhe cila është rezultatja e gjithë këtyre, ndikimi i kësaj mitologjie në ruajtjen apo përcaktimin e një identiteti të caktuar? Në fakt është një marrëdhënie shumë interesante por ne do të ndalemi për aq sa na e kërkon formati i punimit tonë. Kjo do të thotë se kemi përpara heronj të cilët mbartin mbi vete jo vetëm realitetin në të cilin jetojnë por edhe realitetet që do të vijnë. Në këtë mënyrë ky Njeri i Ri, këta heronj janë të parët që arrijnë të kapërcejnë kufijtë kohorë duke na ardhur sot të plotfuqishëm me statusin e tyre të heroit që megjithë metamorfozat, shndërrimet, shtesat, shtresat dhe simbolikën e tyre gjallojnë sot më shumë se kurrë, qoftë edhe përmes elementeve të veçanta të tyre. Ata kanë një identitet të qartë e të përcaktuar mirë në kufijtë e tyre realë. Ata marrin pjesë pothuaj në të gjithë personazhet, qoftë në një formë qoftë në një tjetër. Vokacioni i tyre është i dukshëm.

Të gjitha këto, por ndoshta edhe elemente të tjera, sjellin tek e fundit vetëm një përfundim: personazhi e fiton identitetin e tij nëpërmjet këtij mitologjizmi të trashëguar, organik. Duke vërtetuar edhe një herë rëndësinë funksionale të tij, i cili e krijon identitetin e tij me elemente të vetëdijes kombëtare. Në veprën e Agollit kjo më së shumti shfaqet në poezinë e tij, ku lidhja me këto elemente të dritës, ujit, bimës, diellit, tokës, shpirtit, jetës dhe vdekjes është më e drejtpërdrejtë. Në të gjitha vëllimet poetike të tij kemi heroin i cili i mbart këto elemente, por në të njëjtën kohë përfaqëson edhe vetë unin ligjërimor të autorit. Lidhja e tij me këtë lloj mitologjie dhe arsyeja se përse Agolli është kaq i lidhur me to, përbëjnë në të vërtetë suksesin dhe jetëgjatësinë e poezisë së tij. Nëse do duhej të listonim titujt, në këtë pikë kemi të gjithë vëllimet poetike, ku kulmin e këtij qëndrimi ai e shfaq në poemën “*Nënë Shqipëri*”. Është fakt që në letërsinë shqipe, muza mitologjike në veprën

e Agollit vjen natyrshëm, sepse edhe lidhja e tij me mitin e Atdheut, me mitin e Tokës, është po aq e natyrshme. *Komisari Memo* apo *Mato Gruda* thjesht e duan Atdheun e tyre deri në mitizim dhe përtej kësaj dashurie ata nuk vendosin asgjë tjetër. E duan atë në shumë rrafsh:

1. si *dominim* – është vendi ku ata jetojnë dhe realizohen. “*Nënë Shqipëri*”.

“*Shtëpia ime mes **malesh** përzihet me yjtë*

*Mendimet e mia më mblidhen si bletët rreth **nënës***

*Trokasin hapat në **Jug në Veri**.*

*Trokasin pikat nën **strehët**, nën **pragjet**.*

Nënë Shqipëri, Nënë Shqipëri! (Agolli, 1975:20).

2. si *kontroll* – është dëshira për të ruajtur gjithcka që është e tyrja, është e kaluara, historia.

“***Do të vijë një kohë që do të kesh turp t’i kujtosh këto që po bën Arif***”! (Agolli, 1970:34).

Të duash atdheun është krenari mirëpo foljet tregojnë se tradhëtia ndaj atdheut dhe identitetit kombëtar një ditë do të shpaguhet.

3. si *ndjenjë krenarie* – padyshim që krenari për atë ç’ka ata janë dhe ç’ka duan të jenë, gjë që ia mundëson vetëm Atdheu përmes së shkuarës, mitit, dhe të tashmes, realitetit si në poemën “*Baballarët*”.

E në të njëjtën kohë po këtë Atdhe e duan:

1. Si *llastim* – është dëshira e thellë që i bën të ndjehen të përkëdhelurit e Atdheut.

2. Si *foshnjëzim* – është përulësia ndaj eksperiencës shekullore, përjetësisë e përkohësisë

3. Si *individ që mbart mbi vete mitologji e histori*- duke na krijuar kështu një raport mes asaj që interpretohet si një dashuri amnore (racionaliteti, drejtësia) / dashuri atërore (mëshira, barazia), dhe e gjitha kjo si një e tërë që formëson një hero të vetëm me një identitet të spikatur.

“Qëndrojnë para teje

Ja tek më ke

Në krahët e tua,

Mua

Birin tënd, shëmbëllimin e qënies tënde

Atë që tha sa hapi sytë

Në djep:

“Të dua”

Dhe fjalën e peshës së rëndë e ruajtën malet e rëndë”. (Agolli, 1975:24).

Duke e parë këtë si një mjet për të mbijetuar shpirtërisht, në dallim nga Kadare ku personazhet krijohen ekskluzivisht vetëm për të qenë edhe mitikë dhe rendja e tij si autor drejt aktivizimit të figurave mitologjike është qëllim në vetvete dhe përbën në të njëjtën kohë edhe një qëndrim të caktuar estetik e ideor, personazhet e Agollit nuk merren si një qëllim në vetvete për të qenë edhe personazhe mitologjikë, ai nuk e kërkon mitologjinë, nuk qëmton në të dhënat e saj, nuk përpiqet të bëhet i veçantë në syrin e lexuesit. Për Agollin, mitologjia ekziston atje ku ekziston personazhi, atje ku ekziston dashuria e tij ndaj Tokës, Atdheut, Nënës e kështu me rradhë. Ai nuk e ka qëllim në vetvete një gjë të tillë, por kjo shpërfaqet natyrshëm dhe vjen si një jehonë e largët, materializuar me qëllimet e ditëve të sotme. Tek ky proces ligjërimit vërejmë një sistem tjetër në ndërtimin e heroit mitologjik duke na krijuar disa lloj modelesh:

Modeli i parë mund të ishte sjellja e personazhit në rrethana të caktuara historike. Sjellja e tyre, kujtojmë gjithnjë *Komisarín Memo dhe Mato Grudën*, në rrethana vendimmarrëse, aty

ku përcaktohet ardhmëria dhe identiteti i saj, dhe i kombit e në të njëjtën kohë vetpërcaktohet edhe qëndrimi identitar ndaj kësaj ardhmërie, është tipike e heronjve mitikë.

Modeli i dytë mund të ishte, sakrificë që funksionalizohet përsëri me figurën e Komisarit Memo dhe Mato Grudës. Të dy ata bëjnë sakrificë për të mbrojtur vetë identitetin e tyre të trashëguar, por meqë janë në kërkim, ata ende nuk e kanë shumë të qartë ecurinë, por megjithatë e ndjejnë përmes receptorëve të intuitës popullore se janë në rrugën e duhur. E në rastin e tyre bëhet fjalë për një sakrificë sublime- të dy vriten në luftë si heronj.

Modeli i tretë mund të ishte, paralelizmi i figurës femërore, figura mitike e *Femërores së shenjtë*, që vjen si një pasqyrim i matriarkatit nga njëra anë, dhe ekzistencës së Mëmëdheut nga ana tjetër. Kjo e funksionalizuar përmes personazhit lirik dhe epik në poemën “*Nënë Shqipëri*”. Vetë ideja e përngjasimit të Shqipërisë me nënën, shenjtërinë e jetës në tokë e bën apriori këtë figurë mitike, dhe jo vetëm aq, por edhe një figurë që e kërkon dhe e mbron identitetin e saj, e trashëgon dhe e ruan me fanatizëm të lartë.

Ja tek më ke

Në krahët e tua,

Mua

Birin tënd, shëmbëllimin e qënies tënde

Atë që tha sa hapi sytë

Në djep: “*Të dua*”. (Agolli, 1975:24).

Po ashtu ligjërimi poetik i Agollit tregon se miti i nënës është prezente, jo vetëm si figurë letrare e përdorur, por edhe si personazh i mirë skicuar. Ajo që bie në sy më së shumti, padyshim që është adhurimi i thellë që Agolli ka për mitin e Nënës Shqipëri. “*Në këtë poemë zotëron lartësimi i atdheut (jo vetëm socialist), miti i origjinës dhe përthithja e*

krenarisë kombëtare”. (Sinani, 2012:20). Dhe të kesh një adhurim të tillë, kaq të thellë, ta vendosësh dashurinë për vendin, për tokën në majën e një sistemi hierarkik nuk sjell tjetër veçse Paqe dhe qetësi. Kjo shkon në unison me mënyrën e formësimit të mitit si i tillë- kujtojmë se një nga elementet parësorë të krijimit të tij ishte pikërisht adhurimi, që shkon në përpjestim të drejtë me botëkuptimin patriarkal shqiptar. E nëse do shtyhem më tej në arsyetim, dalim tek mendimi që ekziston mbi ndarjen e shoqërisë njerëzore dhe kujtojmë se të përmbash këta elemente:

a.dashuri të pakushtëzuar- ***birin tënd, shëmbëllim i qënies tënde.***

b.dashuri të natyrshme- ***jeton dashuria për ty, se birin tënd s’e thau civilizimi.***

c.lidhje me tokën, me gjakun – ***biri yt di të ulet në sofrën që shtrojnë fshatarët.***

d.mirëkuptim e mëshirë,- ***ne rrimë në prehrin tënd e dorën na shkon në flokë***

thinjët na fshin kur gjunjët na dhembin nga udha

lodhjen na heq kur zgjuar na tretesh mbi kokë...

jemi në rrafshin e *Matriarkatit* dhe me këtë në të njëjtën kohë kujtojmë edhe thelbin e dashurisë e të qëndrimit të Agollit ndaj vendit të tij. Nga ana tjetër, kujtojmë që, e kundërta na shpie në rrafshin tjetër, atë të *Patriarkatit*. Të dy këta rrafshe, *Matriarkati dhe Patriarkati* në marrëdhënie me njëri tjetrin nuk bëjnë gjë tjetër veçse ndërtojnë atë çka është më e rëndësishme për një komb- identitetin.

Nëse tek *Komisari Memo* heroi nuk ka dilema dhe e ka pranuar menjëherë edhe ndryshimin e ri, tek *Mato Gruda* kjo gjë nuk ndodh menjëherë. Ai ka shumë pikëpyetje dhe e kaluara, tradita, lidhja e konsoliduar me shkallët hierarkike brenda familjes, respekti ndaj fjalës së të moshuarve dhe respektimi i ritit, edhe në rastet kur ky përfaqëson hakmarrjen si një formë eksistence, bëjnë që ai të ketë hezitimet e veta. “Në këto çaste Zarës iu dhimbs i shoqi. Ajo e

vështronte me një keqardhje të thellë. –Ky njeri i tillë do të vdesë: i dashur, i vuajtur, i munduar me mardhanë e hakmarrjes në gjoks- mendoj ajo”. (Agolli, 1975:149). Në fakt, i parë në këtë këndvështrim, *Mato Gruda* më mirë se çdo personazh tjetër i Agollit përfaqëson në të vërtetë, ndryshimin në sistemin e vlerave në bashkëkohësi. Konceptet patriarkale vijojnë të tkurren derisa vijnë në formën që ne kemi vetëm një raport të ngushtë shtëpi-familje. Plaku Mere në këtë rast formësohet përmes dialogut të brendshëm sepse ai bëhet dëshmitar i shpërbërjes së bërhamës së vogël, familjes, ku dashuria, sakrifica mbeten vetëm të njëkahshme.

Si përfundim, mund të pohojmë lirisht se në veprën e Dritëro Agollit heronjtë me elemente të mitologjisë që vijnë si pasqyrim dhe përmes trajtimit të tyre në rrafsh më të përditësuar e konkrete, si dashuria për Atdhe për tokën, besimi, shndërrimet, e kaluara e largët si një vokacion i fuqishëm drejt ardhmërisë, pra të gjitha këto vërtetojnë praninë e këtij heroi. Vërtetojnë praninë e rolit të këtij heroi në ndërtimin e identitetit kombëtar, deri në atë masë sa pohohet me mjete artistike se pa këtë të kaluar, pa këta heronj mitikë të shndërruar në heronj realë, nuk mund të ketë një identitet kombëtar. Kombi formohet mbi bazën e etnisë dhe etnia gjallon mbi bazën e ruajtjes me xhelozë të asaj që mund të jetë tharmi i po asaj vetë. Vepra dhe heronjtë e Agollit vërtetojnë gjithashtu se raporti mes së tashmes dhe të shkuarës është primar në përcaktimin e kombit e në të njëjtën kohë falë edhe ndërveprimit mitik, ky raport transformohet në atë që na paraqitet si një raport mes së shkuarës e të tashmes që na çon tek e ardhmja (e cila ndërkohë e ka bërë të vetën identitetin kombëtar).

4.7 Identiteti kombëtar dhe tjetri. Tjetërsimi përmes nacionalizmit.

Dritëro Agolli në tërë krijimtarinë e vet artistike gjithnjë ka shpalosur të mundshmen për ta realizuar në konkrete, duke dhënë shfaqje e komponente të kërkimit nga vlerat estetike por edhe ligjërimore. Ai prej vargut në varg, prej poezisë në poezi dhe prej veprës në vepër, prej ligjëritimit në ligjërim, ka treguar tipare karakteristike, duke shkrirë konstanten me simbolikën origjinale. Agolli në vargun poetik ka reflektuar ligjërimin e ndërtuar me një strukturë të kompozuar dhe figuracion të qëndrueshëm dhe problemeve të shtruara u ka dhënë formë të re në transformimin e motiveve ligjërimore, po ashtu edhe në brendinë evoluese të tyre.

Është fakt i pamohueshëm që në ligjërimin e Dritëroit më shumë se në çdo vepër tjetër të kësaj periudhe, ndjehet lidhja e fuqishme e tij me natyrën, arën, bagëtinë, bujkun, poçarin, pra njeriun e thjeshtë, që mund të jetë edhe babai, familja, vatra, balta. Më shumë se tek çdo poet tjetër kemi kultin e vendlindjes, tokës, bukës, parmendës – pra të gjitha elementet që përbëjnë atë që ne e kemi parë si qëndrim primordialist. Lëvizja Nacionalclirimitare, e cila mbart në trupin e saj edhe vetë kuptimin e saj, ishte një lëvizje e gjerë popullore. Kuptohet që edhe heronjtë e saj do të ishin heronj që dilnin nga gjiri i popullit dhe kështu shihet qartë se si paraqiten personazhet e Agollit përmes këtij ligjërimi. *“Para syve të tyre gjelbëronte një grurë i sapombirë, që **nuk e dinin** se kur **do të piquej**, që nuk e dinin nëse **do ta korrnin** ata vetë apo do ta korrte ndonjë tjetër”*. (Agolli, 1975:95). Fjalët me të zeza tregojnë veprime që lidhen me vazhdimësinë dhe primordializmin por mbartin dhe peshën emocionale të dilemës së të mbeturit gjallë.

Në fillim paraqiten si personazhe vëllimorë, pra personazhe me biografi të pasur, me botë të brendshme dhe tipare fizike të përcaktuara. *“Tani ai e përforcoi mendimin se **fytyra e bustit i ngjante shumë fytyrës së Rustemit**. Po ato **vetulla të trasha**, po ato **mollëza të nëdha**, po ato **nofulla të rënda** ishin edhe në fytyrën prej bronxi”*.(Agolli. 1981:6) Ky personazh ka një jetë të brendshme shpirtërore të dukshme dhe është i pajisur me detaje. Siç vërejmë edhe përmes ligjërimit të tyre, personazhet e Dritëro Agollit, janë të tillë, që protagonistët janë vëllimorë, ndërsa dytësorët janë të rrafshët.

Në veprën e Dritëroit, fare bukur ne e identifikojmë heroin, personazhin kryesor në shumë përmasa, por të tjerët na paraqiten jo krejtësisht unikë. Ata mund të mos kenë zhvillim dhe të të mbeten në mendje gjatë. Kjo gjë ka ndodhur me Bamkën, Mazllëmin, Sali Protopapën etj. Në këtë mënyrë është vërtetuar edhe thënia e David Galef i cili pohon: *“Identitetet e rrafshët mund të jenë shumë të gjallë dhe mund të ngelen thellë në kujtesë, pavarësisht mungesës së zhvillimit të tyre”*(Galef:1993).

Personazhet e Dritëroit përfaqësojnë vetveten si personazhe tre dimensionalë, pra të ngjashëm me ata realë. Bëjmë fjalë, në këtë rast, për ato personazhe që kanë lindur para vitit 1990, pasi, nëse iu referohemi atyre të mëpasmëve do të shikojmë se ndryshimi dramatik i qenies njerëzore, si pasojë e ndryshimit të sistemit politik e ekonomik si dhe zhvillimit teknologjik të jetës, këta personazhe kanë tendencën të na paraqiten jo më si tre dimensionalë, por dy dimensionalë, gjë që do të thotë se edhe vetë autori ka evoluar së bashku me shndërrimet e kohës. Këtë e vërejmë sidomos tek romanet “Arka e djallit”, “Kalorësi lakuriq”, “Trëndafili ne gotë”, “Vjen njeriu i çuditshëm” etj. Po nëse do të ishim më të vëmendshëm do të vërenim se fillesat e këtij lloji personazhi janë që herët me

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, “Njeriu me top”, “Dështaku” etj të cilët dhe na interesojnë më shumë në punimin tonë.

Reaksioni i shndërrimit të personazheve në raport të drejtë me shndërrimet jetësore është i pashmangshëm dhe i pritshëm në të njëjtën kohë, në rastin e Dritëroit. Modeli i këtij lloji personazhi ka një shndërrim të brendshëm që shoqërohet me paraqitjen e jashtme. Në këtë rast bëhet fjalë për jetën e këtij personazhi, më saktë protagonistin, heronin, i cili në mënyrë të pashmangshme kalon nga një hero popullor, njerëzor në një hero nacionalist. *“Ndërkohë hyri Zara me një çemberkë në kokë. Ia dha dorën italianit dhe u ul në vatër pranë hallës. Augustoja e vështroi Zarën dhe aty për aty i largoi sytë. Mato Gruda me këtë gjest kuptoi se italianin qenkësh njeri i sjellshëm e që paskësh mësuar ca nga zakonet e fshatrave. Gratë nuk duhet që ti vesh re gjatë, nuk duhet t’i vështrosh në beben e syrit: dhe ai tha me vete se i huaji do të ishte nga ndonjë derë e mirë dhe fisnike”*. (Agolli, 1975:63). Lufta i ka tjetërsuar herojtë, po kështu dhe Maton. Përmes këtij konteksti kuptojmë që ai e paragjykon italianin në sensin pozitiv të asaj që duket dhe marrëdhënieve që krijohen (tashmë në familje). Përdorimi i grupit foljor *ia dha dorën* shërben si procedë për të theksuar veprimin, i cili nga ana tjetër përforcohet nga mbiemrat *e mirë dhe fisnike* për të treguar një traditë ardhur nga primordializmi.

Përveç kësaj, fakti i ekzistencës së përfaqësuesit më tipik të tyre, komisarit Memo, është rasti më i qartë i këtij shndërrimi. Që në fillim Memo na shfaqet një njeri i thjeshtë, një fshatar dhe jo pa qëllim është zgjedhur i tillë.

Lufta Nacionalçlirimtare në thelbin e saj ishte lëvizje që u dominua nga fshatarët, ata ishin përbërësit e brigadave partizane, dhe kjo shkon drejtpërdrejt në shërbim të qëndrimit primordialist/pra fshatari që jeton në këtë realitet, dhe ideologjisë komuniste e cila e veshur

me këtë petk nacionalist e ktheu lëvizjen antifashiste në një lëvizje popullore masive. Në këtë mënyrë *Memo* shndërrohet në *Komisari Memo* duke i dhënë e njohur vetes atributet jo vetëm të personazhit protagonist, por edhe të heroit. Dhe si *Komisari Memo* janë edhe personazhe të tjerë të Agollit që përbëjnë galerinë e tyre. Te romani “*Njeriu me top*” krahas trajtimit të temës së luftës trajtohet gjerësisht edhe ai i ndikimit të ideve të revolucionit në psikologjinë e turmës popullore, i ndryshimeve të thella që ndodhën në ndërgjegjen e tyre. Në këtë roman ka një tendencë për të trajtuar një anë pak të njohur të një realiteti që ka kaluar tashmë, të gjurmëve të tij dhe të ndikimit të tij në shndërrimet e ndryshme të personazheve. Autori ka pasqyruar në këtë varg ligjërimor një proces karakteristik për kohën, atë të shndërrimit të këtij fshatari të mbrujtur me paragjykimet dhe stereotipin e një të kaluar e cila shumë pak ka ndryshuar në mendësinë e tij në rrjedhën e kohës. Panorama është kjo: -fshatar i thjeshtë -fshatar nacionalist -fshatar idealist

Komisari Memo, *Mato Gruda* etj, janë emrat e përveçëm përfaqësues. Në jetën shpirtërore të *Mato Grudës* zë vend origjinaliteti i një identiteti fshatar tipik të asaj kohe. Ai është i kthjellët, mbart në vete urtësinë e të parëve të vet, tradicionalist, filozof prej natyre, autentik e popullor. Forcat që e shtyjnë *Mato Grudën* drejt zgjedhjes së qëndrimit të vet janë shumë herë më të fuqishme se ai vetë, është realiteti që jeton përmes nacionalizmit të ringjallur për shkak të situatës së luftës. Dhe autori nuk e ka të vështirë ti pasqyrojë këto ngjarje të Luftës, sepse gjuha që ai përzgjedh dhe vetë qëndrimi i tij estetik ia mundëson një gjë të tillë.

Tek “*Komisari Memo*”, Agolli “*ndjek kryesisht traditën e pasqyrimin epik të jetës, por ai e pasuron këtë traditë duke gjetur një zgjidhje origjinale artistike për të pohuar këtë traditë, trashëgiminë kulturore*”. (Bulo.1982:221). Në ligjërimin e Agollit nuk kemi vetëm një pikënisje për të zhvilluar mendimin mbi domethënien e tyre në kuadrin e idesë së veprës.

Agolli nuk abstragon me fjalë mbi ngjarjet, por ai e aktualizon kuptimin dhe rëndësinë e tyre duke i afruar në kohë me anë të sinkronizimit artistik të së kaluarës me të tashmen.

Ligjërimin e romanit *"Komisari Memo"*, e formojnë një varg ngjarjesh të cilat na vijnë njëra pas tjetrës si një zinxhir kujtimesh që u zgjon bashkëlufëtardë të afërt të komisarit udhëtimi i bustit për në fshat. Shfrytëzimi nga ana e autorit i digresionit në formën e kujtimeve i ka dhënë rrëfimit një karakter më intim dhe më emocional, kjo ka bërë që ideja e aktualitetit të trashëgimit shpirtëror të epokës së luftës të tingëllojë në mënyrë më të natyrshme. Në romanin e Agollit problemi i trashëgimit moral të luftës nuk shihet në plane filozofike, traditat heroike të kësaj kohe pasqyrohen drejtpërdrejtë si diçka e gjallë e mishëruar në karaktere e situata konkrete. *"Autori pohon idenë se këto tradita janë të pavdekshme, se ato veprojnë në jetën tonë si një forcë aktive dhe jo vetëm një kujtim i së kaluarës"*. (Bulo.1982 :223). Është një roman i cili pavarësisht kohës se kur u shkrua dhe rrymës letrare që ndoqi, gjithësesi të mbetet në mendje. **E para**, sepse është shkruar me shumë dashuri dhe kjo ndjehet fare bukur në çdo gdhendje që u ka bërë personazheve. **E dyta**, sepse emocionalisht qëndron shumë lart, kjo do të thotë që këto emocione përcillen fare bukur tek marrësi i mesazhit (lexuesi). Skena kur busti i heroit mbërrin në fshat dhe prindërit e tij puthin bronxin dhe duan ta marrin në shtëpi ka një regjistër shumë të lartë emocional. *"Sa afroheshin ata që mbanin bronzin, aq më shumë lëviznin ato dy figura. Pastaj ato u lëshuan tatëpjetë kodrës për të takuar njerëzit që mbanin bronzin. Ishin i ati dhe e ëma e Memos. ..-O bir, sa na ka marrë malli! Ata nuk e linin mushkën të ecte. Zgjatëshin nga busti dhe e preknin sikur të ishte i gjallë"*. (Agolli, 1975:301).

Nga ana tjetër, kompozicioni i veprës vërteton edhe një herë qëndrimin e autorit për të kaluarën e të tashmen dhe për lidhjen mes tyre. Ai vetëm gjen mundësinë dhe pohon e

ripohon me forcë se e kaluara, se heronjtë e saj janë të pavdekshëm, sepse të tillë rrojnë në kujtesën e popullit. Nëse Mato Grudës iu desh kohë të pësonte një shndërrim, nga një fshatar i thjeshtë i mbrujtur me traditat e veta morale të trashëguara nga e kaluara, Memo Kovaçi vjen i përgatitur si i tillë, i shndërruar. Për Mato Grudën e kaluara është e shenjtë dhe nuk mund të ndryshohet, për Memo Kovaçin shndërrimi i vetes dhe i gjithë të tjerëve bashkëkombas të tij, është thjesht vetëm qëllimi që e afron atë si personazh protagonist drejt shndërrimit identitar. Në fund, të dy janë të shndërruar, kanë kaluar përmes së kaluarës drejt së ardhmes. Në të dyja rastet e kaluara jo vetëm që mbahet, por nëse është brenda normave morale të reja të shoqërisë së re që po ndërtohej, bëhej aktive dhe vendosej edhe ajo në funksion të realizmit të krijimit të heroit të ri. *“Letërsia shqipe nuk kishte njohur më parë një tip të tillë të konceptuar si një karakter me domethënie të gjerë shoqërore dhe të vizatuar me tipare të gjalla individuale, përmes të cilave shprehet në mënyrë plastike thelbi i tipit social që ai përfaqëson si dhe qëndrimi emocional i autorit ndaj kësaj figure”.* (Bulo.1982:238).

Kritika ka vërejtur se personazhet e një letërsie klasike mund të jenë dinamikë. Ata janë vërtetë shumë dinamikë, sepse duke mbajtur mbi vete mesazhe të ndryshimeve të mëdha, këto nuk mund të realizohen po nuk qenë dinamikë. Dinamizmi i tyre shkon në harmoni me pikësynimin e autorit, në atë të ruajtjes së traditës dhe krijimit të një tradite të re të idealizuar, sigurisht të mos e harrojmë këtë detaj. Përvoja e tyre rrëfimtare është lineare në dinamikën e saj në rritje. Rritja e ka një cak i cili është shndërrimi i personazhit protagonist në hero. Heroi i kërkuar nga ideologjia, hero i pranuar nga masa, hero i krijuar nga autori. Skema e kohës e kërkon personazhin e tipit të Komisarit Memo apo Mato Grudës, por Dritëro Agolli me intuitën e shkrimtarit të talentuar e ndjen dhe na e përcjell një tjetër

tip personazhi që mbart një tjetër identitet. Për të parët flitet për një identitet të sunduar nga ideologjia, sikur edhe e pamë, ndërsa në të dytët Agolli me shumë guxim, duke dalë jashtë këtyre skemave, na jep një tjetër identitet, atë të njeriut kompleks tek i cili ndërthuren kohët, e kaluara dhe e ardhmja.

Përballë Memos kemi atë që përfaqëson antiheroin në roman, që është Sali Protopapa. Në ligjërimin e tij vëmë re që me ironi përmendet ose nënkuptohet identiteti kombëtar në emër të të cilit luftohet dhe propogandohet, por në të vërtetë puna dhe qëllimet e tij janë antikombëtare. *“Punët e mira bëhen avash avash. Komunistët po marrin popullin më qafë. Italia sot për sot është mbretëri e madhe. Dhe po të dojë e mbyl Shqipërinë me pështymë”*. (Agolli, 1970:40). Siç mund të vihet re, Sali Protopapa e vendos veten në rolin e ndërmjetesit me të huajin por në fakt duket qartë se ai po bën propagandë antikombëtare dhe nga mënyra se çfarë fjalësh përzgjedh për ta treguar këtë.

Tashmë ky personazh është në kërkim të një formati të ri, që për hir të së vërtetës është shumë e vështirë në ato kushte të realizohet. Jemi në kushtet e shndërrimit të këtij identiteti dhe të dëshirës së sistemit për të ndryshuar. Kështu që tek Memo e Mato Gruda kemi një individ i cili është shumë nacional, e kuptuar kjo si një lidhje e fuqishme me të kaluarën, trashëgiminë, me besimin dhe tokën, me thelbin primar që këto kanë në jetën e njeriut. Kemi një individ i cili është më kozmopolit, ku elementet e identitetit janë më globale, ai është njeriu i lirë në Kohë e Hapësirë, dhe si i tillë kërkon hapësirë e kohë tjetër, të ndaluar nga regjimi i kohës, e në të njëjtën kohë po ky individ i ruan lidhjet me traditën por jo aq sa ajo të diktojë në jetën e tij dhe në vetpërcaktimin identitar. Pra, vërehet qartazi se kemi ndryshime të dukshme në sistemin e ndërtimit të individit identitar.

Sipas kësaj tablele, në rrafshin linear të personazhit (po i shënojmë edhe kuptimet e mundshme të kësaj fjale për t'i patur parasysh reflektimet e saj tek analiza e personazheve) kemi: Vijëdrejtë, Vijor, Vizor, Koherent, Me lidhje logjike, I çiltër, Logjik.

Tabela 3. Ndërtimi i individit identitar përmes rrafshit linear te personazhet e Agollit.

Ndryshimi i identitetit linear	Komisari Memo, Mato Gruda	Shoku Zylo	Plaku Mere, Doktor	Demka, Bamka
Në fillim të ndryshimit të sistemit politik	Konservatorë, identitet të mirëformuar, prirje për ndryshim		Konservatorë, identitet të mirëformuar (megjithëse nga klasa të ndryshme shoqërore), asnjë prirje për ndryshim	
Në mes të sistemit politik të ndryshuar	Mbeten si pranues të ndryshimit, të ideologjisë	Liberalë, identitet të ideologjizuar, prirje të fuqishme për ndryshim	Janë me identitet të ndryshuar në favor të ideologjisë	Konservatorë, identitet ideologjik, prirje për te mos pranuar ndryshimet
Në fund të sistemit politik	Mbeten po ata, por ndryshon qëndrimi ynë për ta	Pranojnë ndryshimin e tyre identitar që i zhvesh nga ideologjia	Mbeten po ata në thelb, me pak ndryshime të pakonsiderueshme	Nuk arrijnë të kuptojnë dhe as guxojnë të kenë ndryshime, të kënaqur me identitetin e tyre.

Pra, siç shihet edhe nga kjo tabelë, identiteti i personazheve të Dritëro Agollit pëson ndryshime që shkojnë në varësi të ligjërimit dhe gjuhës, kohës dhe intensitetit të saj. Nga ana tjetër ata përmbushin vetë profecinë e tyre duke respektuar thjesht rregullat ose duke u bërë vetë pjesë e kësaj loje. Nëse pranojmë se personazhet e Agollit janë linearë, sikur janë të gjithë personazhet e letërsisë klasike, kjo do të thotë që ata janë:

1. vijëdrejtë, që do të thotë, ndjekin një linjë zhvillimore të karakterit të tyre tipik
2. vijorë, që do të thotë, e ndjekin vetveten hap pas hapi në zhvillimin e tyre, pa ndërprerje, sipas një skeme të mirëpërcaktuar.
3. koherente, që do të thotë kanë pika lidhjeje logjike dhe ecuri po ashtu, logjike në jetën e tyre si personazhe, duke imituar kështu edhe jetën e përditshme, realitetin.
4. me lidhje logjike, që do të thotë marrëdhëniet që ata krijojnë edhe me të tjerët janë gjithashtu logjike dhe ndjekin rregullat e saj, natyrisht sociale. *“Doktori **buzëqeshte ngadalë**. Këta **pleq të imët**, që gjithë shpresat e tyre i kishin tek i biri dhe që e shikonin me një **adhurim të madh**, e emocionuan aq shumë, sa që mezi fliste. Bile e emocionoi edhe **dehja e lehtë** e plakut, që rrinte krah plakës së tij”.* (Agolli, 1970:139).
5. të çiltër, personazhet e Agollit janë të çiltër kur flasin e veprojnë, të tillë i gjejmë edhe “personazhet e këqinj”, përmes gjuhës së tyre, pra diagrama e zhvillimit të tyre është e kthjellët.
6. logjikë kur flasin sepse nuk mund të jenë ndryshe përderisa flasim për letërsi të realizmit socialist.

Por nëse nisemi nga arsyetimi i kundërt, pra të një personazhi alinear, atëherë ndoshta do të kishim këtë skemë:

Tabela 4. Ndërtimi i individit identitar përmes rrafshit jolinear të personazhet e D. Agollit.

Ndryshimi i identitetit jolinear	Komisari Memo Mato Gruda	Shoku Zylo	Doktori, Plaku Mere	Bamka, Demka
Në fillim të ndryshimit të sistemit politik, nga borgjezo-feudal/komunist	Këto më të dukshme janë tek Komisar Memo, pasi ai shfaq më shumë elemente të ndryshesës identitare.		Plaku Mere megjithëse konservator, në fund të fundit ka një ndryshim identitar, si përaçësues i trashëgimisë	
Në mes të ndryshimit të sistemit politik, jemi në komunizëm		Prirjet liberale dhe globalizmi ndryshimi i perceptimit identitar është i dukshëm dhe haptas e tregon tjetërsimin		Pas personazheve kryesore vijnë edhe këta, por shumë herë më me pak intensitet
Në fund të sistemit politik të komunizmit	Mbeten ashtu sikur janë dhe qëndrimi ynë për ta mbetet po ai	Marrin statusin e antiheroit haptas duke e sjellë Agollin në kufijtë e disidencës		Kthehen hapatas në personazhe plotësues.

E kuptuar kjo në analizë të personazhit modern vjen e zbërthyer shumë qartë tek Agolli. Shoku Zylo, Cute Babulja, apo Dane Hundleshi tek *“Kalorësi lakuriq”*, (këta të fundit nëse do ti kishim bërë pjesë të analizës sonë), të gjithë këta personazhe mbartin karakteristika të jolinearitetit.

Në këtë rast ndodh ky hiperbolizim, sepse të gjitha veprimet e heroit dhe të superheroit shndërrohen nga kategoria e të vlerësueshmes në atë të mbivlerësueshmes, qëndruar kjo vetëm mbi një kategori- atë të zakonshmes. Është një formë shumë e njohur në romanet klasike të realizmit socialist. Është ai që është kudo, që zgjidh gjithçka, që zgjidhja e tij përkon me të mirën e të drejtën, tipare të mbartura këto, por edhe dëshira për të zgjidhur gjithnjë ai problemet e bën atë në të vërtetë një superhero.

Si përfundim, personazhet e Agollit janë personazhe që në rrjedhën e kohës dhe të rrethanave historike e kanë tjetërsuar identitetin, në kuptimin që e kanë ruajtur thelbin, bazën e tij të paprekur dhe vetëm e kanë pasuruar me qëndrime të reja që shkojnë në mënyrë të drejtë edhe me qëndrimet e përbotshme në fushën e krijimit, zhvillimit dhe ruajtjes së identitetit kombëtar. Agolli, përmes ligjëritimit të përzgjedhur prej tij vetë, më mirë se kushdo tjetër, më qartë e kthjelltë ka ruajtur ekuilibrat e këtij identiteti bashkëkohor. Ata përballojnë shumëllojshmërinë e identitetit të tyre duke krijuar këssoj ura në shoqëri dhe duke u orientuar drejt zhvillimit, në rrugë të reja identitare. Padyshim që kombi, etniciteti i tyre nuk ceket në asnjë rast, e në fakt ky është edhe procesi që ndodh realisht sot në botë në shumicën e kombeve. Kjo i bën ata personazhe sa kombëtarë dhe të mirë identifikueshëm, aq edhe universalë. Dhe kjo padyshim që është meritë e Dritëro Agollit, i cili i kapërcen kufijtë e skemës së metodës së vet, sikur e kanë vërejtur edhe studiuesit.

Nga sa më sipër, themi se, pavarësisht se si shfaqet personazhi në një vepër letrare, (vëllimor, dinamik, hero mitik, hero, superhero), në veprën e Agollit ai vepron si hero i shndërruar në shërbim të ideologjisë, por mbi një shtrat të sigurt nacionalist, pa e humbur asnjëherë e në asnjë rast pikërisht lidhjet e ngushta e të hershme me të.

4.8 Identiteti kombëtar si trashëgimi dhe traditë.

“Në çaste të vështira, popujve u ndriçohet mendja në mënyrë të ethshme”. (Kadare.2006:45). Populli shqiptar u gjend jo rrallë herë në zgrip të identitetit të tij. Shumë herë u vu përpara alternativës për të jetuar apo për të vdekur, shuar. Shumë herë ai luftoi, fitoi, humbi, mbijetoi. Dhe është e natyrshme se gjatë këtij procesi të gjatë historik ai të përvijojë tipare të ngurtësuara të karakterit të tij, të dallueshme nga gjithë fqinjët e tij. Atë që ne e njohim si identitet.

- *Mora vesh se paska qenë në këtë **odë** Tosun Baçi, - tha Murat Shtaga pas një heshtjeje.*

- ***Pushka e trimit dhe sofrë e mikut nuk kthehen!** – tha plaku Mere.*

- *Ai nuk është **as mik, as trim!**, - tha Murat Shtaga.*

- *Trim nuk e di, po mik është, se kapërceu **këtë prag!**, - tha plaku Mere.*

- *Ai nuk e kapërcen këtë prag si mik, po **si tradhëtar**. Ka dashur të kapërcejë dhe pragje të tjerë, ia kanë vënë hurin... Ai është me ata që djegin **pragjet e popullit**. Dhe është gënjeshtar, - tha Murat Shtaga”.* (Agolli, 1975:104). Koha nuk u tregua mikpritëse me shqiptarët, po ashtu edhe politika e përbotshme e cila e nxituri nga lakimi të niveleve të

ndryshme dhe nga interesa të ngushta pushtetarësh lokalë, ia vështirësuan jetën si vetes, ashtu edhe gjithë popullsisë. Po pavarësisht prej këtyre, shqiptarët mbijetuan bukur shumë.

*“Mirëpo kohët e fundit edhe mes Pinxhove dhe Marukëve u ndez një **hasmëri e egër**. Por Marukët ishin edhe **të ndershëm** edhe **trima**. Ata nuk donin t’i sillnin dëm Lëvizjes Nacionalclirimtare, prandaj ruheshin nga hasmëritë”. (Agolli, 1975:52).* Këtu vihet re dukshëm kontrasti mes tipareve të trashëguara të raditës si ndershmëria, trimëria të cilat gjithmonë kanë qenë në ndihmë të forcimit të identitetit kombëtar, por që me forcë janë përpjekur të mbijetojnë. Natyrisht që kjo mbijetesë gjente pasqyrimin e vet në të gjithë jetën shoqërore të kohës dhe të bashkëkohësisë... Kjo mbijetesë, në rrafshet teorike është njëjtësuar me qëndrimin ndaj krijimit, ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit kombëtar, e në raport me këtë edhe në dy rrymat kryesore të zbërthimit analitik identitar: *Primordializmit dhe Konstruktivizmit*.

Më konkretisht, për të përforcuar hipotezën tonë, do të përpiqemi të zbulojmë përmes veprës së tij qëndrimin që ai ka mbajtur në raport me primordializmin dhe konstruktivizmin. Për efekt studimi, meqë për personazhet më përfaqësues të tij kemi folur më lart, në këtë shënim do të ndalemi më gjatë në poezinë e tij e më konkretisht në dy nga veprat më përfaqësuese të tij, në poemat *“Devoll, Devoll”* dhe *“Baballarët”*. Kuptohet që i njëjti qëndrim përcillet në të gjitha poemat e Dritëro Agollit, përfshirë edhe *“Nënë Shqipëri”*.

Identiteti kombëtar shqiptar në ligjërimin poetik na shpërfaq përfaqësimin e emblemës së identitetit shqiptar, në rrafsh historik si një sakrificë e shumëanëshme si dhe në rrafshin bashkëkohor, si dëshmi e prirjeve lindore dhe perëndimore të mbijetesës së shqiptarëve, ku

kulmin e shënon poema epiko-lirike “Nënë Shqipëri”. Më qartë se kudo tjetër këtu ndihet një lloj fryme futuriste e romantizmit naimjan, të cilën Agolli kërkon ta mbartë si frymëzuese për ndërtimin e një Shqipërie në dukje të lumtur përmes dy formave: së pari, përmes ndikimit nga miti i së shkuarës dhe i nostalgjisë për kohët e mëdha dhe së dyti, përmes idealizimit dhe ngritjes në kult të një vendi utopik. Referuar teorisë primordialiste, përmes një procedje ligjërimore e letrare, duke u përpjekur të krijojë ura besimi mes nacionales dhe identitetit, Agolli sjell një problem mjaft të madh e të kahershëm të shqiptarëve, atë të ruajtjes së vlerave shpirtërore e kombëtare përtej ndarjeve e hapësirave territoriale jo si formë e kërkesës materiale, por si një tëhuajtësim të ndjenjës morale e shpirtërore, si dhe duke na treguar se baza e identitetit tonë është prejardhja jonë e përbashkët, apo se etnija dhe identiteti përfaqëson diçka më të natyrshme dhe biologjike.

Ralf Ualldo Emerson thotë: *“Poetët janë perëndi çlirimtare”*. Parë në kontekstin tonë themi se poetët kanë patur dhe kanë role të ndryshme në shoqëri gjatë ekzistencës njerëzore. Po sigurisht që roli evokativ mbetet roli primar i tyre. Evokim që lidhet drejtpërdrejtë me identitetin, me rrugët që çojnë tek ai, me zhvillimet e tij, me rolin dhe rëndësinë e tij në mbijetesën kombëtare, në ndërgjegjësimin e popullit pikërisht me këtë ndjesi identitare.

Gati 60 vjet më parë, kur Dritëro Agolli u prezantua për herë të parë si poet me vëllimin poetik *“Në rrugë dola”* (1958), *“... bota e poezisë ishte e dominuar nga tradicionalizmi poetik. Totalitarizmi shqiptar e kishte korrupsionuar mendimin publik kundrejt formave poetike tradicionale të së kaluarës njerëzore, duke lënë vetëm zërin sekret të poetëve si burim të sigurt të së vërtetës”*.(Sinani.2012:36), apo identitetin shqiptar të çliruar nga rrethanat

ideologjike në vëllimin “*Mesditë*” (1969), ku identiteti gjendet brenda një kornize që e identifikon me token, si element thelbësor primordial.

*Ngrihej dielli nga **malet** e binte në det*

*I spërkiste hëna shelqjet e **borigat***

Ku flinin zogjtë tulitur në fletë

*... U mundova **ugareve** përditë*

*Dhe asnjë **grusht toke** pa mbjellë me një **filiz** s’lashë*

*... Më ke parë ti **Atdhe** se cili kam qenë?*

*... **kokën në prehrin tënd** kam vënë”. (Agolli, 1969:80)*

Apo në poezinë “*Toka ime, kënga ime*” ku gjejmë mjeshtërisht të ndërthurura dy elemente të qenësishme të identitetit sic janë: *toka* dhe *fjala* me të cilën heroit këndon dhe ngre në kult, për të vërtetuar atë që thelbi është pjesë e të qenit unik në formimin e vetëdijes kombëtare.

*“Tokë e dashur... qëkur kam hedhur të parat **hapa***

*... e kam ndier këtë nga **avulli yt i ngrohtë**, nga **era jote**.*

*Kam takuar tek dorën mbushja me **grurë**,*

*... më ra shorti i **bujkut**, shorti i poetit”. (Agolli. 1969:53)*

Vetëm përmes përdorimit të herë të figurës stilistike të epitetit metaforik *tokë e dashur*, gjuha vjen si një thirrje e brendshme e fuqishme për të vazhduar atë konotacionin lirik të një

rrëfimi epik që na vjen nga Rilindja jonë kombëtare, e për të ecur kësisoj në gjurmët e Naimit, të cilin Agolli vetë e ktheu në një mit të penës e të fjalës shqipe, duke parë tek ai mishërimin e njeriut me ideale të qarta kombëtare në të cilën fle një identitet i kompletuar kombëtar.

*“Ti, si **bujk** i mirë, **lërove arën** e fjalëve,*

Arën** e fjalëve të **stërgjyshërve** mbetur **djerrë

*Mbuluar nga **barëra** të liga **maleve***

*E lërove që djerrë **të mos mbetej** asnjëherë” (Agolli, 1969:53*

E gjithë sa pohuam më sipër, vërteton dhe njëherë tezën tonë se për primordialistët a) Historia, b) Kultura, c) Tradita e një kombi, janë pika kryesore e ekzistencës së një kombi. Dukshëm vemë re praninë e sistemit komunist ku identiteti shqiptar gjendet i kushtëzuar në rrethanat ideologjike siç spikat tek poema “Devoll, Devoll” etj. Është koha kur teoria e Realizmit Socialist, sa absurde aq dhe groteske, po përpiqet të ndërtojë një njeri të mbrujtur me idenë e qenësisë dhe të nacionalizmës duke u identifikuar me pjesë të fundamentit të tij siç është në këtë rast lumi i vendlindjes, Devolli me të cilin lidhen sa e sa ngjarje, histori e legjenda mitike të identitetit të tij personal e kombëtar. Duke e personifikuar dhe duke e bërë pjesë të vetëdijes së tij kombëtare, Agolli e sheh si një lloj krijese që ecën përmes shtigjeve e që mbart një pjesë nga historia dhe kultura kombëtare pa të cilën ai (Agolli) nuk jeton dot. Kjo bie në sy që në vargjet e para tek poema “Devoll, Devoll”(1964):

*“Po, Devoll, i tillë qenkam **unë**,*

*Paskam marrë **baltën** tënde **arave***

*Në një **trajstë leshi**, ndënë **gunë**,*

Për t'ia sjellë Lidhjes së Shkrimtarëve” (fq.9)

Që në këto vargje ai kërkon të afirmojë qenien e tij si një pjesë organike, natyrore, normale të një përkatësie historike që është e njëjtë jo vetëm për të si një individ-**unë**-, por edhe për të gjithë vendin të cilit ai përket natyralisht, **-baltë, arave, gunë, trajstë leshi-** Kohët e foljeve të përdorura në këto vargje nuk bëjnë gjë tjetër veçse afirmojnë edhe njëherë përkatësinë e tij historike të pandashme nga populli të cilit ai përket dhe që dëshiron ta bëjë prezent për të gjithë një qëndrim të tillë. Për ta përforcuar akoma më tej, më saktë e më fuqishëm:

“**Unë** jam një **plisi yt i tëri**

Dhe një copë **shkëmb** i pagdhendur

Dhe ky plis ngaherë ish i fortë...

...dhe në vargjet mbeti ajo **baltë**

Mbeti ai **bar**, ai **trifil**

Mbeti ai **fyell**, ai **mjaltë**

Mbeti ai **gjemb** e **trëndafil**...” (po aty, fq.11)

Vihet re dukshëm lidhja e pashkëputshme e personazhit patriot me tokën amtare, ruajtjen prej tij të fizionomisë krejt shqiptare dhe cilësive më të mira të popullit tonë. Sikur vihen re në 4 vargjet e fundit përmes metonimish të goditura, origjinaliteti dhe karakteri i theksuar popullor dhe fizionomia thellësisht kombëtare.

Ndërsa lidhja socio-biologjike (të afërmit, lidhje gjaku), vihet re më së shumti tek poema tjetër e tij “*Baballarët*”(1969):

“Eh baballarë,

Kjo vatër ne na polli

Këta thëngjij të kuq na mbajtën nxehtë

Ky lesh velenxash trupin na mbështolli

Ky prak na nisi udhëve në jetë

Në dejtë tanë gjaku juaj ecën, i nxehtë,

Si në motet tua rinore

Kur vriteshit me plumb për të vërtetën

Në brazda e në male me dëborë.”(Kënga IV-V, Baballarët)

Të njëjtën ide e gjejmë edhe tek poema “*Nënë Shqipëri*”, kënga IV, Strofa 14. Baballarët vërtetë dalin të plakur, por ata janë gjithnjë në lëvizje e ndryshim. Në të gjithë poemën i lihet një vend i gjerë portretit fizik dhe moral të baballarëve dhe kjo bëhet jo pa qëllim. Shqipëria është e shtrenjtë, zhvillimi i saj po ashtu. Baballarët janë etër të denjë për bijtë e tyre dhe historia përsëritet kur bijtë janë bij të denjë për baballarët e tyre. Dhe kjo e ka domethënien e vet sa historike, që do të thotë se kemi të bëjmë me një lloj marrëdhënieje që

vjen nga historia specifike e popullit shqiptar, dhe e dyta, gjenetike, është linja e gjakut që vazhdon “*të prodhojë të njëjtin produkt*”.

Qasja e vetëndërgjegjësimit për identitetin kombëtar shqiptar tek vëllimi “*Pelegri i vonuar*”, ku gjejmë një Dritëro të vetëdijshtë për vonesën në kohë përgjatë udhëtimit të tij metaforik, ndikuar nga mungesa e kohës reale por edhe nga zhgënjimi përtej një ideali, të cilin, të plotë nuk mundi tua përcjellë brezave, pasi të jesh apo të ndjehesh shqiptar, për Agollin është një lloj detyrimi...

*“Unë jam prej kohësh **pelegrin***

Shtegtar i karvanit të humbur

*Dhe bart në **kurriz** një **premtim***

*Të dhënë në **hirin e gjyshërve** të mundur” (Agolli.1993: 5)*

... sepse” Para se të bëhesh një i ardhur, duhet të jesh një i ikur, para se të mbërrish në një vend, duhet të lesh një tjetër dhe ndjenjat e njeriut ndaj tokës që ai ka lënë nuk janë asnjëherë të thjeshta”. (Maalouf. 2006: 42). Fjalët kyçe me të zeza tregojnë se në dallim ndoshta me popuj të tjerë, shqiptarët kanë një unitet brezash historikë për tu admiruar, ku ende sot e kësaj dite ruhen fuqishëm këto lloj marrëdhëniesh brenda familjes, ku respekti për baballarët vazhdon të jetë prezent.

Nga kjo pikëpamje brezat nuk i ndan asgjë, ata i bashkon fuqishëm gjaku i derdhur në luftë, ku shpesh herë krah për krah kanë luftuar babë e bir. (Mato Gruda me te birin Zigurin). I bashkon besimi, dashuria dhe besnikëria e pakufishme ndaj Atdheut, tokës, baltës,

parmendës. Në këtë mënyrë, Agolli përmes poemave në fjalë, por edhe me gjithë krijimtarinë e tij letrare, synoi dhe vërtetoi, edhe duke e kapërcyer metodën së cilës i përkiste (Realizmit Socialist), se primordializmi është një kapacitet universal human, njëlloj si melodia, piktura apo gjuha. *Kënga VII-VIII:*

*“Kështu **na bëtë burra**, baballarë!*

Ne qemë ushtarët e revolucionit

*Që me **durim** të fortë prej **kopshtari***

*Guximin çast me çast **ju na mëkoni...**” (Baballarët. Kënga VII-VIII:43)*

Qasja kulturore është një nga elementët e rëndësishëm në përcaktimin e identitetit kombëtar. Fakti që Agolli ishte edhe komunist dhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë, nuk e pengon atë që të ruajë qëndrimin e tij. Por Agolli do të rigjallëronte traditën e poetit si mjeshër i plotë i një kulture të tërë duke ndjekur në një farë mënyre edhe rrugën e Naimit e Rilindasve të tjerë shqiptarë, të lëvrojë një lloj poezie në të cilën ligjërimi i unit lirik ndërthuret me epikën, në raporte të tilla, sa herë heroi mitik, herë heroi i ditës e herë heroi i ardhmërisë, ndërthuren e ndërveprojnë me njëri-tjetrin duke na dhënë kështu fytyrën e poezisë së Agollit. Ekzistenca e poemave të tij vërteton se nuk është e vërtetë që koha e poemës epike ka përcaktuar, sepse në bashkëkohësinë tonë letrare ajo është zëvendësuar me romanin. Në të kundërt, këto poema jetojnë shumë bukur. Padyshim që nga këndvështrimi i sotëm, ato duhen parë e analizuar duke patur parasysh si kohën, sistemin politik të asaj periudhe, po ashtu edhe nga metoda letrare e imponuar e asaj kohe. Vënia në pah e këtyre elementeve i bën poemat, më të kuptueshme. Është e dukshme që në poemat e

tij Agolli ndjenjat e tij vetjake që kanë lidhje me të kaluarën më së pari, por edhe me llojin e marrëdhënieve që krijohen me brezat, i ndan me komunitetin duke bërë në të njëjtën kohë një promovim të traditës.

“Dhe morëm pas ëndrrat tuaja më të mira

Më të bukurat **ëndërra shekullore**

Për **lirinë** e për **tokat e lira**

Për **njëriun** e për **vatrat paqësore**”, *“Baballarët”, Kënga VIII*

Apo:

“Dhe ne u bëmë baballarë, baballarë!

Dhe **gjaku** i përcjellë **nga epoka**

Te bijtë, le të **rrjedhë** në damarë

E tillë qenka jeta, Valë-valë

Në **dhenë e lashtë** baballarët vijnë

Me një mendin të **brezave** në ballë...

...Dhe **shkojnë motet**, bën të sajën koha

Ju mplaqi edhe kërrusi si kosore

Po para nesh ju ngrihi **si epoka**

Fisnikë, **madhështorë!**...” *Kënga XIII:*

Apo:

“Thellë kësaj **balte** përmbi **lumë**

Që aq **breza rrënjësh** e **lëvrijnë**

Unë, devolliu i pagjumë

Gjeta vargjet, gjeta poezinë”. (*“Devoll, Devoll”*)

E sa për dy ndarjet e tjera, pra Kulturore dhe Traditës, mendojmë se i kemi cekur mjaftueshëm saqë dhe përfundimi i analizës së përdorimit dhe qëndrimit ndaj tyre nga ana e Agollit, e vërteton edhe njëherë hipotezën tonë se vepra e tij, Agollit ka kahje primordialiste. Këtë e vërtetojmë gjithashtu duke marrë në shqyrtim edhe anën e kundërt të këtij qëndrimi. Tek Agolli ne i gjejmë të trija këto elemente, dhe në raste të caktuara herë spikat njëra, e herë spikat tjetra.

1.- “Se kam pirë ujë në atë lumë

Se kam marrë frymë nëpër fletë”- (*“Devoll, Devoll”*)(*kënga III*)

2.- “Shpjermëni mes shirave e erërave

Dashuria ime nuk është pozë...

*...Unë nuk hyj në **tufën** e poetëve*

Që mërzejnë aq shumë me dashurinë...”

3.-“Shqetësimet **mi ke dhënë vetë**

*Kur më bëre nga kjo **baltë e murrme***

*Ç’baltë dreqi qenka **balta jote***

***Baltë** plot trazira e shqetësime*

Herë lot e herë ëndërrime...”(po aty, kënga IV)

Në këtë pikë, ky lloj ligjërimi bën të duket se Agolli ngjet herë si primordialist e herë si konstruktivist radikal, sepse edhe fijet që i lidhin këto dy qëndrime janë të ngjashme pothuaj. Në të vërtetë pak ndryshime ka, por janë pikërisht këto ndryshime që bëjnë edhe diferencën e përcaktimit. Dhe kjo padyshim që lidhet me qëndrimin kryesor, me atë ndaj Kohës. Në këtë moment arsyetimi mbyllet këtu sepse asnjë nga këto elemente nuk gjenden tek Agolli, pra e themi me bindje se ai nuk është një konstruktivist joradikal. Gjë që nuk mund ta themi për llojin tjetër të konstruktizimit, pra atij radikal. Por tek e fundit, Agolli i bashkoi këto qëndrime në poezinë e tij, ndoshta edhe vetëm me intuitën e tij të trashëguar prej fshatari të argasur në ara dhe në luftë. Të atij individi që Koha në të vërtetë e bëri tejet pragmatist dhe si të tillë e vuri përpara alternativave të ndryshme, prej të cilave ai zgjodhi atë që mendoi se ishte ajo që e mbronte, që i krijonte mundësinë të mbijetonte, të ruante në të njëjtën kohë përcaktimin e vet identitar dhe ta shtynte veten drejt një vetpërcaktimi identitar, drejt asaj që nuk është gjë tjetër veçse Kombi. Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të gjitha ndërtimet gjuhësore të dala nga analiza e ligjëritimit të personazheve të Agollit dhe të veprimeve e ngjarjeve me të cilat ata konfirmojnë identitetin e tyre kombëtar.

Tabela 5. Ndërtimet gjuhësore përfaqësuese të identitetit kombëtar te Agolli

Emra/si emërtime	Mbiemra/si përcaktime	Folje/si veprime	Shprehje
Rrënjët/ filiz	Dhenë e lashtë	Lëvrijnë	Do ti derdhë energjitë
Motet	Legjenda të lashta	Kuvendojnë	Për t’u bërë njerëz
Gjaku/ bulëza e gjakut	Gjak i nxehtë	Valëvitet si flamuri	Në dejtë tanë gjaku juaj ecën
Vatra/ hiri i gjyshërve/ ky prak /strehëz	Vatra paqësore	Na thërret	Kjo vatër na polli
Bijtë/ Brezat	Djem pallëvetëtima	Vriteshit	Vumë eshtrat tona të bardha
Gunë	Lesh velenxash/ Trajstë leshi	U vënë shpatullat	Kryengritës që i kishte shpallur luftë botës së madhe
Grusht toke ara/male	Baltë e murrme/ Bujk i madhërishëm	Do ta kornin	<u>Çani tokën me plugje</u>
Biri yt/ birin tënd	Djersën e ndershme	Valëvitet si flamuri	Na bëtë burra
Nënë/ nënokja e maleve/ loke	Fustanellë e shqyer/ e bukur krenare,	Ju na mëkoni	O hallemadhja me parmendë, pallë e bajrak/ mbështetur në prehrin tënd
Tjetri / armiqhtë/ i huaji	i egër/ i zi	Mërzejnë	Tu hodhën tu derdhën cakejtë
Zakonet	Të trashëguara	Mbartin traditën	Matin shpirtin tend

4.9 Aspekte të ligjërimit tradicional në veprën e Dritëro Agollit

Ligjërimi popullor është karakteristikë në të gjithë veprën e Dritëro Agollit dhe këtë e kemi përmendur disa herë gjatë punimit si për të vërtetuar tezën tonë që Agolli është dhe mbetet primordialist. Rrëfimi i Dritëro Agollit psh në romanin *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo”*, dhe jo vetëm, vjen me një gjuhë thellësisht popullore, fare pranë masës së gjerë të lexuesve. Në përgjithësi karakteri popullor i krijimtarisë së Agollit është vënë re nga pjesa më e madhe e studiuesve, por në këtë vepër ai është shumë më i ndjeshëm. Leksiku i përdorur prej tij është një ndër elementët më thelbësorë që përcakton ngjyrimin popullor të ligjërimit. Leksikologu i shquar, Akademik Jani Thomai, bën një klasifikim në vija të trasha të shtresave, klasave apo grupeve leksikore më të rëndomta në këtë vepër:

1. *Fjalë të leksikut popullor*

2. *Fjalë me burim nga turqishtja, arabishtja e persishtja, që kanë hyrë prej kohësh në leksikun popullor të shqipes*

3. *Njësi frazeologjike, fjalë të urta e proverba, që, në të vërtetë, nuk janë mjete karakteristike për gjininë e poezisë*

4. *Disa mënyra popullore të thëni, që të futin në mjedise popullore*

5. *“Disa krahasime me sende e modele popullore”. (Thomai. 2012:116)*

Ligjërimi popullor i Dritëro Agollit ka trajta sa kombëtare aq edhe dialektore. Në rrafshin dialektor, Agolli mbetet i lidhur ngushtë me zonën e Korçës, në veçanti me të folurën e zonës së Devollit, nga ku ka edhe origjinën përmes së cilës u formësua identiteti i tij. Kjo e

bën edhe më të fortë lidhjen e tij dhe të personazheve të tij me traditën, sa personale e familjare aq dhe kombëtare. Në prozën e tij në përgjithësi, por në romanin psh *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”* në veçanti, ndikimi i këtij ligjërimi është tepër i ndjeshëm, pothuaj të gjithë personazhet përdorin këtë lloj ligjërimi dhe të gjitha trajtat gjuhësore që rrjedhin prej tij. Dialektologu i mirënjohur, Gjovalin Shkurtaç vëren se *“treva e Devollit paraqet interes të madh gjuhësor. Devolli është një krahinë me një folklor të pasur, gjë që dëshmon ndjeshmërinë e lartë të këtij populli. Leksiku, frazeologjia dhe fjalët e urta të asaj krahine, bashkë me toponiminë e saj të larmishme përbënin pa dyshim vlera të kulturës popullore dhe të gjuhës shqipe, me të cilat Dritëroji jo vetëm u ushqye, por edhe mbeti përjetësisht i lidhur e nuk rreshti asnjëherë së qëmtuari e së përzgjedhuri si bleta në lulet e pranverës”*. (Shkurtaç. 2012: 18).

Në lidhje me rolin e madh të gjuhës si mjet jo vetëm për realizimin e veprës letrare, por edhe për krijimin e profilit artistik, vetë Agolli shpalos parimin e tij themelor që shkrimtari të mos e thajë gjuhën, por ta mbajë atë *“me lëng si një pjeshkë”* dhe bindjen e tij se *“lëngu vjen nga gjuha e popullit”*. Ai gëzohet që *“sa vjen dhe më afër gjuhës së popullit po shkon gjuha e shkruar letrare”*. (Agolli.1986:10).

Po tu hedhim një sy fjalëve të përdorura nga poeti, që gjatë analizës i kemi përzgjedhur me të zeza, bien në sy ato që e pozicionojnë menjëherë Agollin si përfaqësues të primordializmit. **Rrënjët, brezat, unë, motet, epoka, lëvrijnë, lumë, dhenë e lashtë, gjaku, vatra, njeriu,** të gjitha këto flasin për këtë lidhje të qëndrueshme të thellë. Personazhi i bariut me gunë e velenxë, i bujkut me qe’ e parmendë që punon e mbjell tokën e të parëve, personazhi i babait, i skicuar me çibuk dhe lopatë, me rakinë e arën, me djersën dhe

vëmendjen ndaj lajmeve, me dëshirën për të mësuar çdo ditë, me dashurinë për çdo gjë, por edhe me ndjenjën e krenarisë që ushqen dhe përcjell tek nipërit si pasardhës të denjë, nuk bën gjë tjetër veçse na vë përpara traditës të cilën kësisoj na e zbulon Agolli. Siç vëren edhe studiuesi Shaban Sinani: *“Dritëro Agolli bashkoi vlerat më të bukura të letërsisë tradicionale me nevojat e poezisë shqipe për modernizim e mjeshtëri. Ai afirmoi poemën lirike/epike”*. (Sinani.2012 :269).

Toponimia dhe onomastika janë elementë shumë të rëndësishëm në formësimin e identitetit kombëtar, kjo si një prej metodave të analizës së ligjërit kur flet për prejardhjen dhe ndryshimet e fjalëve në një gjuhë. Kjo vihet re sidomos në romanin *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*. Ngjarjet zhvillohen sa në Tiranë aq edhe në ndonjë fshat të emërtuar nga shkrimtari si psh Qershizë. Një emër që nuk ekziston, por tipikisht i rrjedhur nga mënyrat e fjalëformimit onomastik shqiptar. Është emri i një fruti me prapashtesën zvogëluese me ngjyrim përkëdhelës -zë dhe -ëz (si Qershizë, Lajthizë, Pjeshkëz, Arrëz). Por elementi onomastik është edhe më i rëndësishëm, qoftë emërtimi i personazheve, qoftë paraqitja e tyre me trajtën e shkurtuar. Zylyftar Kamberi (shoku Zylo), Adem Adashi (Demka), Shemshedini, Miço Karapataqi, Zaim Avazi e të tjerë personazhe duket sikur e marrin ngjyrimin emocional që në emërtimin e tyre dhe kjo ishte edhe një ndër karakteristikat e letërsisë së realizmit socialist: Heronjtë duhet të kishin emra të bukur, antiheronjtë emra qesharakë dhe personazhet negativë me emra të shëmtuar. Element mjaft i rëndësishëm në ligjërimin që përmban vepra e Agollit është përdorimi i fjalëve të huaja, turqizmat. Fjalë si: xhephane, xhenazja, gjyrylidi, haber, hejvallah, allah belaversen etj, për heronjtë e tij jo vetëm që janë mbetje nga të cilat ata nuk shpëtojnë dot, por mbartin edhe një lloj

trashëgimie nga të parët, përforcuar kjo dhe nga gjuha e pushtuesit të hershëm të shqiptarëve.

4.10 Variacione të shfaqjes së elementëve primordialë te Dritëro Agolli.

(Në vend të një epilogu).

“Ndërgjegja kombëtare është një nga faktorët kryesorë për formimin e ndërgjegjes poetike të një populli në një etape të caktuar historike. Edhe kjo ndërgjegje poetike e stabilizuar nuk është e ngurtë por historikisht ndryshe, duke e avancuar kompleksin e mjeteve shprehëse dhe duke shfrytëzuar në mënyrë krijuese përvojat letrare të popujve të tjerë. Më qartë se në të gjithë artet e kultivuara ndërgjegja poetike kombëtare duket në folklor. Ndërgjegja kombëtare e shkrimtarit shprehet edhe në lidhjen e tij, me popullin e vet, me historinë e tij, me problemet që shtron koha dhe realiteti bashkëkohor”. (Agolli, 1980:20). E thënë kështu, na lind vetvetiu të arsyetojmë se, kush më mirë se folklori, elemente që rrjedhin prej tij, mund ta shprehë primordializmin, aq më tepër në veprën e Dritëro Agollit, e cila duket sikur ka lindur nga balta mëmë. Të tre heronjtë kryesorë, vdesin në fund për të mbrojtur idealin e tyre, për të legjitimuar identitetin kombëtar, duke përmbushur kështu një mision sa heroik aq edhe kombëtar dhe ideologjik. Secili prej tyre ka një vdekje primordiale, ku këto elemente (primordialë) janë mjaft të dukshëm.

1. “Busti hyri në mes të fshatit, ku ngrihej një gur i madh, i kuqërremtë, një gur i vjetër dhe i fortë si graniti. Atëherë rreth këtij **guri** u mblodhën të gjithë për të parë Memon. Ata e preknin bustin me gishtat e vrarë, i preknin sytë, vetullat, buzët dhe gjoksin, si për t’u bindur që ishte Memoja. Njëri prej tyre u përmallua shumë dhe vuri në atë gur **draprin** e tij

dhe **një tufë kallinj gruri** dhe tha: -Eshtë kohë **bereqeti**, le të rrinë ky drapër dhe këta kallinj gruri pranë Memos se që thoni ju, Memoja e donte edhe draprin edhe grurin.

Të tjerët bënë me kokë.

-Mirë thua, ashtu është!

Dhe qëndroi busti i bronzit në **gurin e madh**". (Agolli, 1970:302).

2.Zëri i saj oshëtiu në luginën e lumit mes mbrëmjes së lagët të vjeshtës së zyrtë. Të dy qetë ngritën përpyetë brirët dhe tundën kokat si dy murgj me pelerina.

-Xhelo të vranë!- ulëriu Hatixheja.

Xhelo Marës iu morën këmbët përpara **qeve**. Vështroi nga **hendeku** dhe tha me zë të mekur e të ngadaltë:

-C'ju kam bërë, o njerëz!

Ra Xhelo Mara mbi **zgjedhë** mes dy kokave të qeve. ...**Kau** i zi i ngrinte brirët nga njëra anë dhe kau i kuq nga ana tjetër. Xhelo Mara me kokë të varur mbi zgjedhë qëndronte në mes tyre". (Agolli,1985:326).

3."Në këtë kohë fërshëlleu një predhë dhe plasi para tytës së topit. Mato Gruda mbuloi fytyrën me krah. Por ai diçka ndjeu në gjoks. U kollit dhe iu morën mendtë. E zuri grykën e topit me dorë. U mbajt pas tij, hodhi dy hapa drejt Zigurit e ra. Ziguri u derdh mbi **të atin** i frikësuar.

-Baba! Baba!- thirri dhe e shkundi pas jakës së xhaketës. Mato Gruda ishte shtrirë nën dëllinjën e kaltër dhe gjaku i rridhte nga gjoksi.

-Zigur ... bir, vëmë një gur nën kokë! -tha ai ngadalë.

Ziguri i dëshpëruar gati më të qarë mori një gur. Pastaj zhveshi xhaketën e tij prej shajaku, e mbuloi gurin duke e bërë si jastëk dhe ia vuri të atit nën kokë”. (Agolli, 246:1975).

Siç mund të vihet re, në fund të romaneve, të tre heronjtë vriten për kauzën e tyre, për të mbajtur lart identitetin kombëtar, i cili nuk u kurseu as jetën. Fjalët me të zeza janë thellësisht primordiale dhe tipike për një ligjërim me nota të theksuara nacionaliste, të cilat edhe vërtetojnë katërcipërisht tezën tonë se Agolli dhe vepra e tij e legjitimon identitetin kombëtar përmes vlerave primordialiste më tepër sesa modernizmit.

Nëse do të bënim një statistikë të thjeshtë të rasteve të përdorimit të variablave që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar, në ligjërimin poetik e letrar të Agollit, themi që këto raste të shfaqjes së tyre janë të shumtë. Kjo, jo vetëm për të vërtetuar hipotezën tonë, se Agolli është thellësisht primordial në çfarë krijon dhe shkruan por, edhe sepse ka pak gjasë të thuash nëse ai shfaqet më tepër primordial në poezi apo në prozë. Si shpjegim i kësaj themi që, çdo temë e cila zë vend në krijimtarinë e Agollit si dashuria, motivi filozofik apo çfarëdolloj teme tjetër, ngërthen në vetvete frymë nga identiteti kombëtar, ose në rastin më të mirë, është e lidhur kryekëput me të. Si një zot i tokës dhe i vendit të vet, stili i Agollit e kërkon dhe e shpreh kudo identitetin kombëtar, duke mos e shkëputur atë nga filozofia njerëzore e jetësore përmes së cilës formësohen heronj që mbartin peshën e identitetit kombëtar dhe luftojnë për këtë mision të tyre. Nëse do ta shprehnim lidhjen e personazheve të Agollit me

veprat e tij dhe me dendurinë e shfaqjes së variableve primordialë në to, do të kishim këtë tabelë:

Tabela 6. Denduria e përsëritjes së variablave primordialë në veprat e Dritëro Agollit.

Variabli	Variabli sinonimik	Vepra							
		Denduria e shfaqjes							
		Në rrugë dolla	Hapat e mia në asfalt	Mesditë	Njeriu me top	Dështaku	Komisari Memo	Nënë Shqipëri	Baba-llarët
Familja	Nëna, babai, stërgjyshëri, fisi, gjiri, gjaku, djepi, baballarë, prindërore, vëllai, biri	43 raste	61 raste	44 raste	73 raste	68 raste	72 raste	51 raste	49 raste
Toka meme	Arë, lisave, burimi, ugari, baltë, qetë, bujq, lëndinë, koriye, fshat, plisi	54 raste	34 raste	40 raste	94 raste	106 raste	80 raste	48 raste	38 raste
Shtëpia	Kulm, zjarr, tym, vatër, oxhak, pragu, avlli, oborri, oxhaku,	24 raste	37 raste	30 raste	66 raste	89 raste	61 raste	36 raste	30 raste
Gjuha, miti dhe simbolet	Gjuha, flamuri, shqiponja, penë, pushkë, rakia, heroi, lapidari	21 raste	19 raste	26 raste	31 raste	16 raste	43 raste	38 raste	25 raste

Në bazë të elementeve dhe strukturës ligjërimore, shpjegojmë tabelën duke hyrë më në brendësi të analizës, e cila në fakt na jep dhe përgjigjen për pyetjen tonë të tretë kërkimore se: Cilat janë fjalët që përdoren më dendur në ligjërim për të shprehur identitetin kombëtar? Kështu, për të arritur në këtë tabelë dhe për të marrë këto variabla kemi përdorur tekniken e analizës së përmbajtjes dhe teorinë e lidhjes dhe bashkëshoqërimit të fjalëve në bazë të kuptimit sinonimik. *“Fjalët lidhen midis tyre për motive të ndryshme:*

- për tipare të përbashkëta kuptimore

- për solidaritet semantik (kur fjalët përfshihen reciprokisht në fjali)

- për ndonjë karakteristikë të përbashkët kuptimore

- për raporte të bazuara mbi shoqërime idesh

- për një përdorim të ndryshëm simbolik në një kontekst të caktuar socio-kulturor”.

(Ballhysa & Boci, 2002:33).

Duke ditur që, analiza e përmbajtjes fokusohet tek prania e fjalëve (shprehjeve apo koncepteve) në një tekst dhe përpiqet të nxjerrë kuptimin e tyre dhe marrëdhëniet që kanë me njëra tjetrën, atëherë, bindemi se fjalët dhe shprehjet që përdoren më shumë janë ato që duhet të kenë dhe domethënien më të madhe, në rastin tone janë fjalët që lidhen me identitetin kombëtar.

Sipas kësaj logjike, të gjitha këto pika të cituara na shërbejnë për të përpunuar fjalët e marra gjatë analizës dhe të nxjerra në këtë tabelë. Psh fjalët: *nëna, babai, stërgjyshërit, fisi, gjiri, gjaku, djepi, baballarë, prindërore, vëllai, biri* janë variabla sinonimikë të variablit *familja* si element primordial i përdorur në pothuaj të gjitha veprat e Agollit të marra në analizë. Ky

variabël është një fjalë që bart peshë sa leksikore aq dhe emocionale në ligjërimin letrar, e thënë nga personazhet e veprave për të nxjerrë në pah identitetin e tyre kombëtar, por edhe që shërbejnë si sfondi për plotësimin e ngjarjeve dhe situatave në të cilat përfshihen këto personazhe. Ky variabël, dhe të gjithë variablat e tjerë bashkëlidhur me të, lidhen me kontekstin socio-kulturor të krijimit dhe ruajtjes së identitetit kombëtar, përforcojnë lidhjen e thellë primordiale të njerëzve të Agollit me familjen si tipar të trashëgimisë dhe të vazhdimësisë përmes së cilës kalon dhe lidhja me kombin e vet dhe kësisoj dhe me identitetin e vet kombëtar. Lidhja e këtyre variablave tregon edhe solidaritet semantik, sepse këto fjalë përfshihen në mënyrë reciproke me njëra tjetrën në fjali duke formuar paragrafë që përfshihen gjithashtu brenda një konteksti ligjërimor të caktuar, që në rastin tonë ka lidhje me identitetin kombëtar.

Në këtë linjë do të përfshinim dhe variablin *Shtëpia* i cili, i lidhur me variablat sinonimikë përkatës: *sulm, zjarr, tym, vatër, oxhak, pragu, avlli, oborri, oxhaku* përbën lidhjen e fortë që ka njeriu me atë që është thelbësisht primordiale: familjen. Aty ku ngjizen ndjenja të forta të dashurisë për njerëzit, gjakun, kombin tokën tënde etj. Personazhet e Agollit jo vetëm që e shfaqin këtë por edhe luftojnë për të mbajtur të fortë këtë lidhje.

Ndërsa për variablin *Toka mëmë*, variablat sinonimikë me të cilët përforcohet kuptimi semantik dhe ligjërimor janë *arë, lisave, burimi, ugari, baltë, qetë, bujq, lëndinë, koriye, fshat, plisi* dhe fakti që kanë denduri përdorimi në veprat përfaqësuese, e shprehur në ligjërimin e personazheve, tregon se Toka që rrit dhe u jep jetë gjithçkaje në këtë botë është baza nga ku nis, merr jetë dhe legjitimohet identiteti personal dhe kombëtar i personazheve të Agollit. Lidhja semantike e kësaj fjale kryesisht me mbiemra tregon cilesitë kombëtare që

i mvishen asaj, ndërsa lidhja me foljet dhe grupet foljore i jep identitetit frymën kolektive të lëvizjes.

Po ashtu, variabli *gjuha, miti dhe simbolet* është i shprehur në tabelë me variablat sinonimikë *gjuha, flamuri, shqiponja, penë, pushkë, rakia, heroi, lapidari* sepse gjatë ligjërimit të përdorur, por dhe gjatë analizës në përgjithësi këto elementë ligjërimesorë bashkëshoqërojnë në çdo situatë lidhjen e personazheve me tipare tradicionale, shprehin identitetin kombëtar (të shqiptarëve) në rrafshin primordial (etnosimbolik) që është dhe thelbi teorik e historik i të gjithë punimit tonë. Madje, kjo është dhe arsyeja që në romanin Dështaku, ky variabël dhe variablat sinonimikë që e plotësojnë atë na shfaqet në 106 raste, por jo më pak edhe në veprat e tjera të marra në analizë.

Si përfundim të të gjithë këtij punimi, në bazë të këtyre konstatimeve dhe sidomos rezultateve të analizës të nxjerra nga kjo tabelë për çdo variabël që shfaqet në veprat përfaqësuese të Agollit të marra në analizë, themi se, procesi i identifikimit kombëtar është përfshirës dhe përjashtues. Identiteti kombëtar vjen e ravijëzohet në çdo bisedë, debat apo kontekst ligjërimesor por arrijmë të përcaktojmë gjithashtu se nuk ka një prerje me thikë nëse identiteti kombëtar dhe elementet promordiale të tij shfaqen më tepër në poezinë apo prozën e Agollit për disa arsye:

1. Në poezi kërkohet përzgjedhje stilistike e fjalës dhe jo përsëritje e saj, por edhe kur ndodh kjo bëhet përsëri vetëm për efekt stilistik.
2. Proza, nga vetë natyra e saj e rrëfimit, është më voluminoze dhe për pasojë edhe përsëritja e variablave primordiale është më e dukshme.

3. Kjo përsëritje në prozë nuk përcakton thelbësisht faktin nëse identiteti kombëtar shfaqet më tepër në këtë lloj letrar.

KAPITULLI V. KONKLUZIONE

Dritëro Agolli është autori i realizmit socialist që kapërceu metodën krijuese së cilës i përkiste, që kapërceu gjithashtu edhe kufizimin ideologjik të cilit gjithashtu i përkiste. Në letërsinë shqipe padyshim mbetet një shkrimtar i shquar. Heronjtë e tij jetojnë dhe mbartin me vete duke na e përcjellë edhe në identitetin tonë kombëtar, luftën për ruajtjen e tij, shenjtërinë e tij përmes emocioneve. Heronjtë e tij, e shprehin apo jo, ashtu të thjeshtë e modestë, në çdo përçapje të tyre janë të prirur drejt krijimit të një lloj vetveteje dhe egoje themelore, përherë në përballje dhe në konflikt me shumëçka duke vërtetuar atë që autori ka thënë se heronjtë e tij janë kokëshkretë, janë “*njerëz të krisur*”, në kërkim të gjithçkaje autentike, primordiale e kombëtare duke formësuar kështu një pjesëz që fle thellë në subkoshiençen e tyre dhe që është identiteti kombëtar, dashuria për atë që është e jona, e të parëve, e brezave.

“Në një botë të ekonomisë transkombëtare dhe të komunikimeve masive, konflikti etnik dhe nacionalizmi janë forca të rëndësishme politike të kohëve të fundit. A do t’a kapërcejë nacionalizmin kultura globale? Në fakt, revolucioni i modernitetit i ka ringjallur kujtimet dhe bashkësitë etnike, sepse njerëzit kërkojnë qëndrueshmëri dhe kuptim në erën e ndryshimeve të papara dhe kthehen tek trashëgimite e tyre etnike”. (Smith. 2008:56). Nisur nga ky reflektim që bën Smith, mund të themi se ajo pjesë e vetëdijes sociale, kulturore e shpirtërore, që e bën çdo njeri të përligjë ekzistencën e vet është identiteti kombëtar, i konfiguruar në çdo qelizë të kësaj vetëdijeje. E nëse për çdokënd kjo mund të tingëllojë paksa e tepruar, për Agollin, kjo është një pjesëz e asaj që ai e quan dalje nga rrënjet e tua dhe identifikim përballë të huajve.

Çështja e identitetit kombëtar është një çështje e rëndësishme. Ajo ka qenë e tillë në rrjedha të historisë gjithmonë, por edhe në kohët moderne, kur shteti është i konsoliduar përmes strukturave të tij, ajo përsëri zë kreun e vendit për nga rëndësia dhe roli që luan në jetën e shqiptarëve. Ky punim ishte një qasje e ndërthurur mes teorive të nacionalizmit, ligjërimeve nacionaliste dhe analizës kritike të ligjërimit, përmes të cilave shpjegohet konteksti ligjërimor por edhe ai social në të cilin jetojnë dhe bashkëveprojnë personazhet e Agollit duke formuar kornizën e tyre identitare.

Identiteti (kombëtar) është një variabël i cili merret prej studimeve sociologjike apo antropologjike, dhe risillet në letërsi, pra në studimet e kultures, për të shpjeguar mënyrën se si mund të bashkëveprojnë konteksti letrar me atë social. Duke qenë kështu, pyetja kërkimore bazë ishte se çfarë vendi zë dhe si krijohet identiteti kombëtar me anë të ligjërimit dhe ligjërimeve nacionaliste, duke gjetur dhe analizuar veçori e tipare gjuhësore që personazhet mbartin dhe transmetojnë, duke krijuar kështu identitetin e tyre kombëtar dhe duke e kaluar tashmë në rrafshin letrar tek i cili ky identitet rindërtohet. Duke analizuar 11 veprat kryesore në të cilat del identiteti kombëtar, vërtetua hipotezën tonë themelore që vepra e Dritëro Agollit e rindërton identitetin kombëtar dhe konfirmon ekzistencën e qenies shqiptare përmes riprodhimit të vlerave primordiale si toka, balta, gjaku, miti etj. Gjatë gjithë kohës letrare, del se Agolli i ka përshkruar personazhet e tij me tipare kombëtare sa biologjike aq dhe sociologjike.

Identiteti kombëtar shqiptar i parë në fokus të veprave të Dritëro Agollit karakterizohet nga një sërë tiparesh të rëndësishme: Primordializmi më së shumti, por dhe konstruktivizmi në jetën shqiptare dhe në veprën e Agollit mund të konsiderohen lirisht si pjesë e qëndrimit

evropian rreth këtij përcaktimi, sepse të dyja qëndrimet kanë ngjashmëri e ndryshime të njëjta me ndryshimet e ngjashmëritë e realitetet identitare joshqiptare. Kjo do të thotë që edhe zhvillimi identitar shqiptar ka ecur në gjurmë të njohura më parë nga evropianët. Ndryshimet që u hasën më së shumti në kohën e vendosjes së sistemit komunist, nisën si një trajtë ideologjie, dhe kjo perben atë që quhet ligjerimi ideologjik që çoi në transformime, ndonëse jo të konsumuara për shkak të faktorit kohë. Si pasojë, në hapësirën shqiptare, përmes personazheve të Dritero Agollit, lëvrojnë dy qëndrimet, të cilat për shkak të kësaj mbivendosje kohore sjellin:

1. Karakteristika gati të njëjta;
2. Heterogjenitetin e sapo dukshëm dhe që mbeti në tentativë zhvillimi të mëtejshëm.

Për shkak të kushteve specifike historike të personazheve dhe të situatave që krijojnë ligjërime dhe veprimi i tyre, këto dy qëndrime na paraqiten me tipare të përbashkëta hera –herës në nivel: 1. historik, 2. kulturor, 3. tradite, 4. besimi 5. gjuhësor. Megjithatë duhet të theksohet se, edhe pse kemi ngjashmëri, funksioni, është i ndryshëm pasi këto përpiqen të zbërthejnë proceset e ndërtimit të identiteteve kombëtare dhe individuale me një finale të respektueshme që është vetëm identiteti kombëtar dhe krijimi i kombeve- shtete. Në raport me veprën e Dritero Agollit ne konstatojmë që ajo ka një kahje më të dukshme drejt primordializmit sepse në të gjejmë mishërimin e elementeve primordialë sikur mund të përmendim:

- Tregon rolin e njërit apo tjetrit në raport me vendimmarrjet politike

- Evokon një qëndrim nacionalist e në të njëjtën kohë sqaron edhe terminologjinë përkatëse
- Evokon të shkuarën, për aq sa na shërben për të kuptuar ecurinë e personazhit.
- Vendos një raport të drejtë me të vërtetën ku e shkuara merret në konsideratë
- Trajtohet raporti mes Primordializmit dhe Konstruktivizmit si një proces zinxhir shkakësie.

Ideologjia është një element i pranishëm në përcaktimin e identitetit kombëtar tek personazhet e Agollit. Ajo është e lidhur me legjitimimin e identitetit personal të cdo personazhi dhe bëhet përcaktuese në etapa të caktuara historike. Ideologjia në rastin e heroit shqiptar agollian nuk ka qenë faktor deciziv. Ajo ka qenë më shumë një zgjedhje artificiale dhe e përkohshme. Veprimi i saj në jetën sociale të kohës e inicuar thjesht nga interesa të ngushta për pushtet absolut, e përjashton atë në kontekstin më të gjerë kohor të formimit të identitetit kombëtar. Nuk mund të lemë pa përmendur se kjo ka ndodhur nën kushtet e një presioni të fuqishëm nga ana e pushtetit e shprehur përmes ligjerimit nacionalist ideologjik, por format e ngurta të trashëguara nga shekujt, ku edhe genet luajnë rolin e tyre të padiskutueshëm, nuk ia dhanë asaj këtë mundësi, që të bëhet faktor.

Edhe në këtë pikë, vepra e Agollit dallohet, sepse përtej skematizmit të imponuar një sy i vëmendshëm mund të dallojë elemente jokonformiste me pushtetin, të cilit si për paradoks ai edhe i shërbente! Për të mos folur pastaj për vepra ku personazhet dalin pothuaj hapur sikur është rasti i Shokut Zylo. Ky korrelacion fjalësh të padukshme dhe tejet të hershme na bën të mendojmë (dhe bashkë me ne edhe personazhet e Agollit), se jemi ata që dëshirojmë

të jemi në formën e një AND-je kujtimesh e kufijsh biologjikë po aq sa jemi ata që të tjerët dëshirojnë të jemi, po aq sa jemi ata që do të dëshironim të ishim.

Kuadri analitik ku u bazua analiza e punimit ishte një ndërthurje racionale mes teorive letrare që merren me analizen e veprës letrare dhe lidhjen e saj me elemente jashtelettrare si mjedisi social dhe kushtet historike. Ka shumë teori rreth problemeve të nacionalitetit dhe të identitetit kombëtar, por Teoria e ligjërimeve nacionaliste e cila eksploron dukurinë e nacionalitetit që nga rrënjët deri tek lidhjet me romantizmin, liberalizmin, marksizmin, islamin etj, jep përgjigje për proceset në vazhdim të krijimit të kombeve e të identiteteve kombëtare, sikur jep shpjegim për mekanizmat e veprimit të këtij procesi të ndërlikuar, ku ndërthuren interesa shumëplanëshe. Është një teori në të cilën referohen edhe teoricienët e çështjeve nacionale, edhe politikëbërësit, edhe studiuesit e analizës kritike të ligjërimit, po ashtu edhe lexuesi i thjeshtë.

Për shkak të interesave të ngushta të lidhjeve të ligjërimit me pushtetin, ka një shumësi debatesh rreth identitetit kombëtar, krizës së tij, krijimit e rikrijimit të kombeve, po qartësisht të grupuara. Metoda që mori përsipër të analizojë dukjen e identitetit kombëtar në veprën e Dritëro Agollit, ishte analiza kritike e ligjërimit e cila fokusin kryesor të saj e ka ta shohë ligjërimin jo më në aspektin gjuhësor por në lidhjen e tij me dukuri jashtëgjuhesore. Bazuar në konstatimin e marrë prej teorisë së James Paul Gee në lidhje me misionet ndërtuese të gjuhës, punimi ynë u fokusua në gjashtë prej tyre që janë: Rëndësia, Praktikën, Identitetet, Marrëdhëniet, Politikën dhe Lidhjet (ndërlidhjet), të cilat shoqërohen me pyetjen specifike përkatëse, që iu përshtatën zgjidhjes së hipotezës dhe pyetjeve kërkimore, duke i ardhur kështu në ndihmë të gjithë analizës së punimit tonë.

Kështu tekstet letrare të veprës së Dritëro Agollit në këtë punim janë analizuar duke përdorur koncepte të ndryshme të kritikës bashkëkohore të Analizës Kritike të Ligjërimit (Analiza kritike e ligjërimit u referohet një sërë qasjesh që janë të lidhura shumë me ç'ka u takon themeluesve të saj si Norman Fairclough, Ruth Wodak, Teun Van Dijk dhe Theo Van Leeuwen) kritika formaliste, kritika strukturaliste, qasjes sociolinguistike (Metodologjia e përdorur rrjedh nga një model akademik i cili është i përkufizuar dhe shpjeguar, e që bazohet kryesisht në modelin e Teun Van Dijk e njohur si qasja socio-konjitive me një fokus të përbërë nga elemente të diskursit, perceptimit dhe shoqërisë që shërbejnë si mjet për krijimin e fenomeneve të realitetit shoqëror.

Në këtë kontekst, diskursi mund të kuptohet si një eveniment komunikativ ku përfaqësimet sociale kanë një rol vendimtar), dhe qasja historike, e cila ka të bëjë me shtrirjen në kohë, ku përfshihen faktet historike, e përfaqësuar nga Ruth Wodak e cila nëse flet për një qasje ligjërimore që ka në themel të analizës makrostrukturat që lidhen me ligjërimin në një kontekst të caktuar social dhe historik, prej saj kemi huazuar pikërisht përfaqësimin tematike dhe kuptimin e një ligjërimi specifik siç në rastin tonë është ligjërimi mbi identitetin kombëtar apo ligjërimi nacionalist.

Për analizën e tabelës së variablave primordiale (gjuhësore) gjatë kritikës letrare dhe analizës së përmbajtjes u mbështetëm në një qasje shkencore të hartuar nga Timothy Stephen. Duhet theksuar se gjatë kësaj analize kemi marrë në shqyrtim njësi të vogla ligjërimi, pra segmente ligjërimi, (fjalë, fjali dhe shprehje) të cilat na shërbyen për të sqaruar mënyrën sesi ndërtohen identitetet (kombëtare) në letërsi.

Ligjërimi i personazheve dhe gjuha e përdorur prej tyre, na vërtetoi se dhuna është një element që e shoqëron krijimin e identitetit kombëtar dhe kjo bëhet më e dukshme në atë që ne e kemi cilësuar si identitet i përhershëm. Jo gjithmonë fajtorët janë fitimtarët e luftërave në humbjen e identitetit kombëtar. Kjo formë e ligjërimit tregon se ky është një fakt historik tek i cili referohemi sa herë që identiteti kombëtar është në rrezik.

Ligjërimi ideologjik e vret heroin e atëherë ky hero jeton aq sa jeton ideologjia që e lindi. Ndërkohë është kërkesë imperative dhe ligjërimore që shkrimtari, hero i të ketë lirinë e fjalës. Në kushtet e krijimtarisë së Agollit, heronjtë e tij jo të gjithë mbijetojnë. Pavarësisht se si shfaqet personazhi në vepër (vëllimor, dinamik, hero mitik, hero, superhero), në veprën e Agollit ai vepron si i tillë, si hero, i shndërruar në shërbim të ideologjisë, por me një shtrat- dhe këtë e theksojmë fort!- me një shtrat të sigurt nacionalizmi ku në asnjë rast lidhjet me të nuk rezultojnë të humbura- dhe kjo është edhe arsyeja se përse personazhet ideologjikë të Agollit kanë mbijetuar. Ata dolën nga korniza ideologjike dhe zhvilluan jetën e tyre, jetuan në dy realitete, në atë të imponuarin, të jashtmin, dhe realitetin e tyre të brendshëm, ashtin, boshtin që i mbajti të tillë, sepse ditën të shprehen dhe të kërkojnë. Merita e autorit dhe e procedesë së tij ligjërimore, veç të tjerash, nuk është se ai e krijoi me ngjyra aq të gjalla duke i dhënë një plasticitet e pasuri ngjyrash, por e dha edhe në dilemën e tij thelbësore:

1. Të ruajë qenien e tij identitare përmes ruajtjes së traditës?

2. Të ndryshojë qenien e tij identitare duke i dhënë më shumë hapësirë ideologjizimit nacional?

Heronjtë e Agollit nga ana tjetër përcjellin një vitalitet të jashtëzakonshëm identitar dhe kanë arritur të venë në balancë kërkesat për një hero idologjik, Njeriu i Ri, me heroin e vërtetë që mbart elementet bazë të qëndrimit primordial sikur janë heroi historik, tradicional, i trashëguar. Sjellja e këtyre elementeve në karakterin e heroit ideologjik, përmes ligjërit të tij, i jep atij pikërisht ideologjizmin e dukshëm të tyre, duke e afruar kështu Agollin, sikur e kanë vërejtur edhe studiues të tjerë (gjë që e kemi përmendur në punim), me disidencën e vërtetë. Këtë mendim e përforcojnë edhe disa faktorë:

-Heronjtë agollianë kanë identitet

-Heronjtë agollianë marrin pjesë në konfliktin nacional dhe luftojnë për të dhënë zgjidhje

-Heronjtë agollianë janë njerëz të thjeshtë, e si të tillë janë të lidhur ngushtësisht me traditën

-Heronjtë agollianë luftojnë për ruajtjen e identitetit edhe kur koha politike është e disfavorshme

-Heronjtë agollianë kanë shumë armë në përdorim po karta e fitores së tyre është Nacionalizmi. Heronjtë agollianë mbartin edhe elemente mitologjike në emër të trashëgimisë e traditës kombëtare, etnike. Këta heronj vërtetojnë edhe njëherë se kanë rol parësor në ndërtimin e identitetit kombëtar.

Prezenca e mitologjisë në ndërtimin e personazheve tek **Dritëro Agolli** vjen si një raport që ai vendos mes Kohës Universale dhe Kohës që përfaqësohet prej të shkuarës/ të ardhmes. Në raport me qëndrimin që mban ndaj elementeve shumë të rëndësishëm të Kohës, ne përftojmë një hero agollian mitik që në të njëjtën kohë është mbartësi, po aq sa inicuesi i

krijimit të identitetit. **Personazhet e Agollit** janë personazhe që në rrjedhën e kohës paraqesin përpjekje për tjetërsim të identitetit, por në thelbin e vet ata paraqiten me një identitet dhe një nacionalitet të qëndrueshëm. Ata përballojnë bukur shumëllojshmërinë e identiteteve në kohën e sotme, duke krijuar një **UNË** në shoqëri. Në të njëjtën kohë ata janë sa kombëtarë, aq edhe universalë.

SHTOJCA I.

Intervistë ekskluzive me shkrimtarin e madh DRITËRO AGOLLI

“Shkrimtarët që i tremben kritikës, venë në dyshim krijimtarinë e vet, nuk kanë besim tek krijimtaria e tyre. Shkrimtari kur e boton një vepër, apo kur boton një diskutim, nuk është më pronë e tij, por është pronë e lexuesve. Dhe lexuesi, ka të drejtë çdo gjë për atë. Nuk është pronë, që ta mbrojë medoemos ai. Fjala vjen Naim Frashëri, Fishta, Mjeda, Migjeni, Esad Mekulli, etj, nuk kanë tani shokë, kushërinj, apo dikënd që mund t’i mbrojë. Ata i mbron vetë lexuesi”. (Agolli, shtator 2015)

Më poshtë kemi një interviste ekskluzive, e cila është realizuar me shkrimtarin dhe poetin Dritëro Agolli, nga shkrimtarja, poetja dhe studiuesja Mimoza Erebara si person i autorizuar nga autori i këtij punimi doktoral për të marrë këtë intervistë.

Mimoza Erebara: Profesor përshëndetje dhe faleminderit që pranuat të na jepnit këtë intervistë.

Dritëro Agolli: Ju falenderoj juve që erdhët të më intervistoni se “... *neve pleqve na vjen mirë e na bëhet qejfi kur na sajdisin*”. (qesh).

Mimoza Erebara: Profesor, me lejoni t’ju shpjegoj se intervista jonë konsiston në një punim doktoral mbi identitetin kombëtar në veprën tuaj.

Dritëro Agolli: Ju falenderova në fillim për intervistën, por, më besoni që, kjo që sapo thatë ma shtoi më shumë gëzimin. Çdo shkrimtar ndihet mirë kur puna e tij bëhet objekt studimi e diskutimesh, qofshin këto për mirë por edhe për kritikë.

Mimoza Erebara: Sa për parantezë profesor, si mendoni, a është vepra juaj e mbarsur kaq shumë me ndjenjën e identitetit kombëtar dhe a do të ishte i vlefshëm ky studim i yni në këtë aspekt?

Dritëro Agolli: Për një poet si unë që vij nga fshati, me rrënjë nga balta dhe nga toka, që ka marrë pjesë në luftë, pra, pa të gjitha këto, pjella ime poetike nuk do të kishte asnjë vlerë. Kështu, mes njerëzve të popullit mësova të qaj, të këndoj, të festoj e të pi raki me ta por dhe të shkruaj, pse jo, duke treguar se kjo është forma më e mirë e dashurisë për tokën e të parëve. Sado të jetosh në qytete të mëdha me zhurmë e luks, prapë qetësinë e shpirtit ta jep veç era e tokës, e bukës dhe e barit.

Mimoza Erebara: Më lejoni profesor të kthehemi te letërsia. Libri juaj *“Zhurma e erërave të dikurshme”* ishte ndaluar nga diktatura komuniste, por në një panair të librit në Tiranë, u ribotua dhe u risoll përsëri? Si mendoni ju, pse u kërkua përsëri ky libër?

Dritëro Agolli: E kam thënë edhe herë të tjera, në shtypin e përditshëm dhe më tej në Shqipëri, se çdo libër, në përgjithësi, ka një histori të vetën. Ka historinë, se si ka lindur, në çfarë rrethanash, si është botuar, si është pritur etj. Libri është me një biografi si njeri dhe veçanërisht si autor i tij. Ky libër u botua në vitin 1964 por nuk doli në qarkullim, sepse u ndalua atëherë. Sipas atyre që e ndaluan, ky libër nuk paraqiste realitetin e atëhershëm socialist në mënyrë optimiste por, ishte një libër pesimist. Heronjtë dhe personazhet e librit, sipas tyre, dukeshin të mërzitur, jo luftëtarë, por njerëz me lëkundje shpirtërore dhe në përgjithësi, deheroizoheshin. Këto ishin vërejtjet që u bënë atëherë, prandaj botimi i parë, nuk doli në shtyp. Më pas, doli botimi i dytë, nga i cili u hoqën disa tregime, e pastaj doli në qarkullim, por kur doli në qarkullim, përsëri u ndalua, pas një plenumi të Komitetit Qëndror,

një vit para përpjekjeve për të dalë ky libër, u kritikua dhe më vonë u ndalua, si i tillë. Në vitin 2006, presidenti i shtëpisë botuese “Onufri”, më kërkoi që ta botoja këtë libër në shtëpinë e tij botuese, megjithëse pjesë - pjesë, ishin botuar edhe më përpara. Unë ia dhashë atij, duke e paralajmëruar se disa tregime edhe i kisha botuar, por ai nguli këmbë dhe e botoi. Unë shkrova një parathënie për këtë libër. Kishte edhe disa vlerësime të tjera nga Ismail Kadareja, dhe kur doli libri, pati sukses. Por, çdo libër e ka historinë e tij në kushte të vështira po edhe në përpjekjet e shkrimtarëve për të lëmuar sa më shumë stilin e tyre, për t’u kujdesur, që të paktën në stil, të ishin superiorë, të ishin njerëz që nuk mund t’i zinin lehtë nga ana e formës artistike. Në kohë të vështira, shkrimtarët janë përpjekur shumë për të dhënë vepra, sepse në kushte të ashpra kanë përpunuar stilin, duke përdorur edhe mjete të tjera për tu paraqitur në publik.

Mimoza Erebara: Disa nga librat tuaj nga instruktorët e komiteteve të partisë u ndaluan edhe nëpër shkolla. Pse u ndaluan dhe cfarë ndodhi pas kesaj?

Dritëro Agolli: Ishte ideologjia e kohës që për këta libra, u dhanë orientime, të mos shpërndareshin për nxënësit sepse kishin “të meta”. Nuk përhapeshin, nuk lejoheshin nxënësit që t’i blinin, dhe më vonë u hoqën edhe nga libraritë dhe mund të gjendeshin vetëm në fondet e bibliotekave. Në vitin 1987, kur unë botova një cikël me tregime, në revistën “*Nëntori*”, nga instruktorët e partisë në Tiranë dhe në rrethe, ishte dhënë udhëzimi, që këto tregime të mos u lejoheshin nxënësve. Në atë kohë, unë isha kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve (1987), por edhe kryetarit ia ndalonin librat në atë kohë. Në vitin 1964, unë isha thjesht një gazetar, që punoja në gazetën “*Zëri i popullit*”, ndërsa në vitin 1987, isha

kryetar, por edhe pse njeri me autoritet që kisha takuar personalitete të mëdha të vendit, megjithatë, nuk pyetej në atë kohë.

Mimoza Erebara: Cfarë mendimi keni për letërsinë që krijohet sot?

Dritëro Agolli: Mendoj që është një fazë e re ku ka hyrë letërsia, qoftë në Shqipëri qoftë edhe në Kosovë sepse letërsia dhe artet kanë kaluar në një fazë tjetër të re ku njerëzit shprehen me stile të ndryshme, me rryma e shkolla të ndryshme, në mënyrë që letërsia të pasurohet. Veçanërisht janë autorët e rinj që japin një kontribut të shquar në këto anë, por edhe ata që kanë krijuar në kohën e socializmit. Përsëri bashkërisht mundohen të gjejnë forma dhe mënyra të tjera të shprehjes, që veprat e tyre të shpërndahen, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në botë. Ka lëvizje të mirë letrare dhe artistike, por kjo veçanërisht është në poezi, sepse më shumë lëvrohet poezia dhe që ka mjaftë autorë, që shkruajnë me një nivel të lartë artistik. Edhe në Kosovë, vihet re që në poezi por edhe në prozën e shkurtër veçanërisht, ka një element të ri. Po hyhet edhe në disa anë të jetës së njerëzve, po jepet edhe ndjenja e dashurisë më shumë, e familjes, e peizazhit, që në kushte të veçanta, siç ishte atëherë puna e lirisë, puna e problemeve kombëtare. Atëherë, ajo justifikohet, kurse tani ka një poezi veçanërisht të mirë dhe cilësore, por edhe proza ka një konotacion të lartë dhe kështu po ecën edhe ana tjetër e një poezie më intime dhe më e lirë.

Mimoza Erebara: A mendoni se ekziston një kritikë letrare e mirëfilltë në letërsinë shqipe dhe a është ajo ashtu si duhet të jetë?

Dritëro Agolli: Me thënë të vërtetën, kritika letrare ka mbetur pas dhe nuk analizohen veprat letrare, sepse nuk jepet një mendim për to, për të treguar sesi po ecën kjo krijimtari, çfarë të reje sjell kjo krijimtari në këto 25 vjet, cilët janë personalitetet që po e lëvrojnë më

shumë të renë. Cfarë dobësish ka? Cfarë të mirash sjell? Nuk ka një kritikë të tillë. Tani janë përqendruar vetëm kur bëhen promovime librash, vetëm kur bëhen mbledhje më shumë ku nuk kritikojnë por vetëm lavdërojnë sesi po ecën kjo letërsi. Janë vetëm njerëz të veçantë, të dikurshëm, që e bëjnë e që flasin për këto problem, por fjala është për më të rinjtë, që nuk e analizojnë krijimtarinë sepse ata më shumë flasin me terma specifike dhe hedhin poshtë krijimtarinë e viteve të shkuara duke e parë në mënyrë krejtësisht bardhë e zi. Duke kritikuar sistemin e atëhershëm, e hedhin poshtë edhe prodhimtarinë letrare dhe në përgjithësi kulturën sot por kjo nuk është e drejtë, pasi letërsia dhe kultura, nuk janë të barabarta me politikën dhe ekonominë.

Mimoza Erebara: Shkrimtaria është arti dhe profesioni juaj. Cilin nga librat e vlerësoni si librin tuaj më të mirë, më të arrirë?

Dritëro Agolli: Çdo shkrimtar librat i do si prindi fëmijët e vet. E kam shprehur shpesh por, libri që ka lënë mbresë, mbetet *“Zhurma e erërave të dikurshme”*, sepse lidhet me një histori pak a shumë tragjike. Por, edhe romani *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*, i cili gjithashtu është kritikuar në atë kohë por, nuk është ndaluar. Duke qenë se romani *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*, ka bërë jehonë dhe ka lënë gjurmë edhe në vendet ku është botuar, si në Francë, Gjermani, Itali, Greqi, Rusi etj, për mua ky është një libër nga më të mirët, që kam shkruar. Përsa i përket poezisë, do të veçoj librat *“Pelegrini i vonuar”*, *“Mesditë”*, *“Udhëtoj i menduar”*, etj. Këto janë librat e mi që më kanë lënë kujtime dhe që nuk do t’i harroj kurrë për mënyrën dhe peripecitë se si janë shkruar.

Mimoza Erebara: Çfarë mendimi keni për debatin e shumëdebatuar, Qosja – Kadare, në lidhje me çështjen e identitetit kombëtar dhe kush mendoni se ka të drejtë për këtë debat?

Dritëro Agolli: Unë mendoj ashtu si edhe Rexhep Qosja, që kjo polemikë i dha rezultatet e saj, sepse u diskutua për disa probleme tepër të ndërlikuara, me gjithë përdorimin e gjuhës jo të këndshme, të atyre që ndërhyjnë në këtë polemikë dhe që ishin tepër të ashpër. Ne duhet të mësohemi të diskutojmë në mënyrë letrare dhe të mos imitojmë politikanët në debate nëpër kuvende sepse, shkrimtarët, duhet të flasin pa u nxehur, më me gjakftohtësi dhe me argumente. Unë mendoj që shkrimtarët që i tremben kritikës, venë në dyshim krijimtarinë e vet pra nuk kanë besim tek krijimtaria e tyre. Shkrimtari kur e boton një vepër, apo kur boton një diskutim, kjo nuk është më pronë e tij, por e lexuesve i cili ka të drejtë çdo gjë për atë. Poetët e ikur nuk kanë askënd që mund t'i mbrojë, sepse ata i mbron vetë lexuesi. Kështu që, shkrimtari duhet ta mendojë veten edhe pas shumë vjetësh, kur të mos ketë shokë, kur të mos ketë simpatizantë të gazetave. Atëherë atë do ta mbrojë vetëm vepra e tij. Kështu që, mendoj se duhet të ndryshojë mënyra dhe stili i polemikave tona. Por, sidoqoftë, Rexhep Qosja është një personalitet i madh i kulturës sonë i cili i ka dhënë shumë Shqipërisë dhe Kosovës, me veprën e tij. Ai është një njeri me përvojë të madhe dhe një njeri me kulturë të gjerë, personalitet, për te cilin çdo komb tjetër do të krenohet me të. Sado që të hidhet baltë mbi këto personalitete të larta të kulturës sonë, nuk kanë çka t'i bëjnë. Edhe Ismail Kadare, është një personalitet i shquar i cili nuk mund të dobësohet nga kritikët e sotëm. Të dy janë personalitete të mëdha të kulturës sonë dhe ne duhet t'i vlerësojmë duke i ngritur lart.

Mimoza Erebara: A është letërsia shqipe e denjë për ta marrë çmimin Nobel, për letërsi? A ka një emër sipas jush?

Dritëro Agolli : Po ndoshta me emra nuk mund t'i them, por besoj se ka edhe në Kosovë e në Shqipëri. Nuk ka ndonjë çudi të madhe ky çmimi "Nobel", as nuk është ndonjë gjë e pa arritshme sepse patjetër tek njëri duhet të shkojë. Këtë çmim, mund ta marrë kushdo. Sigurisht që, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë, ka shkrimtarë të mirë, për ta marrë çmimin Nobel.

Mimoza Erebara: Cfarë të veçante ka një ditë e zakonshme për juve ?

Dritëro Agolli : Dita e zakonshme si e të gjithë njerëzve. Po të isha në fshat, do të ngrihesha sapo të këndonte këndesi. Kurse tani, ngrihem kur fillojnë të bëjnë zhurmë makinat. Në vend të këndesit, janë makinat dhe njerëzit që lëvizin. Unë ngrihem, hap ndonjë libër, hedh ndonjë mendim që më ka mbetur në mendje, mbaj ndonjë shënim, shikoj nëpër shënime ato që më kanë mbetur pa i botuar dhe pa i sistemuar. Takohem me njerëz në shtëpinë time, ku më vijnë shumë miq dhe shokë dhe që çdo ditë është e mbushur plot. Bisedojmë bashkë me ndonjë gotë raki, me ndonjë kafe. Mbrëmjeve nata është më e qetë. Natën njeriu mund të mendojë sepse nuk ka shumë zhurmë, nuk ka njerëz nëpër këmbë dhe atëherë unë shkruaj ndonjë gjë, përpunoj ndonjë gjë që më ka mbetur në shkrim. Shikoj lajmet për politikën, për ekonominë e vendit, për kulturën dhe kështu e mbush ditën.

Mimoza Erebara: Pavarësisht moshës, a keni ju në projektet tuaja të sillni për lexuesin ndonjë libër të ri?

Dritëro Agolli: Eh, unë kam një libër që dua ta mbaroj por kam frike sepse ky libër është nga jeta ime, me kujtime të njerëzve që kam takuar. Është një përzierje mes jetës sime shoqërore, intime dhe politike. Besoj se është një libër i vështirë për ta shkruar por, edhe për ta botuar, sepse është i vërtetë. Për të gjithë e vërteta është lakuriq, dhe shpesh ne kemi turp

ta takojmë, t'i japim dorën. Por, megjithatë, i duhet dhënë dora dhe ta kapërcejmë atë anë të turpit. Ky është libri më i vështirë që kam nisur të shkruaj. Kam edhe shënime të ndryshme publicistikë, me intervista, me artikuj për situatën politike, shoqërore, kulturore, që janë botuar nëpër gazeta.

Mimoza Erebara: Çfarë u këshilloni shkrimtarëve të rinj që i kanë hyrë letërsisë shqipe?

Dritëro Agolli: Shkrimtarët e rinj duhet të kuptojnë dy realitete, atë të jetës ku të takojnë shumë njerëz, që të mos jenë indiferentë ndaj zhvillime të shoqërisë, të politikës, të kulturës. Sa më shumë të jenë njerëz kuriozë, active. Kjo është një gjë shumë domethënëse sepse shkrimtari nuk duhet të jetë kurrë indiferent, por duhet të jetojë me pulsën e zemrës së popullit. Duhet ta njohë mirë atë, të njohë kërkesat, të nxitë njerëzit për përparimin e shoqërisë etj. Të bëjë vepra të tilla që të mos duket si njeri që vetëm shkruan dhe bën eksperimente në krijimtari. Kurse realiteti tjetër, është realiteti i librit, sepse shkrimtari duhet të jetë gjithmonë lexuesi më i madh, të jetë në kontakt gjithmonë me zhvillimin e letërsisë së vendit, por edhe të huaj. T'i njohë mirë teknikat e reja, zhvillimin e tyre, zhvillimin e teknologjisë së re të të shkruarit por, gjithmonë në ndihmë të psikologjisë së historisë, kulturës dhe identitetit të vendit të vet.

Mimoza Erebara: Faleminderit profesor! Ju urojmë shëndet dhe pse jo akoma shpirt pelegrini për të shkruar.

Tiranë, Shtator 2015.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

1. Abazi, Xh. 1984. *Jeta dhe procesi letrar*, Naim Frashëri, Tiranë
2. Albertazzi, S. 2012. “*Belli e perdenti: antieroi e post-eroi nella narrativa contemporanea di lingua inglese*”, Armando Editore.
3. Agolli, D, 1980. *Arti dhe koha*, Naim Frashëri, Tiranë.
4. Aliu, Ali. 1990. *Ese letrare*, Naim Frashëri, Tiranë.
5. Aliu, A. 2010. “*Fenomeni Zylo në prozën e Dritëro Agollit*”, Gazeta shqiptare "Milosao", suplement. Tiranë.
6. Altermat, U. 2002. *Etnonacionalizmi në Europë*, Phoenix, Tiranë.
7. Allworth, Edward 1998, “*History and group identity in Central Asia*” from *Graham Smith et al (eds), Nation-building in the post-Soviet Borderlands: the Politics of National Identities*, Cambridge: Cambridge University Press.
8. Anderson, B.1991. *Imagined Communities*, London, New York: Verso.
9. Aristoteli, 1991. *Poetika*, Çabej, Tiranë.
10. Beaugrande, D. R. 2010 *Discourse Analysis and Literary Theory: Closing the Gap*, Journal of Advanced Composition 13, 1-25.
11. Bohr, A. 1998. *The Central Asian States as Nationalizing Regimes. The Politics of National Identities*. Cambridge: Cambridge University Press.
12. Berghe, Van den 1987. *The ethnic phenomenon*. Greenwood Press.
13. Blommaert, J. 2004. *Discourse. A critical introduction*. Cambridge, England New York: Cambridge University Press.
14. Breht, Foks, Finkelshtajn, 1982. *Studime kritike*, Naim Frashëri, Tiranë.
15. Brubaker, R. 1996. *Nationalism Reframed: Nationhood and the National Question in the New Europe*, Cambridge University Press.
16. Bullo, J. 1982. *Romani shqiptar i realizmit socialist për Luftën Nacionalçlirimtare*, Naim Frashëri, Tiranë.

17. Carr, E. H. 1961. *What is History?* New York: Penguin Books.
18. Clayer. N. 2012. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar (Lindja e një kombi me shumicë muslimane ne Evropë)*. Përpjekja.
19. Connor, Walker. 1994. *Ethnonationalism: The Quest for Understanding*. Princeton, New Jersey: Princeton University Press.
20. Cornell, S, Douglass. H, 1997. *Ethnicity and Race: Making Identities in a Changing World*, Pine Forge Press.
21. Craig C, 1997. *Nationalism*, Minneapolis: University of Minnesota Press.
22. Croce, B, 1941. *History as the Story of Liberty*, Penguin Books.
23. Çabej, E. 1994. *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, MCM, Tiranë.
24. Da Vinçi. 1999. *Mbi artin dhe shkencën*, Apollonia, Tiranë.
25. Derrida, J. 1978. *Writing and difference*. Chicago. University of Chicago.
26. Eagleton, T. 2005. *Hyrje në teorinë e letërsisë*. Tiranë, Camaj& Pipa.
27. Eco, U. 2007. *Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*. Dituria, Tiranë.
28. Emerson, R. 2002. *Esse*, Plejad, Tiranë.
29. Ermath, E. D.1991, *Sequel to History Postmodernism and the Crisis of Representational Time*. Princeton University Press; First Edition.
30. Evans, R. J. 1997. *In Defense of History*, London: Granta Books.
31. Fairclough, I., & Fairclough, N. 2012. *Political Discourse Analysis. A Method for Advanced Students*. London: Routledge.
32. Fairclough, N. 1989. *Language and Power*. London: Longman.
33. Fairclough, N. 1995. *Critical discourse analysis. The critical study of language*. London: Longman.
34. Fogelman, B. 1990. *Realizmi i ri*, Ligo, Tiranë.
35. Frojd, Z. 1999. *Leonardo Da Vinçi*, Apollonia, Tiranë.

36. From. E. 2005. *Nëntë skica psikologjike*, LP.Tiranë.
37. Galef, D.1993. *The Supporting Cast: A Study of Flat and Minor Characters*. University Park, PA: Pennsylvania State UP
38. Geary, J, Patrick. 2009. *Miti i kombeve*. Ombra GVG, Tiranë.
39. Gee, J. P. 2005. *An introduction to discourse analysis. Theory and method*. 2nd Edition. New York: Routledge.
40. Gee, P, J. 2011, *An introduction to discourse analysis. Theory and metthod*. 3th edition. New York: Routledge.
41. Geertz, Cl, *Primordial and Civic Ties*, in Hutchinson, John, Smith, Anthony
42. Gellner, Ernest. 1983. *Nations and nationalism*. Oxford, Basil Blackwell.
43. Gellner, Ernest. 1994. *Encounters with nationalism*. Oxford, Basil Blackwell.
44. Gellner,E. 1997. *Nacionalizmi*, IDK, Tiranë.
45. Gong, G. W. 1997. “*The Beginning of History: Remembering and Forgetting as Strategic Issues*,” *The Washington Quarterly*, Spring 2001 issue, Survey 16
46. Graham Smith, Vivien Law, Andrew Wilson, Annette Bohr, Edward Allworth. 1998. *Nation-Building in the Post-Soviet Borderlands: The Politics of National Identities*. Cambridge and New York: Cambridge University Press.
47. Grup autorësh 1986. (ELYAR, MAN, KALVINO, CVAJG, QEMAL, HEMINGUEJ, LORKA), *Ese dhe shkrime të tjera kritike*, Naim Frashëri, Tiranë.
48. Hearn, J. 2006. *Rethinking nationalism*. Houndmills, England: PalgraveMacmillan.
49. Hobsbawm, E. J. 1990. *Nations and Nationalisms Since 1780*, Cambridge University Press.
50. Hoking, V. S. 1997. *Një histori e shkurtër e kohës, nga Big-Bengu tek Vrimat e Zeza*, Toena, Tiranë.
51. Hutchinson, J. Smith, A. D., 1994.eds., *Nationalism*, Oxford, New York: Oxford University Press.

52. Jacques. E. J. 1995. *Shqiptarët, Kartë e Pendë*, Tiranë.
53. John M. Ellis, 1974. *The Theory of Literary Criticism. A Logical Analysis. (Teoria e kritikës letrare. Një analizë logjike)*,
54. Johnstone, B. 2002. *Discourse analysis*. Oxford: Blackwell.
55. Jorgaqi, N. 1987. *Poetika e dokumentit*, Naim Frashëri, Tiranë.
56. Kadare, I. 2011. *Mosmarrëveshja*, Onufri, Tiranë.
57. Kadare, I. 2006. *Identiteti European i Shqiptarëve*, Onufri, Tiranë.
58. Leka. F. 1972. *Fjalor shpjegues i termave të letërsisë*, Naim Frashëri, Tiranë.
59. Le Goff, J, 1992. *History and Memory*, Rendall, Steven and Claman, Elizabeth, New York: Columbia University Press.
60. Lemke, J. L. 1995. *Textual politics. Discourse and social dynamics*. London: Taylor & Francis.
61. Maalouf, A. 2006. *Identitete vrastare*, Onufri, Tiranë.
62. Martin,D.J. 1995. *Deleuze, Cinema and National Identity: Narrative Time in National Contexts*. Edinburgh University Press.
63. Mato, J. 1983. *Risi të letërsisë shqiptare të Realizmit Socialist*, Tiranë. Naim Frashëri.
64. Muhamataj. E. 1982. *Tipikja dhe tipizimi në letërsi*, Naim Frashëri, Tiranë.
65. Nikolla P, Albert.2012. *Njeriu i Ri shqiptar*, Onufri, Tiranë
66. Millosh, C, 1998. *Mendja e robëruar*, Dritëro, Tiranë.
67. Norwich, J, J,2005. *Bizanti*, Uegen, Tiranë.
68. Ozkirimli, U. 2000. *Theories of Nationalism: A Critical Introduction*, New York: St. Martin's Press.
69. Paskal, B. 2005. *Mendimet*, Plejad, Tiranë.
70. Pipa, A. 2006. *Kritika e ese 1940-1944*. Princi, Tiranë.
71. Plejad, 2005. *Temat e mëdha të futurizmit*, Plejad. Tiranë.

72. Poper, K. 2003. *Mjerimi i historicizmit*, Onufri, Tiranë.
73. Renkema, J. 2004. *Introduction to discourse studies*. Amsterdam Philadelphia: John Benjamins Pu
74. Robert d'Angely, 1991. *L'enigme...* Paris, France.
75. Schevill, F. 2002. *Ballkani, historia dhe qytetërimi*, Uegen, Tiranë.
76. Schiffrin, D. 1993. *Approaches to discourse*. Oxford: Blackwell.
77. Sen.K.A. 2006. *Identiteti dhe dhuna- iluzioni i fatit*, ISHM, Tiranë.
78. Sinani, Sh. 2011. *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Naimi, Tiranë.
79. Sinani,Sh. 2011. *Për letërsinë shqipe të shekullit të XX*, Naimi, Tiranë.
80. Sinani, Sh. 2012. *Njerëzit e krisur të Agollit*. Naimi, Tiranë.
81. Smith, A, D. 1986. *Ethnic origins of nations*, Oxford basic Blackwell .
82. Smith, A, D. 1989. *The origins of nations*, Ethnic and racial studies
83. Smith, A. D. 1991. *National Identity*, London, New York: Penguin Books.
84. Smith, A. D. 1998. *Nationalism and Modernism*, London and New York: Routledge.
85. Smith, A. D. 2008. *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale*, Dudaj, Tiranë.
86. Smith, A. 1998. *Nation-building in the Post-Soviet Borderlands: The Politics of National Identities*, Cambridge University Press.
87. Spinoza, B. 2001. *“Traktat mbi intelektin”* Plejad. Tiranë.
88. Spinoza, Benedict de. 2007. *Theological-Political Treatise*; “On the vocation of the Hebrews”, Cambridge University Press.
89. Stoessinger, G. J, 2007. *Përse kombet shkojnë në luftë?*, ISN, Tiranë.
90. Sulstarova, Enis. (2015). *Ligjërimi nacionalist në Shqipëri*. Tiranë, Pika pa sipërfaqe.
91. Shkurtaj, Gj.2012. *“Balta e arave si shtegu i prurjeve gjuhëpasuruese dhe gjuhëdashëse të Dritëro Agollit”*, Botime “FEF”, SCRIPTA MANENT, Korçë.

92. Tishkov, V, 1999. "*The Culture of Ethnic Violence: the Osh Conflict*", in *Ethnicity, Nationalism and Conflict in and after the Soviet Union*, London, Sage.
93. Titscher, S., Meyer, M., Wodak, R., & Vetter, E. 2000. *Methods of text and discourse analysis*. London Thousand Oaks, CA: Sage.
94. Trere, S& Gallegati, G. 1990. *Nuovi itinerari nella comunicazione letteraria*. Bulgarini, Firenze.
95. Thomai, J. 2012. "*Aromë popullore në ligjërimin poetik të Dritëro Agollit*", Botime "FEF", SCRIPTA MANENT, Korçë.
96. Uçi, A.1982. "*Mitologjia, folklori, letërsia*" Naim Frashëri, Tiranë.
97. Van Dijk, T. 1998. *News as Discourse*. Hillsdale, NJ: Erlbaum.
98. Van Dijk, T. A. (Ed.). 2011. *Discourse Studies. A multidisciplinary introduction*. Second Edition. London: Sage.
99. Van Dijk, T. A. (Ed.). 2007. *Discourse Studies. 5 vols.* Sage Benchmark Studies in Discourse Analysis. London, Sage.
100. Van Leeuwen, T. 2005. *Introduction to social semiotics*. London: Routledge.
101. Van Leeuwen, T. 2008. *Discourse and Practice. New Tools for Critical Discourse Analysis*. Oxford: Oxford U.P.
102. Wasilewska, E, 1997. "*The Past and the Present: the Power of Heroic Epics and Oral Tradition*. Manas 1000.
103. Weiss, G., & Wodak, R. (Eds.). (2003). *Critical discourse analysis. Theory and interdisciplinarity*. Houndmills, UK: Palgrave Macmillan.
104. Wellen, R & Warren, A. 2007. *Teoria e letërsisë*. Tiranë, Onufri.
105. Wheelles, A, B. 1958. *The quest for Identity*. New York Norton.
106. Wodak, R. 1989. *Language, power and ideology. Studies in political discourse*. Amsterdam: Benjamins.
107. Wodak, R., & Meyer, M. (Eds.). 2001. *Methods of critical discourse analysis*. London Thousand Oaks, CA.: Sage.

108. Wodak, R., & Chilton, P. A. (Eds.). 2005. *A new agenda in (critical) discourse analysis. Theory, methodology and interdisciplinarity*. Amsterdam: J. Benjamins Pub. Co.
109. Wodak, R., & Koller, V. (Eds.). 2008. *Handbook of communication in the public sphere*. New York: Mouton de Gruyter.
110. Wodak, R., & Meyer, M. (Eds.). 2009. *Methods of critical discourse analysis. Second revised edition*. London: Sage.
111. Wodak, R & Meyer, M (Eds.). 2009. *Critical Discourse Analysis, History, Agenda, Theory and Methodology in Methods of critical discourse analysis (Introducing Qualitative Methods)*. London, Sage
112. Wooffitt, R. 2005. *Conversation analysis and discourse analysis. A comparative and critical introduction*. London: SAGE.
113. Yourdusev, A, N.1997. *"Avrupa Kimliğinin Oluşumu ve Türk Kimliği" ("The Making of European Identity and Turkish Identity")* in Atila Eralp (ed.) *Türkiye ve Avrupa: Batılılaşma, Kalkınma ve Demokrasi (Turkey and Europe: Westernization, Development and Democracy)*, Ankara: İmge Yayınları.

Vepra të Dritëro Agollit

1. Agolli, D. 1958. *Në rrugë dolla*, Naim Frashëri. Tiranë.
2. Agolli, D. 1961. *Hapat e mia në asfalt*, Naim Frashëri. Tiranë
3. Agolli, D. 1969. *Mesditë*. Naim Frashëri, Tiranë.
4. Agolli, D. 1973. *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, Naim Frashëri, Tiranë.
5. Agolli, D. 1975. *Nënë Shqipëri*. Naim Frashëri, Tiranë.
6. Agolli, D. 1975. *Njeriu me top*. Naim Frashëri, Tiranë
7. Agolli, D. 1977. *Fjala gdhend gurin*, Naim Frashëri. Tiranë
8. Agolli, D. 1980. *Arti dhe koha-Artikuj kritikë*. Naim Frashëri, Tiranë.

9. Agolli, D. 1981. *Komisari Memo*. Naim Frashëri, Tiranë.
10. Agolli, D. 1981. “*Vepra letrare*”, nr. 6, Tiranë.
11. Agolli, D. 1986. “*Gjuha jonë*”, nr.1, Tiranë.
12. Agolli, D. 1991. *Dështaku*, Naim Frashëri, Tiranë
13. Agolli, D. 2006. *Zhurma e erërave të dikurshme*. Onufri, Tiranë.
14. Agolli, D. 2011. *Kam penën e mprehtë dhe mendjen e kthjellët*. UET press, Tiranë.

Materiale elektronike

1. Blair, Toni- ish Kryeministër i Britanisë,- *Europa multikulturore, nga fjalimi i tij në Këshillin e Europës, 2010*.
2. Treccani Vocabolario, format elektronik, <http://www.treccani.it/vocabolario/antieroe/> konsultuar më 10.10.2015,
3. Michigan State University: <http://www.msu.edu/user/hillrr/161lec16.htm>
4. United Nations: <http://www.un.org/News/Press/docs/2002/gaef3012.doc.htm>
5. Van Dijk, Teun A. *Critical Discourse Analysis*
<http://www.discourses.org/OldArticles/Critical%20discourse%20analysis.pdf>
6. www.amazon.ca. Dict.fr/he T.2 (Hebrew) Hardcover – Dec 18. 1996 by [MARC M. COHN](#) (Author) pare më 25.08.2015.

Revista shkencore

1. Revista *Rruga e Partisë*, viti 1978
2. *Autoktonia shqiptare në studimet gjermane*, 8 Nëntori, 1990
3. *Quo vadis, Shqipëri?* Albania, 1993
4. Merriam-Webster's Collegiate History, Springfield, Massachusetts: Merriam-Webster, Inc., 1998
5. Amsterdam: *Harwood Academic Publishers*, 2000
6. Evidence From the Field, *Nationalities Papers*, Vol. 28, No 2, 2000
7. DEMSTAR Research Report N 16, September 2003
8. Articles: *Peace and Conflict Review*, Volume 1 Issue 1, Year 2008